



BULETIN

Revistë Informative
Periodike

Qershor - Dhjetor 2015



Republika e Kosovës



Komuna e Gjilanit

2016 - ta,

vit i investimeve të mëdha

Qyteti i Gjilanit, i anashkaluar për shumë vite në projektet e mëdha, tani po hap një epokë të re për sa i përket infrastrukturës dhe zhvillimit. Përfundimisht është vendosur ndërtimi i autostradës në këtë pjesë. Është prezantuar edhe projekti ideor. Autostrada Prishtinë - Gjilan - Konçul e lidh kryeqendrën e Anamoravës me korridoret e kombit dhe korridoret tjera të mëdha ndërkombëtare. Në Gjilan ka filluar edhe ndërtimi i rrugëve hyrëse-dalëse me katër krosi. Komuna ka ndarë 900 mijë euro për drejtimin Gjilan-Bujanoc. Sivjet

pritet të fillojnë investime të mëdha në sektorin e ujërave të zeza. Marrëveshja është nënshkruar tashmë me austriakët dhe ka vlerën 12 milionë euro. Investimet e përgjithshme, sivjet do të arrijnë në 22 milionë euro. Edhe ndriçimi publik dhe infrastruktura e gjelbër po kompletohen gradualisht. Gjilani po hap një epokë të re. Gjilani nuk është më një qytet anësor në Kosovë, por një kryeqendër e rëndësishme e një mikro-regjioni ballkanik. Qeverisja e Lutfi Hazirit ka hapur një epokë të re për Gjilanin.



**Bëhen me shtëpi 24 familje
skamnore në Gjilan**



**Gjilani bëhet me
autostradë**

FAQE 7

Hoti: Haziri, model për disiplinën fiskale

FAQE 9

Haziri: Standardi i dyfishtë nuk është pjesë e punës sime

FAQE 24

Në Kuvendin e Gjilanit ka hapësirë të gjerë për debat

FAQE 31

Haziri riorganizon qeverisjen

FAQE 86

Në infrastrukturë publike do të investohen 22 milionë gjatë vitit 2016

Botoi

KK Gjilan, Zyra për Informim

E përgatiti, Stafi i Zyrës për Informim:

Ilmi Musliu

Ibrahim Ademi

Muhamet Pajaziti

Eroll Jonuzi - Fotoreporter

kk.rks-gov.net/gjilan

0280/321 486



Për Gjilani

Gjilani gjendet në pjesën juglindore të Kosovës. Si njëra ndër komunat më të mëdha të Kosovës, me rreth 100 mijë banorë rezidentë, është qendër e Anamoravës dhe regjionit të lindjes, në përgjithësi, që përfshin njëmbëdhjetë komuna.

Gjilani si vendbanim është formuar rreth vitit 1750, ndërsa si qendër urbane - në vitin 1772. Si qendër urbane është zhvilluar krahas shuarjes së Novobërdës (Artanës), e cila në mesjetë ka qenë njëri nga qytetet dhe qendrat më të mëdha tregtare dhe ekonomike në Ballkan.

Pozita gjeografike që ka Gjilani, si një gjeo-komunikuese, i mundëson atij lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit.

Gjilani është larg nga Prishtina, kryeqendra e Kosovës, 46 kilometra, nga Kamenica - 27 km, nga Vitia - 22 km, nga Artana – rreth 25 kilometra. Me komunat e regjionit, në juglindje kufizohet me Preshevën (33 km) dhe Kumanovën (53 km), ndërsa në lindje – me Bujanocin (40 km).

Ndërtimi i rrugës Gjilan-Lipjan, nga drejtimi i Kishnapolës, ka shkurtuar dukshëm distancat e kësaj komune me aeroportin e Prishtinës, me rrugën e kombit si dhe me hekurudhat e Kosovës.

Gjilani si komunë dhe si regjion, shumë shpejt, do të ketë edhe autostradën. Është duke u kryer studimi i fizibilitetit dhe pritet të përcaktohet drejtimi më i përshtatshëm për ndërtimin e autostradës.

Gjilani pret të lidhet së shpejti edhe me Kumanovën, nga drejtimi i Stançiqit, ku parashihet hapja e një pike doganore.

Qyteti përshkohet nga tre lumenj të vegjël, Mirusha, Banja dhe Stanishori, të cilët bashkohen dhe derdhen në Moravën e Binçës, që përbën njërin prej tre lumenjve më të mëdhenj në Kosovë.

Gjilani ka dy liqej akumulues, në Përlepnice, që shfrytëzohet për furnizimin e qytetit me ujë të pijes dhe, në Livoç të Epërm, që shfrytëzohet si qendër rekreative.

Gjilani njihet edhe për ujërat termale dhe ka dy banja, në Mireshe e Uglar.

Gjilani ka kushte të mira për bujqësi dhe njihet si qytet agro-industrial. Rrethina e Gjilanit është e pasur me xehe (hekur e leucid) dhe me burime minerale (Nasalë, Pidiq, Kmetoc, Uglar, Përlepnice).

Gjilani njihet edhe si qytet i bashkatdhetarëve, meqë besohet se në botën e jashtme jetojnë mbi 35 për qind e qytetarëve të kësaj komune.

Prej 15 vitesh e kënde, Gjilani është shndërruar në atdhe të dytë edhe për të zhvendosurit nga Lugina e Presheves. Aktualisht, llogaritet se këtu jetojnë mbi 15 mijë banorë nga kjo trevë etnike dhe mbi 11 mijë prej tyre kanë ardhur gjatë luftës së fundit atje.

Me iniciativën e kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri, korriku është shpallur “Muaj i mërgimtarëve”. Haziri i konsideron mërgimtarët vlerë kombëtare.

Prej dhjetorit të vitit 2014, në Gjilan, është hapur Zyra për Preshevë, Bujanoc e Medvegje, në bazë të Rezolutës së Parlamentit të Kosovës, të sponsorizuar nga deputeti i atëhershëm Lutfi Haziri. Zyra merret me problemet e të zhvendosurve si dhe bashkëpunimin ndërkufitar.

Gjilani e ka rikthyer “panaxhyrin” e famshëm, për të ruajtur traditën dhe për t’iu dhënë mundësi bizneseve vendore që t’i promovojnë dhe shesin prodhimet e tyre.

Gjilani është shpallur “Qytet i Paqes” nga Këshilli i Europës.

Qyteti i Gjilanit është dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani si dhe nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga.

Gjilani është binjakëzuar me qytetet dhe komunat Luterbah (Francë), Iper (Belgjikë), Jelderim (Turqi) dhe të tjera.

Gjilani, me kalanë e Pogragjës dhe vlerat tjera të trashëgimisë, ka bërë hapa konkret në zhvillimin e turizmit, duke falënderuar edhe sektorin privat që ka bërë investime në këtë fushë.

Qeverisja e tashme, e udhëhequr nga Lutfi Haziri, në vitin e parë të qeverisjes ka punuar me shumë përkushtim në ndërtimin e rrugëve dhe trotuareve, ujësjellës, kanalizime dhe ndriçim publik, si katër prioritete të mëdha dhe të domosdoshme për jetën e qytetarëve.

Një punë e madhe është duke u bërë në ndërtimin e shtëpive për të pa strehët dhe vetëm sivjet, me kulm mbi kokë do të bëhen të paktën 15 familje, sikurse shumë të tjerave do t’iu rinovohen objektet e banimit, ndërkaq rasteve që nuk kanë troje, po u kompensohet qiraja mujore.

Gjilani, tani po përgatitet për fillimin e projekteve më të mëdha, siç janë hyrjet e qytetit me katër krosi, sistemimi i ujërave të zeza, parku në lagjen Dardania si dhe shumë projekte të tjera, të cilat do të realizohen nga buxheti i Komunës, mjetet e qeverisë dhe donatorëve e miqve të shumtë, që kjo Komunë i ka krijuar falë aftësive të kryetarit Haziri.

Lutfi Haziri e ka kthyer vëmendjen e Prishtinës dhe Tiranës nga Gjilani.

Gjilani nuk është më një qytet i harruar dhe i anashkaluar i Kosovës, siç ishte për disa vite me radhë.

Editoriali

Gjilani po hyn në një epokë të re

Sapo e lamë pas edhe 6-mujorin e dytë të vitit 2015, përkatësisht vitin e dytë të qeverisjes sonë. Jemi të vetëdijshëm se nuk kemi bërë aq sa është dashur, por jemi po ashtu të bindur se jemi përpjekur të bëjmë më shumë se sa kemi mundur.

Problemet e trashëguara kanë qenë një barrë e rëndë për qeverisjen tonë, që na ka penguar të ecim përpara sipas planit tonë.

Viti që kemi hyrë, do të jetë fillim i një epoke të re për Gjilanin. Problemi i vadave, lloçit, ujërave të zeza, kanalizimeve, ndriçimit publik, rrugëve, trotuareve dhe ujit të pijes, do t'i takojnë një periudhë të kaluar për Gjilanin.

Problemi i banimit social është zbutur ndjeshëm. 25 familje tashmë kanë shtëpi të reja. Mbi 30 të tjera janë në procedura për rinovim, kurse mbi 40 familjeve u është kompensuar qiraja. Do të vazhdojmë derisa ta zgjidhim këtë problem.

Vitin tjetër fillon edhe autostrada e Gjilanit. Gjilanin e anashkaluar për shumë vite, tani po e integrojmë në korridoret e mëdha të kombit dhe ato ndërkombëtare. E kemi kthyer vëmendjen jo vetëm të Prishtinës dhe Tiranës nga Gjilani. S'ka ambasador dhe as ministër që s'ka ardhur në Gjilan në këto dy vite.

Vlera e investimeve që do të fillojnë sivjet, tejkalon edhe buxhetin e përgjithshëm të Komunës, prej afër 22 milionë euro. Gjilani nuk ka pasur kurrë kaq shumë investime. Këto investime nuk kanë mundur të sigurohen pa lobime, pa miq e pa partnerë, për të cilët Gjilani ka shumë nevojë.

Gjilani është shpallur Komuna me shpenzimet më të ulëta në Republikë. Kemi qeverisur me duar të pastra dhe me dyer të hapura për qytetarët.

Vazhdojmë tutje, për të realizuar ndryshimet e mëdha në Gjilan.

Lutfi Haziri, kryetar i Komunës

Ndërlidhja mes gjeneratave, çelës i ndërtimit të një të ardhme përparimtare

*(Fjala e Lutfi Hazirit në Samitin për Leadership të Ri,
në Minneapolis të Minesotas në SHBA)*

Përsëritje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur në këtë sesion, i cili besoj të jetë më i rëndësishmi i konferencës vjetore të Sister Cities International mbi temën e Ndërlidhjes së Gjeneratave për Paqe, jo sepse unë jam ligjëruesi i këtij sesioni, por sepse ju jeni audienca.

Unë ndihem i nderuar dhe i privilegjuar që po ju drejtohem juve sot. Kam kaluar Atlantikun për të qenë me ju sot dhe po ndihem mirë për këtë. Siç e dini, unë vij nga shteti më i ri i Evropës, Republika e Kosovës, dhe jam kryetar i Gjilanit, njërit nga qytetet më të mëdha të Kosovës.

Kur po ju shikoj juve, po më kthehen në kujtesë kujtime të ditëve të hershme të angazhimit tim në shërbim të komunitetit dhe në jetën politike. Por, kur unë kisha filluar të merrem me këto punë, kushtet në të cilat veproja ishin shume të rënda. Kosova, shteti im, ishte në okupimin serb deri në Qershor 1999, dhe gjatë asaj periudhë të ishe shqiptar ishte pretekst i mjaftueshëm për t'u diskriminuar, maltretuar, apo burgosur nga regjimit i atëhershëm serb. Historia e vendit tim paraqet një fakt fatkeq që tregon ekzistimin e aparteidit në zemër të Evropës në shekullin 21.

Sidoqoftë, ato ditë përplot vuajtje kanë marrë fund. Unë ndihem krenar që i kam shërbyer vendin dhe popullit tim, dhe që po i shërbej qytetit tim tani.

Barrierat dhe sfidat janë ndoshta mënyra më e mirë për të na dhënë mësimet jetësore. Mënyra se si ne merremi me barrierat dhe sfidat që na paraqiten do ta definojë atë se kush jemi ne. Dhe, nganjëherë, ju mund të mendoni se sfidat me të cilat ballafaqoheni janë tepër të mëdha për t'u tejkaluar. dhe si rezultat, nganjëherë mund të duket se rrugëdalja e vetme është dorëzimi para tyre. Nganjëherë, ne edhe mund të mos provojmë fare të tejkalojmë këto sfida. Mirëpo, nuk ka asnjë sfidë a barrierë të pakalueshme. Krejt çka ju duhet është vullneti. Të keni vullnet është të keni një urë që ju shpije drejtë tejkalimit të

sfidave dhe barrierave. Dhe, për të kaluar këtë urë mandej, ju duhet ta shoqëroni vullnetin tuaj me punë vetëmohuese, përkushtim dhe qasje pozitive. Kështu, do të tejkaloni çdo sfidë apo barrierë.

Mirëpo, pse po flasim për sfida dhe barrierat? Ndoshta do të ishte më e këndshme të flisnim për suksesin apo kohët e mira. Ndoshta! Mirëpo, çfarë kuptimi do të kishte suksezi nëse ju falet, ju jepet pa munda? Çfarë kuptimi do të kishin kohët e mira nëse nuk do të ekzistonin edhe kohët e vështira?

Një gjeneral amerikan i mirënjohur, George Patton, ka thënë “suksezi është lartësia në të cilën ngjiteni pasi të keni prekur fundin.” Unë nuk do të mund të pajtohesha më shumë me këtë thënie. Me fjalë tjera, sukses është aftësia juaj për të tejkaluar sfidat dhe barrierat.

Në moshën tuaj, disa nga sfidat me të cilat ju ballafaqoheni është se çfarë të studioni, në cilin universitet të shkoni, apo çfarë të bëheni në të ardhmen? Apo, cila vajzë apo djalë do të ishte një dashur apo dashur më i mirë për ju? Dilema të mëdha, apo? Mund të jenë... Por, janë dilema të mira. Janë sfida të mira. Dhe, mënyra se si do t'i zgjidhni këto dilema e t'i tejkaloni këto sfida do ta definojë të ardhmen tuaj.

Por, çfarë mbanë e ardhmja për ju? Kush e di! Ndoshta ju do të bëheni një inxhinier i suksesshëm, apo një doktor, avokat, ndërmarrës? Çka do të jeni ju në të ardhmen? Kjo do të përcaktohet – deri diku të paktën – edhe nga e kaluara juaj, mënyra se si jeni rritur.

E kaluara juaj, miq të mi, është diçka e rëndësishme për ta konsideruar gjerësia të planifikoni të ardhmen. E kaluara e juaj është historia juaj, apo e prindërve të juaj, e lagjes suaj, familjes, shoqërisë, qytetit, apo kombit tuaj. Si individë, ne jemi të gjithë unikë. Përkundër kësaj, ne të gjithë kemi diçka të përbashkët—qytetet nga vijmë, lagjet ku jetojmë, apo edhe komunitetet të cilave iu takojmë. Kështu, ne jemi shoqëri të kësaj bote.

Dhe, përderisa fokusohemi në ecjen tonë përpara si individë, këtë duhet ta bëjmë edhe si shoqëri. Si shoqëri, në botën e globalizuar, ne mund të ecim përpara vetëm së bashku. Sfidat dhe barrierat me të cilat ballafaqohet bota jonë mund të zgjidhen vetëm kur ne bashkëpunojmë. Shoqëritë mund të jenë të racave, religjioneve, apo etnive të ndryshme, por përfundimisht të gjitha janë të një bote – të planetit tonë tokë.

Prandaj, ne duhet të punojmë së bashku – si shoqëri. Dhe për ta bërë këtë me sukses, neve na duhet ndërtuar ura lidhëse në mes të kaluarës dhe të tashmes sonë për të ndërtuar, kështu, shtegun tonë drejtë të ardhmes. Ndërlidhja ndërmjet gjeneratave është çelësi i ndërtimit të një të ardhme përparimtare për neve, për familjet tona, për komunitetet, qytetet, shtetet dhe shoqëritë tona—dhe në fund—për botën tonë.

Mos e merrni asnjë sfidë si të pamundur. Mos e merrni asnjë barrierë si të pakalueshme. Merreni vullnetin tuaj, te kaluarën, të tashmen dhe të ambicieve për të ardhmen si tulla mbi të cilat mund të arrini lartësi të reja. Dhe këto lartësi suksesesh nuk kanë fund. Gjithmonë bëni më të mirën që mundeni për të arritur suksesin e dëshiruar. Sepse, në fund të fundit, ju jeni e ardhmja; ju jeni suksesi për të cilin ëndërron secili prind.

Ky është vend i të lirëve dhe trimave. Ky është vend i mundësive. Merreni këto mundësi dhe ktheni ato në storie suksesi jo vetëm për vetën tuaj, por edhe për familjen tuaj, komunitetin, qytetin, dhe vendin tuaj—por edhe për botën, botën tonë. Bëjeni këtë. E di se mundeni. Po, gjithsesi mundeni. Ju faleminderit!

18 Korrik 2015, Minneapolis, Minnesota, USA

Mbi 100 biznese ekspozojnë prodhimet e tyre në panairin “Gjilani 2015”

02
KORRIK

Në Gjilan, të enjten është hapur Panairi regjional i prodhimeve vendore “Gjilani 2015”, i cili është organizuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, në bashkëpunim me USAID-in. Në hapjen e këtij panairi, ku prodhimet e tyre i kanë ekspozuar mbi 100 biznese, mes tyre edhe minoritete, ka marrë pjesë kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku Rexhepi, drejtori për Zhvillim Ekonomik, Ismail Januzi, përfaqësuesja e USAID-it, Marina Demitrievich, zyrtarë komunalë dhe qytetarë të shumtë Drejtori i DZHE-së, Ismail Januzi, ka thënë se qëllimi i këtij panairi është që bizneset të shkëmbejnë përvoja dhe të promovojnë produktet e tyre në kohën kur edhe mërgimtarët kthehen për pushime. “Synim yni është që prodhimet tona të gjejnë hapësirë edhe në tregjet e jashtme”, ka thënë Januzi. Kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku Rexhepi, tha se në Gjilan, përmes këtij panairi, po u mundësohet bizneseve që t’i promovojnë prodhimet e tyre. Marina Demitrievich, përfaqësuese



e USAID-it, ka thënë se përmes këtij aktiviteti, USAID-i ka për qëllim të përmirësojë komunikimin horizontal ndërmjet komuniteteve shumicë dhe jo shumicë, sikurse edhe promovimin e konkurrencës mes të bizneseve të vogla dhe të mesme. Panairi regjional i prodhimeve vendore “Gjilani 2015” është hapur për herë të parë vitin e kaluar dhe synon të bëhet tradicional. Ndërkohë, panairin tregtar në Gjilan e ka vizituar edhe kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, së bashku me ministrin e Shëndetësisë, Imet Rrahmani, nënkryetarin Rexhep Kadriu si dhe drejtorë komunalë. Pas bleu një plis, disa libra dhe gjëra të tjera, kryetari Haziri tha se synimi ynë është që të promovojmë vlerat e regjionit të Anamoravës. “Ne edhe vitin e kaluar, edhe sivjet kemi promovuar prodhimet tona, që po shkojnë në rritje”, është shprehur kryetari Haziri. Kreu i Gjilanit ka ftuar qytetarët që ta vizitojnë panagjyrin dhe të blejnë prodhimet tona, duke shtuar se ky “është ushqim i sofrës sonë, është ushqim për familjet tona”.



“Pak nga ne, shumë për ata” Komuna dhe donatorët i bëjnë me shtëpi të reja 24 familje në Gjilan

Aksioni i Komunës së Gjilanit, për t'i ndihmuar familjet që vetë nuk kanë arritur të zgjidhin problemin e strehimit, ka rezultuar shumë i suksesshëm. Ftesës së kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri, në mbrëmjen humanitare “Pak nga ne, shumë për ata”, i është përgjigjur një numër i konsiderueshëm i donatorëve, të cilët janë bërë pjesë e këtij aksioni të madh. Nga fondi i përbashkët i Komunës dhe donatorëve, sivjet janë ndërtuar 24 shtëpi të reja, 32 janë në proces të rinovimit, ndërkaq 41 familjeve u është kompensuar qiraja mujore e banimit për një vit. Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri i ka ftuar njerëzit e vullnetit të mirë që ndihmojnë për zgjidhjen e problemit të strehimit për familjet nevojtare. “Familje pa kulm mbi kokë, ka shumë në Gjilan”, ka thënë Haziri, duke shtuar se nuk ka vepër më të madhe sot në botë, se sa t'ua kthesh shpresën për jetë dhe për të ardhmen, këtyre familjeve dhe fëmijëve të tyre. Kështu donatori Bekim Emini, nga Gjilani, i cili jeton dhe punon në Berlin të Gjermanisë, në bashkëpunim me Komunën e kanë bërë me shtëpi të re familjen Spahiu nga fshati Kishnapole, duke e kthyer gëzimin në këtë familje nëntë anëtarësh. Në emër të familjes, Gazmend Spahiu, ka thënë se deri tani kanë jetuar në kushte shumë të rënda, meqë shtëpia u ishte djegur gjatë luftës. Donatori Fejzulla Mustafa, pronar i Fabrikës së pijeve “Fluidi” ka ndërtuar dy shtëpi për familjet e Mehreme Krasniqit si dhe Valbona Lutfiut. Donatori Lulzim Bajrami ka ndërtuar

shtëpi për familjen gjashtë anëtarësh të Fatmir Jusufit, në lagjen “Dheu i Bardhë”. Shoqata humanitare “Sali Çeku”, në bashkëpunim me ish-klubin kulturor “Muharrem Bekteshi” në Ollten të Zvicrës, ka ndërtuar shtëpi për veteranin e luftës, Xhevdet Qahili, në fshatin Zhegër. Familja gjashtë anëtarësh e Fatmir Jusufit nga Gjilani, e cila ka jetuar në gjendje të mjerueshme të banimit, është bërë me shtëpi nga donatori Lulzim Bajrami. Klubi i motoristëve nga Zvicra “Plisat” kanë ndërtuar shtëpi për familjen e Shukri Rahimit nga fshati Verbicë e Zhegocit, e cila deri tani ka jetuar në kushte jashtëzakonisht të rënda. “Kjo është dita më e lumtur e jetës time”, ka thënë Rrahimi, pasi ka shkelur në shtëpinë e re. Në fshatin Sllakoc, dy shtëpi janë ndërtuar nga donatori Fehmi Fetahu (Vali Ranch). Mirvete Momqilla, nëna e gjashtë fëmijëve, ka thënë se ndjehet jashtëzakonisht e lumtur me shtëpinë e re. Feriz Ymeri, përfituesi tjetër, ka thënë se tani ndjehet lumturia edhe në familjen e tij. “Shyqyr zotit që e prita këtë ditë ta shohë familjen time me shtëpi të re. Deri sot kemi jetuar në lloç”, ka theksuar Ymeri. Me shtëpi të reja janë bërë edhe shumë familje tjera në Gjilan. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, ka thënë se përsëri do të organizohet gala mbrëmja, në mënyrë që të ndihmohen familjet që kanë nevojë, i bindur se gjatë vitit të ardhshëm, 90 për qind të rasteve do të zgjidhen. “Shtëpia është dhurata më e madhe për këto familje”, thotë Haziri.

Ministri Hoti: Haziri është model për disiplinën fiskale

06
KORRIK

Ministri Avdullah Hoti e ka lavdëruar kryetarin e Gjilanit, Lutfi Haziri, për disiplinën buxhetore që ka imponuar në këtë Komunë, e që siç tha ai, duhet të jetë model për të gjitha komunat tjera, për shkak të situatës në të cilën jemi. Pasi e ka falënderuar për vizitën në Gjilan, kryetari Haziri e ka njoftuar ministrin Hoti rreth angazhimeve për qarkoren e parë buxhetore, për avaritë që i ka gjetur, sikurse edhe për obligimet dhe problemet tjera. “Thuhet se aty ku shkon ministri i Financave, aty është krejt qeveria, për shkak të peshës dhe rolit të madh që ka kjo Ministri në menaxhimin e buxhetit”, ka thënë Haziri. Ai theksoi se është njoftuar prej ministrit



Hoti për çështjet që pritet të kenë efekt jashtëzakonisht të madh në Gjilan, si reforma e pakos fiskale dhe falja e borxheve, që është politikë e re e qeverisë dhe e cila do ta ndihmojë Gjilanin. Ndërkaq, ministri i Financave, Avdullah Hoti ka thënë se me kryetarin Haziri ka biseduar për shumë çështje praktike e konkrete, që janë në interes të përbashkët, për punën e Komunës, për disa projekte që janë nisur në nivel të qeverisë. “Në Gjilan e kemi mbajtur takimin e parë kur e kemi prezantuar programin qeverisës dhe tash qeveria në praktikë po i zbaton këto tri ligjet e pakos fiskale, ligjin e amnistisë dhe plot projekte tjera”, tha Hoti.



07
KORRIK

Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, ka vizituar sot Universitetin Publik të Gjilanit “Kadri Zeka”, ku me rektorin Naim Syla kanë biseduar kryesisht për regjistrimin e studentëve të rinj. Temë e bisedës ka qenë edhe kompleksi universitar, që parashihet të ndërtohet në hapësirat e tashme të FSK-së. Me këtë rast, kreu i Komunës së Gjilanit ka kërkuar nga përfaqësuesit e Universitetit Publik “Kadri Zeka” që të përfshihen sa më

Haziri kërkon përfshirjen e studentëve nga Kosova Lindore në UPGJ

shumë studentë nga Presheva, Bujanoci e Medvegja si dhe nga Kumanova. Po ashtu, Haziri e Syla kanë diskutuar edhe për nevojën e ndërtimit të kompleksit universitar në hapësirat e kazermës së FSK-së. “Ndërtimi i kompleksit universitar në Gjilan, është i domosdo për qytetarët e Anamoravës, po ashtu edhe për ata të Preshevës, Bujanocit e Medvegjes si dhe të Kumanovës”, ka thënë kryetari Haziri, gjatë takimit me rektorin Syla.

Në Gjilan hapet Panairi i 43-të i librit

08

KORRIK

Është hapur sot në Gjilan Panairi i 43-të i librit “Gjilani 2015”, ku po marrin pjesë një numër i konsiderueshëm i shtëpive botuese. Në një fjalë rasti, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, tha se këtë ditë të nxehtë korriku, shkrimtarët po e freskojnë me librat e tyre. Ai ka falënderuar punëtorët e Bibliotekës si dhe zyrtarët komunalë, për punën që kanë bërë për panairin e librit në Gjilan. Kryetari i Gjilanit tha se në këtë vit institucionet komunale e rrisin çmimin e blerjes së librave në 4 mijë euro, në mënyrë që çerdheve, shkollave, bibliotekës dhe institucioneve tjera, t’iu ofrojmë libra të reja dhe botimet që u mungojnë. Kurse rektori i UPGJ “Kadri Zeka”, Naim Sylja, tha se ndjehet krenar që është pjesë e kësaj feste të librit, duke shtuar se pretendojnë që libri të jetë letërnjoftim i Universitetit, ndërsa kryefjalë e tij të jetë dija dhe cilësia.



Anton Nikë Berisha, fitues i çmimit letrar “Beqir Musliu”

Ndërkohë, me vendim të jurisë profesionale në përbërje Nihaz Sopaj, Sabile Keqmezi –Basha dhe Ramadan Musliu, fitues i çmimit letrar “Beqir Musliu” është shpallur prof. Anton Nikë Berisha. Vepra e gjithmbarshme letrare e studiuesit dhe shkrimtarit Berisha është e pasur dhe e veçantë. “Gjilani sot shënon emrin tuaj, në radhën e shkrimtarëve që e kanë marrë çmimin “Beqir Musliu” dhe këtë emër ne do ta ruajmë me kujdesin më të madh dhe me nderin më të madh ndaj jush”, u shpreh kryetari Lutfi Haziri, pasi ia dorëzoi çmimin “Beqir Musliu”shkrimtarit Anton Nikë Berisha. Anton Nikë Berisha ka falënderuar kryetarin Haziri dhe jurinë profesionale për vlerësimin e punës së tij, që përmbledhet në mbi 100 libra.



09

KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, ka pritur në një takim pune kryetarin e Këshillit Kombëtar për Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, njëherësh edhe kryetar i Kuvendit të Komunës së Bujanocit, Januz Musliu, me të cilin ka biseduar për problemet e ndryshme që kanë shqiptarët në Kosovën Lindore. Me këtë rast Haziri, ka thënë se takimet me përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës Lindore, për t’iu dhënë atyre mbështetje në të gjitha proceset për përmirësimin e gjendjes në atë pjesë, janë të rregullta. Në Gjilan është hapur edhe Zyra për Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, pas

Takimet me përfaqësuesit e Kosovës Lindore janë të rregullta

miratimit të rezolutës së Kuvendit të Kosovës, që ka të bëjë me gjendjen e shqiptarëve në këtë regjion dhe që është sponsorizuar nga Lutfi Haziri, në kohën sa ishte deputet. “Edukimi dhe arsimi në përgjithësi, janë në qendër të kësaj rezolute”, ka thënë Haziri, duke nënvizuar se fëmijët shqiptarë kanë të drejtë të mësojnë atje, sikur shqiptarët tjerë në regjion. Për më tepër, ai ka nënvizuar se kurrikula e Kosovës është e përshtatur me standardet e BE-së dhe nuk ka gjuhë urrejtje. Ndryshe, Haziri ka thënë se takimet me përfaqësuesit e shqiptarëve nga Kosova Lindore do të jenë të rregullta. “Ne do të tako-

hemi në periudha të rregullta kohore edhe me kryetarët e Komunave, për t'iu dhënë një mbështetje dhe për të ngritur zërin në institucionet e Kosovës lidhur me zgjidhjen e këtij problemi, por edhe për të ngritur zërin kundër politikës së Beogradit ndaj shqiptarëve të këtyre komunave, duke kërkuar zgjidhje të problemeve përmes bisedimeve, në mënyrë që njerëzit t'i kthehen jetës normale”, tha Haziri. Për më tepër, ai ka thënë se Kosova Lindore nuk mund të jetë pjesë shpërbërës apo e larguar e Kosovës së vitit 1974. “Ky problem duhet të shihet në thjerrëzën e një territori dhe të një populli kompakt, i cili do ta zgjedh problemin e kufijve në kohën kur Serbia do ta pranojë pavarësinë e Kosovës”, tha Haziri. Kurse, kryetari Mus-

liu, ka falënderuar kryetarin e Komunës së Gjilanit për angazhimin e përhershëm për të drejtat e shqiptarëve të Kosovës Lindore, që nga dorëzimi i rezolutës në Kuvendin e Kosovës, e deri ta hapja e Zyrës për Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, që është një urë lidhëse shumë e fuqishme për shqiptarët e zhvendosur nga ajo pjesë. Ai ka folur edhe për shkollimin, që është shumë larg asaj që duhet të jetë për fëmijët shqiptarë. Literatura në gjuhën shqipe është me shumë gabime, në nivelin fillor, kurse në nivelin e mesëm, mungon tërësisht. Atje po bëhet pas-trimi i listave të gjendjes civile dhe shtetësisë së shqiptarëve. “Shqiptarët po largohen nga listat pa asnjë kriter”, ka thënë Musliu.

Haziri: Standardi i dyfishtë nuk është pjesë e punës sime

09
KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri ka paraqitur raportin e punës për periudhën 6-mujore, në Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), ku pasqyrohen të gjitha aktivitetet, sukseset dhe sfidat e kësaj periudhe. “Duke u bazuar në obligimet e mia ligjore, jam këtu për të paraqitur para jush punën e qeverisjes komunale dhe këtë e kam bërë edhe para shoqërisë civile dhe qytetarëve, në debatin publik të javës së kaluar dhe do të vazhdoj edhe nëpër lagje”, ka thënë kryetari Haziri, duke shtuar se është i gatshëm t'i dëgjojë edhe vërejtjet e KPF-së dhe të mbajë shënime për to.

Ndërkaq, duke iu përgjigjur akuzave të Bujar Nevzatit (PDK), në drejtim të tij, kryetari Haziri ka thënë se ai është i zgjedhur prej qytetarëve dhe nuk pranon që një këshilltar komunal të sillet kundërt tij si prokuror, në një seancë të Komitetit për Politikë dhe Financa. “Shumica e madhe e qytetarëve të Gjilanit e kanë zgjedhur programin tim dhe ky besim duhet të respektohet edhe nga opozita në vendimmarrjen komunale”, ka thënë Haziri, duke shtuar se ligji i jep mundësi atij që të punojë edhe në zyrë. Duke vazhduar me përgjigje ndaj akuzave tjera të këshilltarit të PDK-së, Bujar Nevzati, rreth ndërtimeve pa leje, zhurmës, pendës dhe shtëpisë së kulturës në Përlepenicë dhe të tjera, Haziri ka thënë se “disa njerëz janë të lindur për të bërë histori, kurse disa të tjerë janë të lindur për të mësuar histori”. Sa u përket ndërtimeve pa leje, ku

Nevzati insistoi më së tepërmi, kryetari Haziri ka thënë se ndërtimet pa leje janë njëri ndër problemet e Gjilanit dhe këtu nuk ka asgjë për të fshehur, por duhet shtuar se ka edhe këshilltarë komunalë, edhe oficerë policie që kanë ndërtuar pa leje. “Rrënimi i objekteve pa leje do të ndodh, sikurse që do të ndalohet edhe zhurma në qytet”, ka thënë kryetari Haziri, duke rikujtuar se në të shumtën e rasteve janë fëmijë të prindërve të njohur ata që krijojnë zhurmë dhe shtinë me armë në dasma.

Kurse sa i përket pendës së Përlepenicës, Haziri ka thënë se nuk paraqet asnjë rrezik për banorët dhe ka shtuar se penda është nën përgjegjësinë e Ministrisë dhe jo të Komunës.

Duke kërkuar që të mos personalizohen raportet, kryetari Haziri ka thënë se ky qytet ka më shumë nevojë për punë se sa për fjalë e pallavra dhe si njëri prej punëve të mira, ka përmendur edhe projektin për ndërtimin e çerdhes në lagjen “Dardania 1”, për të cilin USAID-i pritët të ndajë 200 mijë dollarë dhe nevojitet një participim edhe prej Komunës. Përndryshe, raporti i kryetarit të Komunës, i ofruar në formë të shkruar, i përmban në hollësi të gjitha aktivitetet e kësaj periudhe dhe do të diskutohet edhe në Kuvend Komunal, në seancën e ardhshme.

Kryetari Haziri hapi zyrtarisht fushatën e korrje- shirjeve



10
KORRIK

Lutfi Haziri, kryetar i Komunës së Gjilanit, i shoqëruar nga drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, e ka hapur sot zyrtarisht fushatën e korrje-shirjeve në Gjilan. Komuna e Gjilanit ka të mbjellë mbi 3 mijë hektarë me drithëra të bardha dhe bazuar në ngastrat e para, rendimentet janë premtuese. Me këtë rast, kryetari Haziri u zotua se do të vazhdojë t'i subvencionoj familjet bujqësore, në mënyrë që të mos mbetet asnjë pëllëmbë toke pa punuar. "Sot filluam fushatën e korrje-shirjeve, e falënderoj Drejtorinë e Bujqësisë për përgatitjet, bujqit dhe kombajnerët, të cilët kanë bërë të pamundurën që fushata e korrje-shirjeve ta zë kohën e bereqetit, që për një vit familjet kanë punuar për ta fituar

bukën e gojës. I lutemi dhe i falemi Zotit për bukën e dhënë, për bereqetin që e kemi sivjet dhe zotohemi që do të vazhdojmë t'i subvencionojmë familjet bujqësore, në mënyrë që të mos mbetet asnjë pëllëmbë toke pa punuar", ka deklaruar Haziri. Drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, tha se në komunën e Gjilanit janë të mbjella mbi 3000 hektarë grurë, ndërsa ka shfaqur bindjen se fushata e korrje-shirjeve të përfundojë brenda 12 ditëve. "Të gjitha përgatitjet për korrje-shirje janë bërë me kohë. Kapacitetet pranuese të grurit janë të mjaftueshme dhe shpresoj shumë që për 12 ditë do ta përfundojmë fushatën", ka thënë Ramadani. Sipas tij, rezultatet e para janë premtuese.

"Po e ruajmë kuletën e popullit"

10
KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga kryesuesja Valentina Bunjaku Rexhepi, nënkryetari Rexhep Kadriu si dhe drejtorët komunalë, ka mbajtur mbrëmë një debat publik me qytetarët e lagjes "Dardania". Në debatin e madh me qytetarë, që u mbajt javën e kaluar, Haziri tha se debatet do t'i shtrijë edhe nëpër lagje, për të dëgjuar nga afër zërin e publikut. Sipas tij, vetëm një takim i obliguar, është i pamjaftueshëm. Kryetari Haziri ka përmendur të arriturat gjatë kësaj periudhe qeverisëse, duke aplikuar dietën e ashpër buxhetore dhe ka theksuar se në këtë mënyrë po e ruajmë kuletën e popullit. "E kemi kthyer disiplinën në punë, dieta e ashpër fiskale po vazhdon, nuk ka shpenzime në ushqime dhe kategori tjera. Duke kursyer, ne po realizojmë investime dhe po e ruajmë kuletën e popullit", tha Haziri. Kreu i Gjilanit është shprehur se në lagjen "Dardania" është investuar me të gjitha kapacitetet në infrastrukturë, përfshirë ndërtimin e rrugëve, kanal-

izimeve, ujësjellësit, ndriçimin publik, pastaj investimet në shkollën fillore "Selami Hallaqi" dhe të tjera. Ai ka paralajmëruar se së shpejti pritet të nis ndërtimi i çerdhes në këtë lagje, që do të jetë bashkëfinancim me USAID-in, pastaj projekti nga programi "Kosova e Bukur", që ka të bëjë me parkun dhe hapësirat rekreative në këtë lagje, ku pritet të punësohen mbi 60 persona. Gjatë ditëve në vijim në "Dardania" pritet të nis edhe ndërtimi i kanalizimit në rrugën "15 qershori", sikurse edhe pilot-projekti për ndarjen e mbeturinave, që do të realizohet në bashkëpunim me GIZ-in. Më pas, kryetari Haziri dhe bashkëpunëtorët e tij u janë përgjigjur pyetjeve dhe interesimeve të qytetarëve Sahit Hyseni, Edon Rexhepi, Sabri Shkodra, Isuf Rexhepi, Bexhet Ismajli etj., të cilët, kryesisht paraqitën si shqetësim zhurmën që po krijojnë kafiteritë. Kreu i Komunës tha se ka nënshkruar urdhrin ekzekutiv për këtë çështje, duke theksuar se do të ketë zero tolerancë sa i përket zhurmës.



Gjilanit i premtohet autostrada

11
KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri së bashku me nënkryetarin Rexhep Kadriu dhe drejtorët komunalë, kanë pritur sot në një vizitë pune ministrin e Infrastrukturës, Lutfi Zharku, me të cilin kanë biseduar për mundësinë e investimeve në rrugët regjionale, të cilat janë degraduar jashtëzakonisht shumë, pa harruar as kërkesën për autostradë. Me këtë rast, Haziri ka thënë se Komuna do t'i bëjë investimet e veta sipas dinamikës së planifikuar, por ka kërkuar nga ministri që rrugët magjistrale, hyrje – daljet dhe rrugët tjera në Gjilan, të mbështeten financiarisht nga niveli qendror, sepse është e pa mundur që ato të rregullohen me buxhet vetanak. “Gjilani ka nevojë për projekte madhore, siç janë korridoret, autostradat, rrugët regjionale apo rrugë që Gjilanin e lidhin me regjionin, me korridoret ndërkombëtare dhe me rrugën e kombit”, tha Haziri. Ndërsa

ministri Lutfi Zharku, ka thënë se erdhi në Gjilan për t'i parë nga afër projektet që janë realizuar, por edhe për t'u njohur me problemet dhe hallet që ka kjo Komunë, lidhur me rrugët magjistrale dhe rrugët tjera në përgjithësi. “Javën e ardhshme do të kemi propozimet e para për autostradën Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë, që më pas, bashkërisht të bisedojmë për opsionin më të mirë”, ka thënë Zharku, duke shtuar se në buxhetin e vitit të ardhshëm, do të futet edhe planifikimi për autostradën si dhe për projektet e shumta që Gjilani ka dorëzuar në ministri.

Ndryshe kryetari Haziri dhe ministri Zharku kanë vizituar korridorin që lidh Gjilanin me Bujanocin, me Preshevën, me Ferizajn dhe Prishtinën dhe gjithashtu kanë vizituar edhe projektet e asfaltimit të rrugëve në disa lagje të Gjilanit.

Haziri: Po e kthejmë vëmendjen e Prishtinës dhe Tiranës nga Gjilani



16
KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka qëndruar për një vizitë të shkurtër në Tiranë, ku është pritur nga kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Ilir Meta dhe nga kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Lulzim Basha. Gjatë takimeve të ndara të kryetarit Haziri me kryeparlamentarin Meta dhe

kryetarin e PD-së, Basha, është biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit mes Gjilanit dhe institucioneve të shtetit shqiptar, përfshirë këtu edhe këmbimin e përvojave në arsim, kulturë, art etj. Kryetari Haziri ka thënë se kjo vizitë përkthehet edhe me kthim të vëmendjes së Prishtinës dhe Tiranës nga Gjilani.

Haziri ua dorëzon pllakat me emrin e shkollave familjeve Hoxha e Shemsu



17
KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga nënkryetari Rexhep Kadriu ua ka dorëzuar familjeve Hoxha nga Cërница dhe Shemsu nga Përlepnica, pllakat me emrin “Nazmi Hoxha” e “Zija Shemsu”, të cilët do t'i mbajnë shkollat në “Lagjen e Re” dhe “Zabeli i Sahit Agës”. Nazmi Hoxha ishte patriot dhe udhëheqës për lirinë e shqiptarëve.

Kryetari Haziri tha se ky emër i bënë nder shkollës, Gjilanit dhe Anamoravës. Bashkëshortja Zijaverja ka falënderuar kryetarin Haziri për nderin dhe respektin që ka treguar për këtë familje, duke emërtuar shkollën fillore me emrin e Nazmi Hoxhës, i cili la gjurmë të pashlyeshme në historinë e Kosovës, si udhëheqës për lirinë e shqiptarëve.

Ndërkaq, në emër të familjes Shemsu, pllakën me emrin e shkollës fillore në lagjen “Zabel i Sahit Agës” e ka pranuar Shabani, vëllai i heroit, i cili tha se ky është nderi më i madh që ndonjë institucion ka bërë për familjen Shemsu. Kryetari Haziri tha se kjo është më e pakta që mund të bëjnë institucionet lokale për veprën heroike të Zija Shemsut, i cili u sakrifikuara për lirinë e shqiptarëve.



Kryetari Haziri, vizitë zyrtare në SHBA

17
KORRIK

Kryetari i Komunës së Gjiçanit, Lutfi Haziri, me ftesë zyrtare të “Sister Cities International” ka udhëtuar për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Haziri është folësi kryesor në Samitin e Lidershit Rinor, i cili organizohet nga “Sister Cities International” në Minneapolis, ku pritet të marrin pjesë mbi 600 liderë të zgjedhur me vota nga komuniteti, nga e mbarë bota. Samiti i Lidershit Rinor është dizajnuar të angazhojë gjeneratën e ardhshme të liderëve dhe të ekspozojë ndaj sfidave të rëndësishme globale. Në Wisconsin Dells, afër Chicagos, kryetari Haziri do të takohet me presidentin

e kompanisë amerikane Blue Stone Safety, e cila ka shprehur interesim për investim në Gjiçan, përderisa më 20 korrik, në Washington DC, Haziri do të ketë takim me drejtorin global të International City Management Association, sikurse edhe një takim me ish-ambasadorin Walker, tani përfaqësues i një kompanie energjetike amerikane. Më 21 korrik, në Washington DC, kryetari i Gjiçanit do të takohet me zyrtarë të lartë të Departamentit të Shtetit, ndërsa nga 22 deri më 25 korrik, në New York City, do të ketë takime me përfaqësues të lobit shqiptar në SHBA, me komunitetin e biznesit etj.



Lutfi Haziri mbanë fjalim kryesor në Konferencës Vjetore të Sister Cities International në SHBA

18
KORRIK

Minneapolis, 18 korrik 2015 - Në ditën e parë të qëndrimit të tij në SHBA, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka marrë pjesë në punimet plenare të Konferencës Vjetore të Sister Cities International në Minneapolis, Minnesota, ku është ftuar të mbajë fjalimin kryesor të Samitit mbi Lidershpin Rinor të kësaj konference. Paradite, Haziri ka marrë pjesë në sesionin plenar diplomatik të konferencës, ku panelistë ishin Tomosaburo Esaki nga Ambasada Japoneze në Washington DC, Alberto Fierro Garza, Konsull i Meksikës në Minnesota, dhe Jamshed Merchant, Konsull i Përgjithshëm i Kanadasë në Minnesota. Ndër temat e diskutuara, në të cilën u inkuadrua edhe Faton Bislimi, ligjërues në Universitetin e Albertës që po shoqëron Kryetarin Haziri në këtë udhëtim, ishte edhe bashkëpunimi në mes qyteteve në fushën e zhvillimit ndërkombëtar. Në sesionin e mesditës, atë të Samitit të Lidershit Rinor, kreu i Gjilanit ishte i ftuar nderi dhe ligjërues kryesor. Para një audience studentësh

dhe pjesëmarrësish tjerë në konferencë, znj. Aveen Karim, drejtoreshë e konferencës, e paraqiti një biografi të shkurtër të kryetarit Haziri. “Jemi krenarë që sot para jush kemi një ligjërues nga një shtet i ri në Europë, një njeri që ia ka dedikuar një jetë të tërë kauzës së popullit të vet për liri e pavarësi. Sot kemi nderin e veçantë që në mesin tonë të kemi një kryetar komune, i cili, kur ishte zgjedhur kryetar për herë të parë ishte vetëm 29 vjeçar. Kemi një lider që shquhet për përkushtimin e tij, angazhimin e tij të pareshtur për të përmirësuar jetën dhe gjendjen e qytetit dhe shtetit të vet. Sot i jemi mirënjohës z. Lutfi Haziri që është me ne” ka thënë ndër të tjera Karim. Kryetari Haziri në ligjëratën e tij u fokusua në rolin që të rinjtë kanë dhe mund të luajnë në zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në mes shteteve, vendeve, dhe qyteteve. “Shpeshherë ju mund të ndiheni të pafuqishëm për t’u ballafaquar me sfidat që ju dalin përpara. Këto sfida mund t’ju duken të pakalueshme, shumë të

mëdha. Mirëpo, nuk ka asnjë sfidë të pakalueshme, asnjë problem pa zgjidhje. Se si ju i tejkaloni sfidat dhe i zgjidhni dilemat tuaja, do të definojë se kush jeni. Ajo që ju duhet është vullneti i mire, përkushtimi dhe angazhimi i singertë dhe me këtotribute ju do të mund të kaloni çdo sfidë dhe të zgjidhni çdo problem”, ka thënë Haziri. Ai tutje i është referuar përvojës së tij si udhëheqës politik dhe aktivistë në Kosovës gjatë okupimit, luftës, dhe në periudhën e pas çlirimit. Pas përfundimit të fjalës së tij, interesimi i pjesëmarrësve ka qenë i madh për t’i bërë pyetje kryetarit të Gjilanit. Diskutimi kështu ka vazhduar edhe pas përmbylljes së sesionit dhe në të është inkadruar edhe Xhevat Latifi, Drejtor Ekzekutiv i Qendrës së

Kosovës për Politika Publike, i cili ka folur në lidhje me rëndësinë e kultivimit të një qasje multi-kulturore në ndërtimin e urave lidhëse në mes shoqërive të ndryshme anekënd globit. Gjatë drekës, kryetari Haziri ka diskutuar edhe me Adam Kaplan, Zëvendës President i Sister Cities International për mundësinë e pranimit të Komunes së Gjilanit si anëtare e kësaj organizate. Ndryshe, Sister Cities International me seli në Washington DC, është themeluar me 1956 nga presidenti amerikan Dwight D. Eisenhower dhe tani për president Nderi ka presidentin aktual të SHBA-ve, Barack Obama. SCI është organizata më e madhe dhe më aktive e qyteteve në botë.

Në Gjilan ndërtohen dy salla sportive



20
KORRIK

Në Gjilan është vënë gurthemeli për ndërtimin e dy sallave sportive, njëra për shkollën “Abaz Ajeti” dhe tjetra për shkollën “Liria” në Pogradje. Në ceremoni kanë marrë pjesë ministri i Arsimit, Arsim Bajrami, ministri i Administratës Publike, Mahir Yakgjilar, nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, drejtori i Arsimit, Nazmi Musa dhe të tjerë. Ministri Bajrami ka thënë me këtë rast se sallat sportive për shkolla, janë më se të nevojshme për kulturën fizike, si degë e arsimit. Për më tepër, ai ka thënë se MASHT-i do të punojë në reformën shkollore dhe në ngritje të cilësisë në mësim. “Do të merremi me investime tek mësimdhënësit dhe nxënësit, sepse jemi në fazën e ndërtimit të shkollave cilësore. Duhet të ngrihet cilësia në edukim dhe arsimim, në përgjithësi”, ka thënë ai, duke shtuar se është koha që të krijohet shkolla të forta e cilësore dhe këto projekte janë në këtë funksion. Shkolla nuk është vetëm mësim-

dhënia, por shumë të rëndësishme janë edhe aktivitetet sportive, ka thënë Bajrami. Ndërsa, ministri i Administratës Publike, Mahir Yakgjilar, ka thënë se sallat sportive do të jenë të gatshme brenda 120 ditëve. “Palestrat sportive janë çështje të rëndësishme sa i përket zhvillimit edukativ dhe njerëzor”, tha Yakgjilar, duke bërë të ditur se departamenti i inxhinierisë do të jetë monitorues si në aspektin e cilësisë dhe atë kohor. Kurse, nënkryetari Rexhep Kadriu, ka thënë sallat e edukatës fizike u kanë munguar këtyre dy shkollave dhe komunitetit në këtë pjesë, sikur që për salla kanë nevojë edhe shumë shkolla të tjera. Deputeti Fatmir Rexhepi, ka thënë se në oborin e shkollës “Liria”, me dekada janë mbajtur gara nga më të ndryshme në nivel edhe të vendit, si në basketboll, hendboll dhe të tjera. Drejtori i Arsimit, Nazmi Musa, tha se projektet e tilla dëshmojnë për përkushtim që kemi ndaj arsimit.



Nis ndërtimi i rrugës së re në fshatin Përlepnice

21

KORRIK

Në fshatin Përlepnice, sot ka nisur ndërtimi i rrugës së re që lidh këtë fshat, respektivisht Komunën e Gjilanit me Komunën e Ranillugut, për të krijuar kushte për qarkullim më të shpejtë në drejtim të Kamenicës dhe pikës kufitare “Dheu i Bardhë”, por edhe mbështetje për biznesin privat. Nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, ka thënë se sipas prioriteteve të përcaktuara më herët nga kryetari Haziri, sot ka nisur ndërtimi i kësaj rruge të re, që lidhë komunat Gjilan dhe Ranillug, duke kaluar pranë kompleksit turistik “Vali Ranch”. Kjo arterie mund të shfrytëzohet nga qytetarët,

për të arritur më shpejt në pikën kufitare “Dheu i Bardhë”, apo për qarkullimin në drejtim të Kamenicës, ka thënë Kadriu. Ai po ashtu ka bërë të ditur se në prioritetet e kryetarit Haziri, është edhe mbështetja për biznesit privat dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Do të vazhdojmë me infrastrukturë në zonën industriale afër fshatit Cërnicë, Livoç i Epërm dhe të tjera, ka thënë Kadriu. Drejtori i Departamentit të Prokurimit, Salih Kqiku, ka thënë se rruga që ka nisur sot, ka një gjatësi mbi dy kilometra dhe një kosto financiare prej 350 mijë euro. Punimet duhet të përfundojnë brenda 60 ditëve.

Shefat e grupeve të këshilltarëve komunalë në konferenca shtypi

Aliu: Qëllimi ynë kryesor është interesi i qytetarit, jo i grupeve të ngushta

20

KORRIK

Shefi i grupit të këshilltarëve të LDK-së në Kuvendin Komunal të Gjilanit, Avdyl Aliu e ka vlerësuar të dobishme për qytetarët punën e vendimmarrësve komunalë në këtë gjashtëmujor. Në një konferencë me gazetarë, ai ka thënë se Kuvendi Komunal i Gjilanit kultivon një klimë të mirë dhe tolerante ndërmjet grupimeve politike, ku të gjithë kanë të drejta të njëjta si dhe hapësirë e mundësi të barabartë për pjesëmarrje në diskutime. Aliu tha se gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 6 seanca, 5 prej tyre të rregullta dhe një solemne, ku janë miratuar shumë vendime dhe janë anuluar shumë vendime të tjera, të përbërjes së kaluar, që siç tha ai, kanë qenë të kundërligjshme. Shefi i grupit të këshilltarëve të LDK-së, ka thënë se e gjithë puna e asamblesë komunale ka pasur si qëllim kryesor interesin e qytetarit dhe assesit interesin e ndonjë grupi të ngushtë. Ai e ka

vlerësuar të kënaqshëm edhe bashkëpunimin me ekzekutivin. “Ne kemi mënjeluar një të metë nga qeverisja e kaluar, ku për shkak të mungesës së këtij bashkëpunimi, në shumë raste ka pësuar qytetari”, ka thënë Aliu. Avdyl Aliu ka thënë se Kuvendi Komunal i Gjilanit do të vazhdojë me këtë ritëm dhe këtë klimë pune, duke synuar që gjithmonë të bëjë edhe më shumë për interesat e qytetarëve. Sa i përket punës së ekzekutivit, Aliu e vlerësoi disiplinën buxhetore, politikat zhvillimore, mirëqenien e qytetarit dhe mbi të gjitha kthimin e besimit të humbur te qeverisja. “Nuk dua të them se kjo që kemi bërë ne, është më e mira e mundshme, sepse ka mundësi të bëhet edhe më shumë, por e rëndësishme është se ka ndryshime pozitive në krahasim me të kaluarën”, ka thënë Aliu. Sa i përket opozitës, ai tha se do të donim të kishin më shumë alternativa, se sa kritika, për probleme të caktuara, megjithëse ka shprehur mirëkuptim për rolin që ka opozita. LDK përfaqësohet në Kuvend Komunal me 14 këshilltarë. Avdyl Aliu është shef i grupit.



Abazi (PDK): Si opozitë kemi qenë aktiv, alternativ dhe denoncues

21

KORRIK

Sahit Abazi, shef i grupit të këshilltarëve të PDK-së, ka vlerësuar se Kuvendi Komunal i Gjilanit i ka përmbushur obligimet e 6-mujorit të parë të këtij viti, në kuptimin sasior, sepse ka mbajtur numrin e mjaftueshëm të seancave, por jo edhe në kuptimin cilësor, sepse nuk ka bërë zgjidhje për nevojat e njerëzve. Në një konferencë me gazetarë, të organizuar nga Zyra për Informim, Abazi i ka numëruar të metat e kësaj qeverisje, por nuk i ka anashkaluar edhe punët e mira të saj. Sipas Abazit, problemi themelor ndërlidhet me ndryshimet e statutit, të cilat opozita nuk i ka votuar, duke kundërshtuar shuarjen e dy drejtorive, Kulturës dhe Inspektionit. “E kemi ditur se pa këto dy drejtori, do të ketë probleme”, ka thënë Abazi dhe ka përmendur problemin me Tetarin e Qytetit, ndërtimet pa leje, lumin Mirusha, që ka filluar kaheerë, por nuk po përfundon ende. Mirusha ka ngecur aty ku e ka lënë qeverisja e PDK-së, ka thënë Abazi, duke shtuar se nuk pret përfundimin e shpejtë të këtij projekti, sepse janë ndarë vetëm 150 mijë euro, që janë të pamjaftueshme. Njëherësh, ai ka thënë se ka edhe degradim të ambientit

nga deponitë ilegale si dhe të shtratit të lumit në fshatrat Livoç i Epërm dhe Livoç i Poshtëm. Sa u përket investimeve, Abazi tha se nuk ka pasur diçka konkrete, pos vizita të ministrave, të cilët kanë ardhur në Gjilan për të promovuar arnimin e rrugëve, duke krijuar një mashtrim optik tek qytetarët, ndërkohë që gjendja e rrugëve mbetet e keqe. Kryeopozitari Abazi ka thënë se depolitizimi i premtuar në administratë dhe arsim, nuk ka ndodhur, ndërkaq depresioni ekonomik në Gjilan, është rritur në krahasim me qeverisjen e kaluar. Abazi ka gjetur edhe gjera pozitive te qeverisja Haziri, duke nënvizuar punën e mirë që po bën Drejtoria e Bujqësisë dhe deri diku edhe Administrata dhe Shërbimet Publike, sikurse edhe nismën për ndërtimin e shtëpive për skamnorë. “Ne si opozitë i japim notë pozitive drejtorit të Bujqësisë”, ka thënë Abazi. Shefi i grupit të këshilltarëve të PDK-së, ka thënë se opozita është mundur të jetë konstruktive në punën e Kuvendit Komunal, por edhe kritike e denoncuese, aty ku është dashur. “Si opozitë jemi munduar të jemi aktiv, alternativ dhe denoncues”, ka thënë ai. Sahit Abazi, është shef i grupit.

Xhemajli (AAK): Do t'i përkrahim të gjitha çështjet që janë interesa të qytetarëve

22
KORRIK

Në vazhdim të konferencave të shefave të grupeve politike që përfaqësohen në Kuvend Komunal, është prezantuar Selami Xhemajli (AAK), i cili i ka shprehur vlerësimet e tij për punën e asamblesë dhe të ekzekutivit, për periudhën e parë të këtij viti. Kjo përbërje e Kuvendit Komunal është treguar funksionale, ligjore dhe e përgjegjshme kundrejt interesave të qytetarëve, ndërkohë që në të kaluarën ka pasur bllokada të Kuvendit, ka thënë Selami Xhemajli, shef i grupit të këshilltarëve të AAK-së. Xhemajli ka thënë se si anëtarë të Kuvendit Komunal kemi dhënë kontribut në konstituimin dhe funksionalizimin e asamblesë dhe trupave ndihmëse të saj, duke respektuar vullnetin e qytetarëve, edhe pa qenë ende pjesë e koalicionit qeverisës. Si grup i këshilltarëve dhe si subjekt politik, kemi treguar unitet në të gjitha çështjet që janë diskutuar në Kuvend. “Do t'i përkrahim të gjitha



çështjet që janë interes i qytetarëve”, ka thënë Xhemajli, duke nënvizuar se këtë do ta bënin edhe sikur të ishin opozitë. Xhemajli ka vlerësuar se Kuvendi Komunal i është përmbajtur agjendës së punës, por gjithmonë ka krijuar mundësi për trajtimin edhe të kërkesave të qytetarëve dhe të subjekteve tjera. AAK si pjesë e koalicionit qeverisës mban pozitën e nënkryetarit si dhe dy drejtori komunale. “Si grup i këshilltarëve kemi dhënë dhe vazhdojmë të japim kontributin tonë në mbështetje të projekteve që janë pjesë e programit qeverisës dhe veçmas përshëndesim uljen e shpenzimeve për luks, për çka Gjilani është një model i mirë i qeverisjes”, ka thënë Xhemajli. Ai ka përmendur edhe meremetimin e rrugëve, parkun në Dardani, prej nga vjen edhe vetë, duke thënë se në këtë lagje po bëhen investime për herë të parë gjatë kësaj qeverisje. Vlerësimet e tij për punën e Kuvendit i ka shfaqur edhe këshilltari Ibish Ibishi.



23
KORRIK

Vlerësimet e tij për punën e Kuvendit dhe të qeverisë komunale në Gjilan, i ka paraqitur të enjten edhe Nevzat Isufi, shef i grupit të këshilltarëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Fillimisht, ai e ka përshëndetur hapin që ka ndërmarrë Zyra për informim e Komunës, për të organizuar konferenca të tilla dhe ka kërkuar që kjo praktikë të vazhdohet edhe në të ardhmen. Ndërkaq, duke folur për rolin e subjektit të tij në vendimmarrjen komunale, Isufi tha se LVV është munduar të jetë bashkëpunuese e parimore në Kuvend, në trupat e tij, në komisione e kudo ku përfaqësohet.

Isufi (VV): Gjendja nuk është as e bardhë, as krejt e zezë

Vlerësimet e tij për punën e Kuvendit dhe të qeverisë komunale në Gjilan, i ka paraqitur të enjten edhe Nevzat Isufi, shef i grupit të këshilltarëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Fillimisht, ai e ka përshëndetur hapin që ka ndërmarrë Zyra për informim e Komunës, për të organizuar konferenca të tilla dhe ka kërkuar që kjo praktikë të vazhdohet edhe në të ardhmen. Ndërkaq, duke folur për rolin e subjektit të tij në vendimmarrjen komunale, Isufi tha se LVV është munduar të jetë bashkëpunuese e parimore në Kuvend, në trupat e tij, në komisione e kudo ku përfaqësohet.



Haziri në New York, takime me përfaqësues të komunitetit shqiptaro-amerikan dhe të OKB-së

24
KORRIK

Pas Washington, DC, kryetar i Gjilanit, Lutfi Haziri, njëherësh nënkryetar i LDK-së po qëndron në New York City. Ai dje ka takuar përfaqësues të biznesit nga komuniteti shqiptaro-amerikan, kurse sot ka pasur një takim në selinë e Federatës Pan Shqiptare të Amerikës “Vatra” ku është pritur nga përfaqësues të saj, Bushati, Balaj dhe Greca. Tek “Vatra”, Haziri me bashkëpunëtorë, është njoftuar me aktivitetin kombëtar të kësaj organizate, që nga themelimi, në fillim shekullin XX e deri më tani Haziri ka falënderuar bashkëkombësit për punën e tyre të madhe për kauzën kombëtare dhe ka biseduar me ta për mundësitë e bashkëpunimit për vazhdim të kësaj pune në të mirë të çështjes kombëtare e veçanërisht asaj në Kosovën Lindore. “Mbetet obligim yni moral dhe kombëtar që të punojmë me dinjitet për të arritur qëllimet e Nolit, Konicës dhe atdhetarëve tjerë që shënuan epokën e tyre me angazhim të pa rezervë në fushën kombëtare”, ka thënë Haziri. Ndërkaq, përfaqësuesi i “Vatrës” tha se “SHBA-të kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë një mik i madh e i sinqertë i Kosovës dhe për këtë, rol të jashtëzakonshëm ka diaspora jonë këtu”. Kryetari

Haziri ka bërë një vizitë të shkurtër edhe tek Konsullata e Përgjithshme e Kosovës në New York, ku është pritur nga konsulli Ylber Kryeziu, në mungesë të konsullit të përgjithshme Vlora Çitaku, e cila gjendet në pushime këto ditë. Pasdite, Haziri ka pasur takim edhe me një zyrtar të lartë të OKB-së me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e fundit në vend. Në ditën e dytë të vizitës zyrtare në Washington, DC, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pasur një takim të rëndësishëm me zyrtarë të lartë të Departamentit të Shtetit, duke përfshirë edhe z. Thomas Yazdgerdi, drejtor për Evropën Qendrore dhe Jugore. Në takim u biseduan disa çështje të rëndësishme nacionale për Kosovën dhe ndër më kryesoret ishte çështja e Gjykatës Speciale. Yazdgerdi shprehu insistimin e thellë të SHBA-ve, si miku më i madh dhe më kryesor i Kosovës, për themelimin e Gjykatës Speciale përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës. “Ne kërkojmë me ngulm që Gjykata Speciale të krijohet përmes institucioneve të Kosovës dhe besojmë se kjo do të ndodhë. Përndryshe, çështja do të mbetet në duart e OKB-së dhe Këshillit të Sigurimit dhe kjo nuk do të ishte fare e mirë për Kosovën,” ka

thënë Yazdgerdi. Tutje ai ka shtuar se “mos votimi eventual i Gjykatës Speciale nga Kuvendi i Kosovës do të vinte në pikëpyetje të madhe kredibilitetin e SHBA-ve, dhe ne këtë nuk e meritojmë nga Kosova”. Drejtori për Evropën Qendrore dhe Jugore në Departamentin e Shtetit, Thomas Yazdgerdi, tutje ka falënderuar kryetarin Haziri dhe LDK-në për përkushtimin e tyre për këtë çështje, duke kërkuar që të njëjtën gjë ta bëjë edhe partneri tjetër i koalicionit, z. Thaçi. Lutfi Haziri pasi ka falënderuar z. Yazdgerdi për përkushtimin dhe përkrahjen e pa rezervë të SHBA-ve ndaj Kosovës e ka siguruar atë se “Kosova është ballafaquar me sfida të vështira edhe në të kaluarën dhe me sukses i ka kaluar ato. Edhe kësaj radhe, unë besoj se Kosova do të dalë faqebardhë nga ky proces dhe Gjykata Speciale do të krijohet nga Kuvendi ynë”. Ai tutje ka shtuar se “ne jemi të vetëdijshëm për rëndësinë jetike që kanë marrëdhëniet e shkëlqyera në mes SHBA-ve dhe Kosovës dhe se asnjë politikan apo përfaqësues i denjë i popullit të Kosovës nuk do të merrte ndonjë vepër që do t’i lëndonte as edhe pak këto marrëdhënie”. Në fund, duke kujtuar bashkëpunimin e suksesshëm të tij me Hazirin që nga koha e bisedimeve për statusin në Vjenë, drejtori Yazdgerdi ka thënë se “esenca e lidershit të mirë e të suksesshëm mbërthen në vete marrjen e vendimeve të vështira dhe jopopullore, duke vënë në rend të parë interesin kombëtar dhe atë shtetëror para çdo interesi tjetër, duke përfshirë edhe atë personal apo partiak”. Në vazhdim të vizitës zyrtare që po realizon në SHBA, kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, sot ka pasur një takim shumë miqësor dhe të frytshëm në International City Management Association (ICMA) në Washington, DC, ku u pritë nga Damian George, drejtor për Evropë dhe Euroazi, dhe David Grossman, drejtor për Programe Globale. ICMA është organizatë e specializuar për përkrahjen e zhvillimit të qyteteve nëpër mbarë botën me një përvojë mbi njëqind vjeçare. Gjatë takimit, nikoqirët nga ICMA njoftuan kryetarin Haziri në lidhje me programet zh-

villimore dhe përkrahëse që po zhvillojnë nëpër shume vende të botës që janë në tranzicion ose në zhvillim e sipër. Kurse, nga ana e tij, Haziri i njoftoi përfaqësuesit e lartë të ICMA-së me prioritet e qeverisjes lokale në Gjilan si dhe zhvillimet më të rëndësishme të qeverisjes lokale në nivel të Kosovës. Nga ICMA, Haziri mori mbështetje të plotë për fillimin e bashkëpunimit në mes të Komunës së Gjilanit dhe ICMA në Washington DC, në realizimin e disa projekteve që konsiderohen me prioritet për qeverisjen lokale në Gjilan, siç është përgatitja e strategjisë për partneritet publiko-privat për projektin e trafikut urban, ofrimin e ndihmës së ekspertëve të ICMA në fushën e menaxhimit dhe reformës së qeverisjes lokale, inkuadrimin dhe përkrahjen e Komunës së Gjilanit në projekte bashkëpunuese ndërkombëtare e veçanërisht me qytete në SHBA, si dhe trajnime në ngritjen e kapaciteteve profesionale në menaxhimin lokal. Haziri dhe përfaqësuesit e ICMA u dakorduan që të bashkëpunojnë edhe në fillimin e një pilot programi për ndërtimin e strategjive investuese në projekte infrastrukturore në Gjilan. “Ne e shohim bashkëpunimin me ICMA si një mundësi shumë të mirë për realizimin e prioriteteve tona në qeverisjen e Gjilanit, gjithmonë duke i ofruar shërbime më kualitative qytetarëve tanë,” ka thënë Haziri. Ndërsa, Faton Bislimi, ligjërues në Universitetin e Albertës, dhe Xhevat Latifi nga Qendra e Kosovës për Politika Publike, që shoqëronin Hazirin në këtë takim, folën për rëndësinë e fushës së zhvillimit ekonomik lokal dhe atë të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve lokale dhe shoqërisë civile. Në fund, z. Grossman dhe z. George kanë shprehur përkushtimin e tyre dhe të ICMA-s për të filluar menjëherë bashkëpunimin me Gjilanin dhe kanë falënderuar të pranishmit e veçanërisht kryetarin Haziri për angazhimin e tij të pa rezervë në këtë drejtim. Ata po ashtu e kanë ftuar kryetarin Haziri që të jetë prezentë në konferencën vjetore ndërkombëtare të ICMA-s, e cila, do të mbahet në Seattle, SHBA në shtator 2015.



Koncert i madh festiv për bashkatdhetarët

25
KORRIK

Komuna e Gjilanit, ka organizuar gjatë mbrëmjes koncertin e madh për bashkatdhetarët tanë që gjenden në botën e jashtme prej vitesh, por që për Gjilanin përherë ishin një mbështetje e fuqishme ekonomike. Nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, ka thënë se këto aktivitete po organizohen për nder të bashkatdhetarëve tanë të shumtë, në shenjë respekti për kontributin e madh që kanë dhënë për vendlindjen e tyre. “Gjilani, që nga dy korriku e deri më një gusht do të zhvillojë aktivitete

për mërgimtarët, për t’i bërë ata që ndihen sa më mirë në shtëpitë e tyre”, ka thënë Kadriu. Ai ka shtuar se madhështia e Gjilanit dhe gjallëria shihen më së shumti gjatë pushimeve verore, kur numër i madh i gjilanasve në diasporë vijnë për pushime në vendlindje, pranë pjesës tjetër të familjes. Me hapjen e këtij koncerti, ka nisur edhe aktiviteti tashmë tradicional “Beer and wine festival”, ku prodhimet e birrës do të ekspozohen për tri ditë me radhë, për të kulmuar me koncertin e madh festiv, që do të mbahet më 1 gusht, në qendër të qytetit.



Haziri: Amerikanët e kanë ruajtur jetën dhe sigurinë e qytetarëve tanë me trupat e tyre

28
KORRIK

Komuna e Gjilanit në koordinim me organizatën “Agro-Eko” ka organizuar sot “Ditën e Kulturës së SHBA-ve” në të cilën ka marrë pjesë kreu i Komunës, Lutfi Haziri, përfaqësues nga jeta institucionale e kulturore. Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, tha se kjo po bëhet në shenjë falënderimi për ndihmën e madhe që SHBA-të kanë dhënë për vendin tonë, sikurse edhe për bashkatdhetarët tanë. “Në kuadër të programit për mërgimtarët, ne do të shënojmë të gjitha aktivitetet që lidhen me kulturën e shteteve mike. E filluam me Japoninë, njëra nga shtetet që e ka pranuar shpejt Pavarësinë e Kosovës dhe e cila është njëra nga donatorët më të mëdhenj në Kosovë. Ky është viti i parë dhe natyrisht që do të vazhdojmë ta pasurojmë programin e akti-

viteteve dhe i përkushtohet bashkatdhetarëve tanë që jetojnë në Amerikë, atyre që kanë bërë shumë për Kosovën dhe për Gjilanin në veçanti. Ju lus që ky solidaritet i yni të pranohet vetëm si falënderim për njerëzit që nuk e kanë harruar asnjëherë Gjilanin”, ka deklaruar Haziri. Ai tha se Kosova dhe Gjilani e kanë listën jashtëzakonisht të madhe dhe se nuk duhet harruar asnjërin nga shtetet mike. “Ne jemi të njohur me hartën gjeo-politike si sektor amerikan në Kosovë me bazën më të madhe ushtarake jashtë Amerikës, ”Bonsteel” dhe “Monteith”, të cilët kanë ruajtur jetën dhe sigurinë e qytetarëve tanë me trupat e tyre. Duhet ta theksojmë se Kosova e ka listën e miqve jashtëzakonisht të madhe dhe nuk mund ta harrojmë askënd”, tha ai.



Gjilani ka nevojë për miq e partnerë

30
KORRIK

Kuvendi Komunal i Gjilanit ka mbajtur të enjten seancën e radhës, nën drejtimin e kryesueses Valentina Bunjkau-Rexhepi, ku kryetari i Komunës, Lutfi Haziri ka paraqitur raportin 6-mujor të punës, në të cilin pasqyrohen të gjitha aktivitetet, sukseset dhe sfidat e kësaj periudhe. Vizitat në SHBA dhe shtetet tjera, kryetari Haziri i ka vlerësuar të nevojshme për komunën e Gjilanit, duke thënë se Gjilani ka nevojë për miq dhe për partnerë. Ndërkaq, duke iu përgjigjur pyetjeve dhe interesimeve të këshilltarëve komunalë, Sahit Abazi (PDK), Fehmi Sylejmani (VV), Riad Rashiti (PDK), Bujar Nevzati (PDK), Nevzad Isufi (VV) Krenare Latifi (VV), Leonora Bunjaku (PDK), Izmi Zeka (PDK) dhe të tjerë, rreth vizitave të tij jashtë, dezinfektimit, projektit të shkollave të mesme, lumin Mirusha, riparimin e rrugëve dhe të tjera, Haziri ka thënë se 17 projekte nga qeverisja e kaluar janë gjetur të papërfunduara, përfshirë edhe lumin Mirusha dhe Kodrën e Dëshmorëve. “Mirusha është projekt i qeverisë qendrore, që ne e kemi trashëguar të lënë në gjysmë dhe tani kemi nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për ta marrë udhëheqjen e këtij projekti. “Ne po punojmë me qeverinë austriake në një program për trajtimin e tërësishëm të ujërave të zeza, që ka vlerën 7 milionë euro, ku përfshihet Mirusha, Stanishorka dhe Baja”, ka thënë Haziri, duke shtuar se ky problem zgjidhet përfundimisht me ndërtimin e një kolektori. Sa i përket dezinfektimit, Haziri ka thënë se deri tani janë kryer dy faza dhe ka mbetur edhe faza e tretë, e cila do të monitorohet shumë rreptë nga komisioni. Kompleksi i shkollave të mesme është në proces të mbylljes dhe shumë shpejt do të hyjmë në procesin e kontraktimit dhe fillimit të realizimit të këtij projekti, ku është bërë vetëm një ndërhyrje te rruga që kalon përmes kësaj qendre. Kurse vizitat në SHBA dhe shtetet tjera, kryetari Haziri i ka vlerësuar të nevojshme për komunën e Gjilanit, duke thënë se Gjilani ka nevojë për miq

dhe për partnerë. Rezultat i këtij partneriteti është edhe projekti për ndërtimin e çerdhes në lagjen “Dardania”, për të cilin USAID-i ka ndarë 200 mijë dollarë dhe nevojitet një participim edhe prej Komunës. Te partneriteti publiko-privat e kemi bërë një prerje, për të bërë një vlerësim të këtij procesi, sepse komunat nuk mund të hyjnë në partneritet për banim, siç ka ndodhur më herët, ka thënë kryetari Haziri, duke nënvizuar se te rasti i kompanisë “Ecohigjiena” po bëhet një prerje e obligimeve. Kuvendi miratoi edhe raportin financiar janar-qershor 2015, të cilin e paraqiti Ilmi Limoni, drejtor financiar. Zijadin Maliqi (LDK) tha se të hyrat janë pak a shumë të njëjta me ato të periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa te shpenzimet vërehet një tendencë e uljes te mallrat dhe shërbimet, kurse Riad Rashiti (PDK) tha se ka një rënie tek të hyrat, derisa shpenzimet janë të njëjta me vitet e kaluara. Krenare Latifi (VV) ka thënë se te mallrat dhe shërbimet ka rritje të shpenzimeve. Sa u përket shpenzimeve të faturuar në emër të zyrës së kryetarit, Haziri ka sqaruar se bëhet fjalë për trajnime të 17 zyrtarëve komunalë dhe nuk janë shpenzime që i ka krijuar ai personalisht. Në këtë seancë, Kuvend Komunal ka miratuar vendimin për emërtimin e QKMF-së me emrin e mjekut Nagip Rexhepi, ku opozita (PDK) ka abstenuar, duke mos u pajtuar me procedurat e ndjekura, që në të vërtetë ishte një iniciativë qytetare. Kuvendi miratoi edhe vendimin për participim në ndërtimin e çerdhes në lagjen “Dardania”, pastaj shfuqizimin e vendimit 01.Nr.16-24249 dhe vendimit 01.Nr.16-24255 të datës 15.03.2013, vendimin për emërimin e Komisionit për përcaktimin e lokacioneve dhe hapësirave publike për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve, brenda territorit të Komunës së Gjilanit si dhe vendimin për emërimin e Këshillit komunal për vlerësimin e meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjilanit, tërësia etnike shqiptare dhe më gjerë. Anëtarët e Kuvendit janë informuar edhe rreth manifestimit “Flaka e Janarit 2015”, nga shefi i Njësisë për Kulturë, Bujar Haziri si dhe janë njoftuar për aktivitetin gjashtëmujor të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Valentina Bunjaku Rexhepi, ka thënë se kjo ishte mbledhja e fundit për pjesën e parë të vitit, ndërkohë që Kuvendi Komunal do të vazhdojë punën e rregullt në shtator, por gjithmonë do të jetë i gatshëm që të mblidhet nëse paraqitet nevoja dhe e kërkon interesi i qytetarëve. Në këtë periudhë, Kuvendi Komunal ka mbajtur 5 seanca të rregullta, ku ka miratuar 41 vendime si dhe ka mbajtur një seancë solemne. Përndryshe, ajo e ka vlerësuar se Kuvendi Komunal i Gjilanit ka punuar në një klimë demokratike, që janë vlera të kësaj vendimmarrje dhe kështu do të vazhdojë edhe në të ardhmen, ka thënë Bunjaku-Rexhepi. Kryesuesja e Kuvendit tha se është e kënaqur edhe sa i përket bashkëpunimit me subjektet politike si dhe me shefat e grupeve të këshilltarëve në Kuvend Komunal.



Bunjaku-Rexhepi: Në Kuvendin e Gjilanit ka hapësirë të gjerë për debat

30
KORRIK

Gjatë periudhës së parë të këtij viti, Kuvendi Komunal i Gjilanit ka mbajtur 5 seanca të rregullta, në të cilat ka shqyrtuar shumë çështje me interes për qytetarët si dhe ka miratuar 41 vendime, ku edhe opozita ka qenë pjesëmarrëse aktive në debat dhe në disa raste edhe në vendimmarrje. Kështu ka thënë Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, në një konferencë me gazetarë, ku ajo ka folur për aktivitetin e organit vendimmarrës në periudhën e parë të këtij viti, që të enjten ka mbajtur seancën e korrikut, ku është diskutuar puna 6-mujore e qeverisjes komunale si dhe janë miratuar disa vendime. “Ne vlerësojmë se në Kuvendin Komunal të Gjilanit është krijuar një klimë demokratike për debat dhe punë, që janë vlera të kësaj vendimmarrje dhe kështu do të vazhdojmë edhe në të ardhmen”, ka thënë Bunjaku-Rexhepi, duke nënvizuar se në disa raste janë futur në rend dite për shqyrtim edhe pika që janë propozuar nga opozita. Kryesuesja e Kuvendit ka thënë se është e kënaqur

edhe sa i përket bashkëpunimit me subjektet politike si dhe me shefat e grupeve të këshilltarëve në Kuvend Komunal. “Shpeshherë e kam toleruar opozitën të marrë kohë më shumë se sa lejon rregullorja e punës së Kuvendit”, ka thënë ajo. Ajo u shpreh e kënaqur edhe me transparencën, duke thënë se Zyra për Informim ka bërë një prezantim mjaft të mirë të angazhimeve edhe të opozitës në Kuvend Komunal. Sa i përket koalicionit, Valentina Bunajku-Rexhepi, ka thënë se LDK-ja nuk ka problem me numra në Kuvend Komunal, sepse e vetme i ka 14 mandate, por ka treguar vullnetin e saj për ta ndarë qeverisjen me partnerët tjerë, për të respektuar edhe vullnetin e qytetarëve. Përndryshe, ajo ka thënë se Kuvendi Komunal i Gjilanit ka themeluar edhe dy komitete të reja, Komitetin për Barazi Gjinore, që është i pari i këtij lloji në Kosovë, si dhe Komitetin për Bashkëpunim Ndërkufitar, ndërkohë që i ka inkurajuar femrat të jenë më aktive në vendimmarrje dhe politikë-bërje dhe të mos kënaqen me përfaqësimin e garantuar



Haziri: Po punojmë që t'i përngjajmë një Komune të Austrisë për nga kualiteti i jetesës

30
KORRIK

Në kuadër të programit për mërgimtarët, Komuna e Gjilanit në organizim të përbashkët me organizatën “Agro-Eko”, ka shënuar “Ditën e Kulturës Austriake”. Në ngjarje i pranishëm ka qenë kryetari Lutfi Haziri, përfaqësuesja e Ambasadës së Austrisë në Kosovë, Vjosa Huruglica, kryeshefi i kompanisë “Ecohigjiena”, Senad Rama, përfaqësuesi i shoqatës austriake-kosovare, Arsim Vranovci, e qytetarë të shumtë. Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryetari Lutfi Haziri, ka falënderuar shtetin austriak për ndihmën e dhënë Kosovës dhe Gjilanit në veçanti. “Austria është ndër shtetet mike dhe partnere të mëdha të Gjilanit, jo vetëm për shkak të numrit të madh të shqiptarëve që jetojnë atje, por për shkak të prezencës së tyre këtu me ushtarë në Kosovë, me biznese në Gjilan drejtpërdrejt dhe mbi të gjitha, njerëzit e Gjilanit punojnë për misione, kompani dhe për institucionet e Austrisë në Gjilan. Po presim që Austria përfundimisht të fillojë programin e madh shtatë milionë euro për Gjilanin, program i qeverisë së Kosovës

dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, i cili do t'i zgjidh problemet e ujërave të zeza, vadave, kanalizimeve, në mënyrë që gradualisht t'i përngjajmë jetës së një Komune Austriase”, tha ai. Në emër të ambasadorit të Austrisë në Kosovë, Johann Brieger, të pranishmit i ka përshëndetur Vjollca Huruglica, e cila e ka falënderuar Komunën e Gjilanit për shënimin e “Ditës Kulturore të Austrisë”. “Austria është një vend mik i Kosovës dhe ndër vendet e para që e ka njohur Pavarësinë e Kosovës. Ky shtet vazhdon ta përkrah vazhdimisht Kosovën dhe është njëri nga investitorët më të mëdhenj në Kosovë në aspektin ekonomik me një shumë rreth 260 milionë euro investime”, tha Huruglica. Arsim Vranovci, nga shoqata “austriake-kosovare”, ka falënderuar Komunën për këtë iniciativë, ndërsa theksoi se janë duke organizuar ditët e turizmit austriak në Kosovë, ku Gjilani do të jetë si një pikë promovimi. Programi do të vazhdojë edhe në mbrëmje, ku qytetarët do të kenë mundësi t'i shijojnë produktet austriake.



“Ditët e Mërgatës” pasurohen me panairin e prodhimeve vendore

30
KORRIK

Komuna e Gjilanit bashkatdhetarët i ka pritur me aktivitete të ndryshme, për t'u ofruar atyre produktet vendore, duke organizuar panairin e prodhimeve vendore në fillim të muajit korrik, pastaj aktivitete të ndryshme kulturore dhe argëtuese, duke bërë shënimin e ditëve të shteteve mike nëpër botë, për ta përfunduar këtë muaj, po ashtu me një "Panaxhyr" të prodhimeve vendore në shënim të "Ditëve të Mërgatës" - "Gjilani 2015", në kuadër të të cilit për tri ditë radhazi do të ketë edhe program kulturo-artistik dhe argëtim për bashkatdhetarët. Me këtë rast, në fjalën e tij hapëse, kryetari Lutfi Haziri, ka thënë se këtyre ditëve jemi duke u takuar shumë shpesh për të promovuar programe, aktivitete dhe shënime të veçanta në Komunën e Gjilanit. "Kemi dalë shumë shpesh këtyre ditëve para Teatrit për të promovuar dhe ndarë bashkërisht programe, aktivitete dhe shënime të veçanta. Sot po ndodhë një përsëritje e mirë e "Panaxhyrit", i cili, me prodhimet e veta, kryesisht në ushqim dhe prodhime të tjera, paraqet para të gjithë juve, e në veçanti para mërgimtarëve, potencialet e mundësitë tona, mbi të gjitha për t'u njohur me prodhimet vendore të Komunës së Gjilanit", ka thënë kryetari Haziri, duke uruar që këto tri ditë për prodhuesit

të jenë më tepër një promovim i produkteve të veta dhe i shitjes së tyre normalisht. Haziri ka thënë se kjo vapë e madhe në Gjilan, do të kalohet më lehtë me freskinë e shënimin të ditëve kulturore që në vazhdimësi do të jetë dita kulturore e shtetit të Austrisë, pastaj do të vazhdojmë me shtetet nordike dhe do të përfundojmë me 1 gusht me shënimin e "Ditës Kulturore të Zvicrës", e cila e shënon në këtë datë Ditën e Shtetësisë. "Çdo vit do të jetë më i zgjeruar "Panaxhyri" dhe do të jetë ditë e kalendarit festiv për Gjilanan", ka thënë kryetari Haziri. Ndërsa, drejtori për Zhvillim Ekonomik, Ismajl Januzi, që është organizator i këtij panairi me rastin e "Ditëve të Mërgatës", ka thënë se panairi të tilla do të organizohen sa herë që të ketë kërkesë dhe nevojë komuniteti i biznesit. "Këtë muaj e kemi nisur me panairin e prodhimeve të regjionit, për t'u mundësuar bashkatdhetarëve tanë të njihen me prodhimet vendore dhe po e përfundojmë pikërisht për "Ditët e Mërgatës", sepse edhe kërkesë e komunitetit të biznesit janë organizime të tilla. Është një mundësi e mirë që prodhuesit të shesin dhe blerësit, e me theks të veçantë bashkatdhetarët, të kenë mundësinë e blerjes së produkteve vendore të gjitha në një vend, në panair, në qendër të Gjilanit", ka thënë Januzi.



Në lagjen Dardania nis ndërtimi i parkut rekreativ- sportiv

05
GUSHT

Në lagjen Dardania ka nisur ndërtimi i parkut, ku parashihet të ketë amfiteatër, fushë futbollit, terrene sportive, fontanë dhe sistem të ujitjes, ndriçimin publik, trotuare dhe kënde të lojërave për fëmijë, zona të gjelbra, ulëse për pushim, elemente të tjera rekreative dhe sportive. Projekti realizohet përmes programit “Kosova e Bukur II”, financuar nga Komisioni Europian dhe Komuna e Gjilanit dhe ofron 92 vende të reja pune, përfshirë 65 persona që do të angazhohen përmes Qendrës për Punësim. Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se ky projekt do ta ndryshojë përgjithmonë këtë lagje. “Jam shumë i lumtur që po nisim sot ndërtimin e këtij parku modern, i cili ka efekte edhe në punësim”, ka thënë Haziri. Ai po ashtu tha se këtë park do ta gëzojnë një numër shumë i madh i qytetarëve, duke nisur nga fëmijët, të moshuarit, familjarët dhe nuk do të ketë më zhurmë apo shitje ilegale të druve, shtazëve dhe materialeve tjera në këtë hapësirë. Ndërsa, Kristof Shtok, drejtor i Unionit Evropian në Kosovë, ka thënë se është një kënaqësi e madhe që në këtë vend po ndërtohet një park rekreativ dhe sportiv. “Kosova e Bukur” si program ka një komponentë shumë të mirë, që është punësimi”, ka thënë ai. Shumica e personave janë njerëz që kanë pritur kohë të gjatë për një vend pune. “Në fund të vitit, do të jemi këtu për të promovuar projektin dhe do të luajmë një lojë voleybolli apo basketbolli së bashku”, tha Shtok. Nga ky projekt që kap vlerën rreth 240 mijë euro, do të përfitojnë 75 mijë banorë të Gjilanit, të cilët nesër mund të jenë shfrytëzues të këtij mjedisi rekreativ.



Almook do të bëjë revolucion, njëjtë sikur teknologjia informative

05
GUSHT

Në Gjilan, është hapur sot qendra e parë inovative, e cila ka për qëllim bashkimin në një shtëpi të të interesuarve pas teknologjisë së informacionit. Krijimi i kësaj qendre inovative, Almoooc Innovation Center AIC, është risi në vetvete për rajonin lindor të Kosovës, jo vetëm për faktin që është e para në llojin e vet në këtë rajon, por për arsye se ajo dallon nga modeli i funksionimit dhe bashkëpunimit që mundëson me SHBA-në. Me këtë rast, në hapjen e kësaj qendre ishte edhe kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, i cili ka thënë se në Gjilan po fillohet me këtë qendër të re, e cila do të sjellë ndryshimin e madh pozitiv drejt teknologjisë moderne. “Sikur që teknologjia sjell revolucion dhe ndikon në zhvillimin ekonomik të një vendi, ashtu edhe kjo qendër dhe ALMOOK-u do të bëjnë një revolucion në këtë pjesë të Kosovës. Nga viti i ardhshëm Komuna do të ndaj fond të veçantë për të ndihmuar të rinjtë të ecin në hap me teknologjinë”, ka thënë kryetari Haziri, duke falënderuar bashkatdhetarin tonë që jeton në Amerikë, Ridvan Aliu i cili drejton ALMOOK dhe EDUonGo. “Jemi me fat që kemi një gjilanas që sot kthehet me projektin Almoooc dhe këtë qendër që sot po inaugurojmë”, u shpreh Haziri. Ndërsa drejtori ekzekutiv, Ridvan Aliu,

rikonfirmoi përkushtimin e tij dhe të ekipit për ofrimin e arsimit cilësor për kosovarët në fushën e programimit dhe kodimit. “Jam i lumtur që sot po bëjmë bashkërisht hapjen e kësaj qendre që u mundëson studentëve të rinj dhe në përgjithësi talenteve ofrim të kushteve në arsimin cilësor në fushën e programimit dhe kodimit. Sipërmarrësit e rinj në lëmin e teknologjisë do të kenë mundësi të prezantojnë para investitorëve amerikanë shpikjet e tyre përmes kompanisë sonë, ka thënë Aliu. Kurse, Steven Yee, menaxher i lartë në EDUonGo, ftoi të rinjtë që t’i përgjigjen në mënyrë masive ftesës që i bënë tregu ndërkombëtar, ku vetëm në Amerikë, deri në vitin 2020, do të nevojiten mbi 1 milion programerë të rinj. Ndryshe, kjo qendër fuqizohet drejtpërdrejtë nga platforma EDUonGo për avancimin e mësimin në distancë nga shteti i Washingtonit dhe vjen tek të rinjtë kosovarë me një kurrikulë të avancuar të përmbledhur në paketën Almoooc, ku të interesuarit mund të gjejnë materiale, kurse dhe leksione të fjalës së fundit të teknologjisë në gjuhën shqipe. Përtej mësim-nxënies dhe përditësimit shkencor të vazhdueshëm, të rinjtë mëndjehapur gjejnë edhe mundësinë e artë të sfidohen në krijimin e startup-ve apo kompanive lokale përmes së cilave sigurojnë edhe punësim.



Trashëgimia Kulturore në Gjilan do të ketë mbështetjen e plotë të qeverisë

06
GUSHT

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri ka pritur në një takim pune zëvendësministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Rexhep Hoti, me të cilin ka biseduar për mundësinë e investimeve në këtë fushë, në mbrojtje dhe restaurim të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe promovimin e tyre. Haziri dhe Hoti kanë vizituar punimet në objektet e trashëgimisë kulturore, si në Muzeun e Gjilanit, në shkollën e Muzikës dhe në të njëjtën kohë kanë vizituar edhe xhaminë Atik. Me këtë rast kryetari Haziri ka thënë se pas zv/kryeministrit Kujtim Shala, i cili është njoftuar saktësisht me nevojat e mëdha që ka Gjilani në fushën e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, ardhja e zv/ministrit, Rexhep Hoti, dëshmon për një përkujdesje të shtuar për Gjilanin. “Bashkërisht me zv/ministrin Hoti vizituam Muzeun e qytetit, shkollën e Muzikës, ku është duke u punuar dhe gjithashtu vizituam edhe Atik-xhaminë si dhe objekte të tjera që janë nën përkujdesjen dhe mbrojtjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, tha ndër të tjera Haziri. Ai tha se gjatë vitit të ardhshëm është propozuar të bëhet renovimi edhe i atik-xhamisë, e cila si ndërtim korrespondon me vlera fetare dhe kombëtare. “Ky objekt

i ndërtuar me elemente fetare dhe kombëtare, ndër më të vjetrit në Gjilan, që është nën mbrojtje, do të rinovohet dhe mirëmbahet, duke i kthyer pamjen origjinale, sepse e ardhmja e Gjilanit është më e mirë vetëm duke ruajtur dhe mbrojtur trashëgiminë kulturore”, tha ai. Nga ana e tij, zv/ministri Rexhep Hoti, ka thënë se Gjilani, së bashku me Prizrenin, kanë një qytetari dhe kulturë të veçantë që kulmon me vlera të shoqërisë sonë, me shumë vlera të trashëgimisë kulturore e historike të gërshtuara në diversitet kulturor. “Jam njoftuar nga kryetari Haziri për nevojën e madhe të përkujdesjes që kërkojnë objektet e trashëgimisë kulturore. Ne jemi sot këtu që ta forcojmë edhe më shumë 1.5 milionëshin e ofruar nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në mënyrë që të ecim përpara, sepse pos trashëgimisë dhe historisë, Gjilani ka edhe një karakteristikë të veçantë, atë të diversitetit kulturor. Kjo është një vlerë që në të ardhmen do të kemi mundësinë të prezantojemi çdo kund. Prandaj ne kemi mundësi që përmes trashëgimisë kulturore të nxjerrim vlera, çoftë nga nëntoka apo nga ndërtimet e vjetra antike për t’i ofruar botës së sotshme, vlera të mirëfillta të një qytetërimi shumë të lashtë”, tha Hoti.



Heliporti i parë në Kosovë hapet në Gjilan

06
GUSHT

Në Kompleksin turistik “Vali Ranch” në Gjilan, është hapur heliporti i parë ndërkombëtar në Kosovë. Me këtë rast, kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, ka thënë se mërgimtari Fehmi Fetahu ka dëshmuar më së miri se si duhet të investohet në vendlindje dhe se si kthehet vëmendja drejt punëve të mira. “Gjilani dhe Anamorava sot kanë heliportin e parë, i cili do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve. Ky helikopter, nuk është vetëm për atraksion, por edhe për nevoja tjera. Heliporti i plotëson të gjitha standardet për operimin e aviacionit ndërkombëtar civil, por edhe për nevoja të brendshme”, ka thënë ndër të tjera kryetari Haziri. Pronari i kompleksit turistik “Vali Ranch”, Fehmi Fetahu, ka thënë se ndjehet shumë i lumtur që heliporti i parë në Kosovë po hapet në Gjilan, në resorin e tij turistik. “Kjo është një krenari shumë e madhe për ne, për regjionin dhe Kosovën, sepse ky heliport është në shërbim të qytetarëve. Jam krenar për investimet që kam bërë në Kosovë. Kompleksi turistik ka prej kuajve deri te helikopteri më modern”, ka thënë Fetahu. Kurse Burim Dinarama, drejtor i Departamentit të Aerodromeve, pranë autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, ka thënë se në dukje është një heliport i vogël, por për Kosovën është shumë i madh. Në ceremoni kanë marrë pjesë edhe zëvendës ambasadori i Hungarisë në Prishtinë, kryetari i Komunës së Ranillugut si dhe zyrtarë tjerë nga niveli qendror dhe lokal. Hapjen simbolike të heliportit, përmes një fluturimi të përbashkët e kanë bërë kryetari i Gjilanit, kryetari i Ranillugut, drejtori i aerodromeve, zëvendës ambasadori dhe pronari i kompleksit turistik.

Haziri riorganizon qeverisjen, emëron pesë drejtorë

07
GUSHT

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në një konferencë për media, ka prezantuar ndryshimet në disa drejtori, duke paralajmëruar ndryshime edhe në nivelin tjetër të menaxhimit, në mënyrë që të përmirësojë edhe më tepër qeverisjen komunale. Ai ka thënë se ndryshimet janë rezultat i vlerësimit të punës dhe angazhimeve, të cilat janë monitoruar me kujdes të veçantë deri tani, duke shtuar se për këtë riorganizim janë pajtuar edhe partnerët qeverisës. Kryetari Haziri ka bërë të ditur edhe emrat e drejtorëve të emëruar: Në krye të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Banimit është emëruar Naser Korça (LDK), i cili për disa vite udhëheq



sektorin e Teknologjisë Informative dhe Logjistikën në Ministrinë e Pushtetit Lokal. Në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, është emëruar magjistrin i shkencave sociale, Nexhat Hajrullahu (LDK). Në Drejtorinë e Financave, është emëruar Zijadin Maliqi (LDK), profesor i ekonomisë, njohës i mirë i problemeve buxhetore. Në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, është emëruar një kuadër i ri, Enzar Kadriu (PD). Te Zhvillimi Ekonomik, është emëruar Agim Zuzaku (AAK), njohës i mirë i politikave të partneritetit publiko-privat dhe i zhvillimit ekonomik lokal. Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri ka falënderuar drejtorët e deritashëm.



07
GUSHT

Në një konferencë për media, drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Ramiz Ramadani, ka njoftuar se fushata e korrje – shirjeve ka përfunduar me sukses. “Nevojat e banorëve të komunës plotësohen mbi 60 për qind nga rendimentet e kësaj vere”, ka thënë Ramadani. Prej mbi 2.800 hektarëve të mbjellë me grurë, janë siguruar 11.631 tonë drithëra. Ai ka thënë se çmimi i korrjes prej 110 euro për hektar, është respektuar nga kombat

Korrje – shirjet: Aq sa është pritur

jnerët. Për dhjetë ditë është përfunduar fushata në terrenet e rrafshëta, që përbëjnë 90 për qind të mbjelljeve të sivjetme, për të vazhduar pastaj në terrenet kodrinore – malore, ku rendimentet janë më të ulëta. Në terrenet e rrafshëta, rendimenti mesatar është 4380 kg/ha, kurse në viset kodrinore – malore, sillet nga 2800-4000 kg/ha. Rendimenti mesatar i grurit në nivel komunal, është 4154 kg/ha. “Rendimentet mesatare janë brenda pritjeve tona”, tha ai.



Bujqësia potencial për punësim dhe mirëqenie familjare

10
GUSHT

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga nënkryetari dhe bashkëpunëtorë të tjerë, kanë vizituar plantacionin e prodhimeve të mollës dhe dardhës të pronarit Sali Haliti, në fshatin Capar, i cili ka punësuar tërë familjen në këtë biznes. Me këtë rast, kryetari Haziri ka thënë se kjo familje është shembulli më i mirë i punës. “Fshati Capar dhe Gjilani, në përgjithësi, kanë tokë,

traditë e potencial që të kultivojë produkte nga më të ndryshmet, duke nisur nga molla dardha e deri te duhani. Shembullin e kësaj familje duhet ta ndjekin edhe fermerë të tjerë, sepse kështu sigurohen të ardhura dhe punësim”, tha kryetari Haziri. Ndërsa pronari Sali Haliti ka thënë se nga ky investim ka siguruar të ardhura dhe punësim për familjen. Haliti planifikon që në të ardhmen t’i zgjerojë sipërfaqet e mbjella me pemë.

Ndërtohet infrastruktura në Shillovë

11
GUSHT

Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komuna e Gjilanit, janë duke realizuar projektin për rehabilitimin e rrugëve në fshatin Shillovë, i banuar nga komuniteti serb. Vlera e kontratës, është afër 40 mijë euro. Nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, ka thënë se në vazhden e investimeve në infrastrukturën publike në Komunën e Gjilanit, këtu në fshatin Shill-

ovë po asfaltohen rrugë dhe po rregullohet edhe sistemi i kanalizimit dhe ujësjellësit. “Kështu do të vazhdohet edhe në pjesët tjera të qytetit dhe fshatrave, ku së pari do të rregullohet infrastruktura nëntokësore dhe pastaj do të asfaltohen rrugët”, ka thënë nënkryetari Kadriu. Ai ka thënë se do të shqyrtohen të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe ato do të realizohen sipas prioriteteve dhe në bazë të mundësive buxhetore.



Haziri konfirmon mbështetjen dhe pjesëmarrjen për aktivitetet e rinisë

12
GUSHT

Në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, kryetari i Komunës së Gjilanit ka pritur në një takim të rinjtë organizatë “Climb Up” dhe klubin e çiklistëve të Gjilanit, për tu dhënë mbështetje dhe konfirmimin e tij për pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar “Gjilani bike”, ku qëllim ka përdorimin sa më të madh të biçikletave dhe largimin nga përdorimi i shumtë i veturave. Me këtë rast kryetari Haziri i ka dhënë mbështetje aktivitetit “Gjilani bike”, duke konfirmuar edhe pjesëmarrjen e tij dhe të stafit në kuadër të këtij aktiviteti për promovim të qarkullimit me biçikleta, por edhe dhurim të gjakut. “Sot në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, kam pritur në një takim të rinjtë që janë organizator të aktivitetit “Gjilani bike” ku përfshihen disa ngjarje nga dhurimi i gjakut në ditën e nesërme e deri tek udhëtimi për eksplorimin e bukurive natyrore dhe monumenteve historike të shumta që ka Gjilani. Komuna e Gjilanit do ta mbështesë këtë aktivitet dhe do t’i bashkëngjitet vetëdijesimit, qëllim i cili është pikërisht për përdorim të biçikletave në baza ditore duke lënë veturat në shtëpi”, ka thënë kryetari duke bërë thirrje tek drejtorët, mësimmësuesit, mjekët dhe të gjithë ata që e ndjejnë veten mirë në aspektin shëndetësor, që ti përgjigjen aktivitetit për dhurimin e gjakut gjatë ditës së nesërme. Ndërsa, në emër të organizatorit të aktivitetit

“Gjilani bike”, Genc Mustafa, ka falënderuar kryetarin Haziri, për mbështetjen dhe ka bërë të ditur detajet e kësaj ngjarje e cila ka nisur sot në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, për të vazhduar gjatë ditës së nesërme me dhurimin e gjakut e që përfundon me rrugëtimin prej 13 km në drejtim të Kalasë së Pogradit me biçikleta më 16 gusht. “Ishim sot për të marrë mbështetjen nga i pari i Gjilanit për mbështetjen e madhe që i ka dhënë këtij aktiviteti dhe shumë ngjarjeve të tjera të rinisë. Kemi marrë konfirmimin e kryetarit Haziri dhe të stafit të tij për të qenë pjesë e aktiviteteve të “Gjilani bike”, ku qëllim ka përdorimin e biçikletave dhe largimin nga veturat”, tha në fjalën e tij Mustafa. Ndërsa, drejtori i Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Banimit, Naser Korça, ka thënë se me të marrë detyrën si drejtor, është angazhuar menjëherë në krijim të kushteve për biçikleta në komunikacion. “Që në fillim do të punojmë për shënjimin horizontal dhe vertikal për hapësirën e trafikut që do të kenë biçikletat. Për të vazhduar në të njëjtën kohë me vend parkingun e posaçëm për biçikleta, por në të ardhmen do të punojmë edhe në uljen e trotuareve në mënyrë që të gjithë ata që do të përdorin këtë mjet udhëtimi ta kenë më të lehtë qarkullimin nëpër rrugët e Gjilanit”, tha ndër të tjerash drejtori Korça.



Haziri: Çdo ditë është e nevojshme dhe e rëndësishme për të dhuruar gjak

13

GUSHT

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, me stafin e tij ka dhuruar gjak dhe ka apeluar te qytetarët që t'i bashkohen aksionit, duke thënë se gjaku është i nevojshëm çdo ditë për të shpëtuar jetën e atyre që mund të jenë në rrezik. Nuk duhet të ketë ditë të shënuara për të dhuruar gjak. “Çdo ditë është e rëndësishme, çdo ditë mund të shpëtohet një jetë”, tha kryetari Haziri, i cili është një dhurues i rregullt i gjakut. Ndërsa, Bajram Salihu, teknik i transfuzionit të gjakut në Gjilan, ka thënë se për këtë periudhë të vitit 2015, janë mbledhur rreth 600 doza të gjakut, por vetëm 30 për qind të tyre janë nga dhuruesit vullnetarë, ndërsa pjesa

tjetër është nga familjarët. Këto doza nuk mjaftojnë për nevojat e Spitalit Regjional, prandaj duhet të plotësohen përmes intervenimeve familjare dhe Qendrës Kombëtare të Transfuzionit. Sipas tij, numri i dhuruesve të gjakut, është rreth njëmijë në vit. Ai ka kërkuar nga qytetarët të cilët qëndrojnë mirë me shëndet, që të japin gjak, sepse kështu shpëtojnë jetë. Ndryshe, ky aktivitet është organizuar në kuadër të “Gjilani bike”, që ka nisur më 12 gusht, në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, për të vazhduar sot me dhurimin e gjakut dhe për të përfunduar më 16 gusht, me një rrugëtim me biçikleta në eksplorim të bukurive natyrore dhe historike në Kalanë e Pogradit.

KE ndihmon valorizimin e zejeve tradicionale

14

GUSHT

Komuna e Gjilanit që është përfituese e grantit të Komisionit Evropian në kuadër të programit për bashkëpunim ndërkufitar mes Komunës së Gjilanit dhe Çairit përmes partnerit lokal OJQ “Agro-Eko” në Gjilan, sot ka mbajtur takimin e radhës të Komitetit drejtues dhe ekipit të projektit “Valorizimi i zejeve tradicionale”, me kryetarin e Komunës Lutfi Haziri, i cili ka kërkuar angazhim edhe më të madh në arritjen e objektivave dhe qëllimit të këtij projekti. “Është mundësi shumë e madhe që e kishim fatin të jemi pjesë e këtij programi për bashkëpunimin ndërkufitar me Komunën e Çairit për promovim dhe bashkëpunim në prodhimin dhe përpunimin të zejeve tradicionale, të mbështetur nga Komisioni Evropian. Kjo po ashtu ka edhe qëllimin e shkëmbimit të përvojave mes bizneseve të kësaj fushe, nga të dyja Komunitatet. Prodhimi që bëhet nga këto biznese, të cilat merren me

këtë zeje, domosdo që kërkon edhe promovimin e këtyre produkteve të vjetra, andaj kërkoj që të punohet edhe më shumë nga ky komitet, në mënyrë që rezultatet të jenë në favor të zhvillimit të kësaj fushe në të ardhmen”, ka thënë kryetari Haziri. Ndërsa koordinatori i projektit, Gëzime Idrizi – Ismaili, ka pohuar se investimet në bazë të projektit do të zhvillohen shumë shpejt në Gjilan, duke iu ofruar qytetarëve shërbime sa me efikasë dhe informim në të njëjtën kohë. “Jemi në fazën përfundimtare të organizimit të trajnimeve për bizneset e Komunës sonë. Gjithashtu kemi filluar përgatitjet për panairin e madh të përbashkët të dy Komunave Gjilan – Çair. Në panair ka mundësi të bëhet promovimi dhe shkëmbimi i përvojave mes bizneseve, por edhe plasimi i tyre në treg si dhe informimi i qytetarëve me zejet tradicionale që ende mund të përdoren për nevoja të ndryshme në jetën e përditshme”, tha ajo.

Gjilani shënon Ditët kulturore të shteteve mike

14
GUSHT

Komuna e Gjilanit në bashkëpunim me OJQ “Agro-Eko”, ka organizuar shënimin e Ditëve kulturore të shteteve mike, në shenjë falënderimi e respekti për ndihmën që i kanë dhënë ato Kosovës, para dhe pas luftës. Me këtë rast, kryetari i Komunës, Lutfi Haziri ka falënderuar shtetet mike për gjithë atë që kanë bërë për Gjilanin, përmes investimeve të shumta dhe të ndryshme, të cilat drejtpërdrejt kanë ndikuar



në jetën e qytetarëve. Në kalendarin e “ditëve kulturore të shteteve mike” janë përfshirë SHBA-të, Japonia, Franca, Turqia, Italia, Gjermania, Suedia, Danimarka, Finlanda dhe Norvegjia. “Kjo është më e pakta që ne mund të bëjmë për këto shtete mike dhe për mërgatën e Gjilanit, që është shumë e madhe në botën e jashtme, ku ndodhet edhe një numër i konsiderueshëm i bashkatdhetarëve tanë”.



26
GUSHT

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga drejtori i DKA-së, Nazmi Musa, ka vizituar sot shkollën e mesme të Agrobiznesit “Arbëria” për të parë ecurinë e punëve në vitin e ri shkollor, ku janë pritur nga drejtori Xhelal Jetishi. Drejtori Jetishi e ka falënderuar kryetarin Haziri që ka gjetur kohë për këtë vizitë, derisa e ka njoftuar së pari për përgatitjet që janë duke i bërë për fillimin e vitit shkollor, për vështirësitë, sfidat dhe sukseset e kësaj shkolle. Kryetari Haziri u shpreh se Komuna i ka dhënë statusin e privilegjuar shkollës së Agrobiznesit, duke siguruar bursa për nxënësit e suksesshëm dhe duke ua siguruar edhe transportin falas. “Shkolla e mesme e Agrobiznesit është njëra nga shkollat që i kemi dhënë status të privilegjuar, që nënkupton se të gjitha profilet që kjo shkollë i ka, duhet të mbushen me nxënës dhe kuadër i ri, i cili

Transport falas dhe bursa për nxënësit e shkollës së Agrobiznesit

është jashtëzakonisht i mirëpritur edhe nga kuadri profesional i kësaj shkolle, por edhe nga tregu i Gjilanit, i cili është tipik agro-industrial e bujqësor. “Ne po presim t’i ngrehim kapacitetet në industrinë e duhanit, në industrinë e mishit dhe po ashtu jemi regjion kampion në pemëtarë. Natyrisht, që kjo shkollë duhet të përgatis kuadro përkatëse për tregun e Gjilanit, Kosovës dhe atë europian”, tha Haziri. Ai ka apeluar te prindërit dhe nxënësit që këtë shkollë ta shohin si një mundësi të mirë, sepse bujqësia është perspektivë e rëndësishme për këtë regjion. “Ne do të japim edhe bursa për nxënësit e shkollës së Agrobiznesit dhe po ashtu do të sigurojmë edhe transportin në një vijë urbane”, ka thënë Haziri. Drejtori i DKA-së, Nazmi Musa, tha se shkolla e Agrobiznesit është më e mira në rajon, me të gjitha pajisjet dhe kabinetet moderne për mësim cilësor.

Gjilani synon të bëhet qytet ekologjik



28

GUSHT

Qyteti i Gjilanit po hyn në një fazë të re të dijes për ambientin. “Gjilani në vitin 2016 do të jetë qytet ekologjik sepse jemi vlerësuar lart edhe prej organizatave ndërkombëtare”, ka thënë kryetari, Lutfi Haziri, gjatë një takimi me drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme, të organizuar nga Green Art Center – Prishtina, ku u prezantua projekti “Gjilani riciklon”. Ky projekt, i përkrahur nga GIZ, do të realizohet nga GAC, me qëllim që të themelojë “klubet e gjelbra” në shkollat e Gjilanit, si dhe të shtrijë rrjetin “Eco-friend”, përkatësisht të ndërlidhë përpunuesit e mbeturinave të riciklueshme me procesin, me qëllim që të stimulohet riciklimi, ndarja e mbeturinave dhe njëherësh të gjenerohen të hyra për “klubet e gjelbra”, me qëllim të financimit të aktiviteteve të këtyre klubeve. Në kuadër të këtij projekti, qyteti i Gjilanit ka përfituar edhe infrastrukturë për ndarjen e mbeturinave, përkatësisht kosha dhe kontejnerë të veçantë. Kryetari Haziri dhe drejtoritë respektive do të angazhohen që bashkëpunimi me GAC të jetë i suksesshëm, si dhe të hartojnë së bashku edhe projekte të

tjera në të ardhmen. Ky projekt është i rëndësishëm për qytetarët e Gjilanit, meqë do të sjellë zhvillime në fushën e menaxhimit të mbeturinave në Gjilan, njëherësh do të pasurojë kalendarin e aktiviteteve të Gjilanit me nisma të shumta mjedisore. Nga tash e tutje, nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në Gjilan do të kenë mundësinë të kryejnë aktivitete të shumta mjedisore, të cilat padyshim do të ndikojnë në ngritjen e cilësisë të jetesës në Gjilan. “Green Art Center – Prishtina (GAC) do të angazhohet që Gjilani të jetë një qytet edhe më i pastër, por mbi të gjitha do të angazhohemi që së bashku me Komunën e Gjilanit të sjellim projekte dhe investime të cilat do të përmirësojnë jetesën në këtë qytet”, tha drejtoresha e GAC, Merlina Beu –Muçaj. Përderisa, Driton Vatovci, përfaqësues i GIZ në Gjilan, tha sedo të vazhdojnë të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes mjedisore në Gjilan. Klubet e gjelbra janë grupe vullnetarësh, të krijuara, rivitalizuara dhe mbështetura nga Green Art Center – Prishtina (GAC), në institucionet shkollore në Kosovë, të cilat kryesisht ndërmarrin aktivitete në të mirë të mjedisit.



Haziri: Do të vazhdojmë të jemi të parët në nivel vendi me rezultatet në arsim

01

SHTATOR

Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2015-2016, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga drejtori i DKA-së, Nazmi Musa, ka vizituar sot shkollën fillore “Selami Hallaqi”, ku nxënësve dhe arsimtarëve të saj u ka uruar suksese gjatë këtij viti. Kreu i Gjilanit tha se ndihet krenar për suksesin e nxënësve të Gjilanit, në vitin që e lamë pas, i bindur se këto rezultate do të avancohen. “Rruga e vetme që të arrihen qëllimet e jetës është që të mësoni shumë”, ka thënë Haziri. Vitin e kaluar, Gjilani ka arritur suksesin më të madh në testin e semimaturës në nivel

vendi. “Shpresoj dhe besoj shumë sedo të vazhdojmë të jemi edhe më tutje të parët në nivel vendi”, ka thënë kryetari Haziri. Kurse drejtori i Arsimit, Nazmi Musa, ka thënë se 2015-ta është shpallur “vit i ngritjes së cilësisë në arsim”, duke shtuar se një shoqëri dhe një popull nuk mund të zhvillohet pa arsimim cilësor. Përndryshe, Komuna e Gjilanit ka investuar shumë në arsim, duke ndërtuar salla sportive, duke rinovuar shkolla atje ku ka pasur nevojë, në mënyrë që t’u krijohen mundësi më të mirë për nxënësit në nxënien e dijes dhe për një fillim të mbarë.



Buxheti 2016 diskutohet me qytetarët

07

SHTATOR

Pas katër dëgjimeve publike që janë mbajtur në fshatra, Komuna e Gjilanit, përkatësisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ka mbajtur sot dëgjimin e pestë publik me qytetarët, që është i fundit për planifikimin e buxhetit për vitin 2016. Drejtori për Buxhet dhe Financa, Zijadin Maliqi, tha se qëllimi është që të bashkëbisedojmë me qytetarët, për të bërë një buxhet sa më të mirë. Maliqi tha se buxheti për vitin 2016 është 21.354.700 euro. Mallrat dhe shërbimet janë ulur për 11 për qind, për t'i rritur investimet. Për subvencione janë paraparë 554 mijë euro, që kryesisht do të shkojnë për bujqësi, pastaj në kulturë, rini e sport e shëndetësi. Ndërkaq, 3.4 milionë janë planifikuar për investime kapitale, që përfshinë zhvillimin ekonomik, ndërtimin e rrugëve, kanalizime, ujësjellës, nënkalime, trotuare, pastaj për kadastrë dhe gjeodezi, urbanizëm, shëndetësi

e arsim. Me pyetje e kërkesa janë paraqitur shumë qytetarë, që kryesisht kishin të bënin me investime në infrastrukturë. Maliqi është zotuar se të gjitha kërkesat do të merren parasysh brenda kapaciteteve komunale. Ai tha se shpreson që me ndihmën e kryetarit Lutfi Haziri, përmes ministrive do të thithen mjete tjera për investime. Shefi i Grupit të Këshilltarëve të LDK-së në Kuvend, Avdyl Aliu, ka falënderuar qytetarët për ardhje në numër kaq të madh në dëgjimin publik për buxhetin. Dëgjimit qendror i kanë paraprirë disa takime me qytetarë në Velekincë, Zhegër, Livoç të Epërm, Përlepnice e gjetiu, ku zyrtarët e Komunës kanë paraqitur buxhetin 2016 dhe i kanë marrë kërkesat e banorëve të këtyre zonave. “Kërkesat tuaja do të merren për bazë dhe do t'i fusim në buxhetin e vitit 2016 dhe me të gjitha kapacitetet tona do t'i realizojmë ato”, ka thënë Maliqi.



Lutfi Haziri në Bruksel për rikthimin e Gjilanit në mikro regjionin evropian

09
SHITATOR

Gjatë vizitës së tij në Bruksel, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka zhvilluar sot takime me nënkryetarin e Brukselit, Ahmed El Ktibi, me sekretarin gjeneral të Komitetit të Regjioneve të Europës, Jiri Burianek dhe përfaqësues të Departamentit për Zgjerim dhe atij për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Haziri synon ta rikthejë Gjilanin në qendër të këtij mikro regjioni evropian. Në takimin me nënkryetarin e Brukselit është biseduar për rikthimin e Gjilanit në mikro regjionin evropian, bashkëpunimi me qytetin e Brukselit në fushën e ambientit, eficiencës së energjisë dhe urbanizmit. Ndërkaq, në takimin me sekretarin gjeneral të Komitetit të regjioneve të Europës, Jiri Burianek, dhe kryetarit Haziri, është folur për bashkëpunimin

ndërkomunal GJPKT (mikro regjioni evropian), infrastrukturën e përbashkët ndërkomunale dhe ndërkufitare. Ndërkohë, kryetari Haziri ka biseduar me përfaqësues të Departamentit për Zgjerim për raportin e progresit dhe rolin e komunave të përmirësimit të standardeve. Kreu i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka takuar edhe përfaqësuesin e Departamentit për Bujqësi dhe rural, John A. Clark, me të cilin ka diskutuar për rolin e komunave në zhvillimin e sektorit të bujqësisë. “Gjilani si qendër regjionale mund të bëhet promotor i zhvillimit ndërkomunal për bujqësi dhe zhvillim rural”, tha me këtë rast kryetari Haziri. Kryetari Haziri pritet të ketë edhe takime tjera të rëndësishme në Bruksel, për zhvillimin e Komunës së Gjilanit në shumë fusha.



Komuna e Gjilanit kthen shpresat te banorët e fshatrave të Karadakut

09

SHTATOR

Miradi Maloku nga lagjja “Maloku” e fshatit Selishtë të Karadakut të Gjilanit, ka udhëtuar më shumë se 30 minuta për të dalë në rrugën kryesore, shkak i rrugës së degraduar skajshmërisht. Por, gjendja tash ka ndryshuar shumë, pasi Komuna e Gjilanit e ka zgjeruar këtë rrugë dhe e ka shtruar me zhavorr, duke e bërë më të lehtë lëvizjen. Miradi Maloku thotë se kjo rrugë, tash përshkohet për pesë minuta dhe shpreh falënderim për kryetarin e Komunës, Lutfi Haziri, që ua ka kthyer shpresat për jetë banorëve të asaj ane. “Jemi kanë në gjendje shumë të rëndë. Këtu s’kanë mujt me kalu as veturat. E kur ka ra shi, s’ke mujt me kalu prej lloçit. Problemi më i madh u kanë për fëmijët tanë me udhëtu në këtë rrugë për në shkollë. Tash u ba shumë mirë dhe faleminderit shumë prej kryetarit që na e rregulloi rrugën që për pesë minuta po dalim në asfalt”, thotë Maloku. Pas kësaj, Komuna i ka shtruar

me zhavorr dhe i ka zgjeruar të gjitha rrugët e fshatrave të Grykës së Karadakut, ku përfshihen të gjitha lagjet e fshatrave: Shurdhan, Çelik, Pidiq, Stançiq e Goden. Drejtori për Shërbime Publike, Naser Korça me bashkëpunëtorë, është ndarë shumë i kënaqur me finalizimin e këtyre projekteve, ku janë ndërtuar 42 kilometra rrugë të rendit të tretë. “Sot vizituam këto rrugë të fshatrave të Karadakut dhe me investimet këtu u kemi krijuar mundësi më të mira për jetesë qytetarëve. Rregullimi i këtyre rrugëve ka qenë premtim i kryetarit dhe tash e bëmë realitet. Do të vazhdojmë të investojmë gjithandej territorit të komunës së Gjilanit për ta realizuar katërshen infrastrukturore”, ka thënë drejtori Korça. Pas këtyre investimeve të Komunës në Selishtë dhe në fshatrat tjera, Miradi Maloku tha se banorëve të asaj ane i është kthyer shpresa për jetë dhe pritet që të kthehen edhe ata që janë shpërngulur si pasojë e kushteve të rënda.



Gjilani ‘sefte’ në rajon zbaton projektin e punës “prej shtëpie”

15
SHITATOR

Sali Hasani, procesmbajtës në sekretarinë e Kuvendit Komunal të Gjilanit, që nga sot do të punojë në shtëpinë e tij, falë projektit për punë në distancë, të emërtuar “Prej Shtëpie”. Ky është projekti i parë i kësaj natyre në nivel vendi dhe rajon, për çka zyrtari Sali Hasani thotë se ndihet i privilegjuar. “Unë ndjehem si zyrtari më i privilegjuar i Gjilanit sepse po e filloj ta zbatoj një projekt të ri, atë të punës në distancë. Që nga sot, një zyre e shtëpisë sime është zyre e Kuvendit Komunal dhe të gjitha përgjegjësitë e mia do t’i kryej me vullnet shumë të madh”, ka thënë Hasani në ceremoninë e hapjes së zyrës në shtëpinë e tij. “Gjilani është Komunë model sa i përket aplikimit të metodave të punës në administratë. Ky është programi i katërt që ne po e aplikojmë për këto 18 muaj, programe këto jashtëzakonisht në interes të ofrimit të shërbimeve për qytetarët, por edhe në

interes të funksionalitetit”, ka thënë me këtë rast kryetari Haziri. Kreu i Gjilanit tha se përparësia e këtij programi është se e mban të ‘okupuar’ në punë sërish tetë orë zyrtarin në fjalë, por është shumë më fleksibil në atë se si e menaxhon ditën. “Ne besojmë shumë se menaxhimi punëve nga Sali Hasani do të jetë model për të tjerët”, u shpreh Haziri. Drejtori i Administratës, Nami Gagica, tha se “tele-work” (puna në distancë), është projekti i parë në Kosovë dhe rajon. “Ne i matim objektivat e zyrtarit nëpërmjet softwerëve”, ka thënë Gagica. Ndryshe, Komuna ka paraparë që deri në fund të vitit, në “tele-work” të përfshihen 10 zyrtarë komunalë, për të vazhduar në të ardhmen edhe me të tjerë. Ndryshe, Komuna e Gjilanit ka zbatuar për herë të parë në nivel vendi edhe projektin për nxjerrjen e certifikatave online, sikurse edhe projektin e zyrave të hapura “One Stop Shop”.



Gjilani bënë homazhe në ditën e rivarrimit të dëshmorëve

17

SHTATOR

Në varrezat e dëshmorëve në Gjilan, për nder të shënimit të Ditës së Rivarrimit të Dëshmorëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga kjo zonë, ku ishin prezent udhëheqësit e institucioneve më të larta nga niveli lokal dhe ai qendror, duke nisur nga i pari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, drejtuesi i Policisë së Kosovës në Gjilan, familjarë të dëshmorëve dhe veteranë të UÇK – së si dhe qytetarë të tjerë të cilët nderonin me përlujë veprën heroike që ata bënë për të jetësuar lirinë në gjithë Kosovën. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i cili shoqërohej edhe nga disa deputet të kësaj legjislature, ka thënë se Kosova është një vend i cili ka dhënë shumë qytetarë të saj për lirinë e vendit, është derdhur shumë gjak dhe ishte vetëm një qëllim, luftë deri në lirinë e vendit. “Sot është dita e rivarrimit të dëshmorëve të Zonës Operative të Karadakut. Çdo përvjetor ne përulemi para dëshmorëve të cilët dhanë gjithçka që Kosova të gëzojë sot lirinë, me besimin e madh që amanetin e tyre ta qojmë deri në fund. Familjarët e dëshmorëve duhet të jenë krenar për bijtë e bijat e tyre që janë flijuar, në të njëjtën kohë bashkëluftëtarët e tyre, që ta vazhdojnë rrugën dhe amanetin e

tyre dhe gjithë qytetarëve Kosovës, që ti vlerësojnë edhe më shumë, vlerat të cilat janë më sublimë në vendin tonë”, tha në fjalën e tij kryetari i Kuvendit të Kosovës, Veseli. Me këtë rast nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, ka thënë se ajo që bënë dëshmorët është një veper e shenjtë e cila mund të bëhet vetëm në mbrojtje dhe garantim të lirisë së truallit ku të gjithë ne jemi të lindur. “Heronjtë, dëshmorët dhe martirët e Gjilanit u sakrifkuan për sjellë lirinë e popullit dhe mbrojtjen e vendit. Ata këtë veper të shenjtë e bënë, jo për të sulmuar dikë, por për të garantuar lirinë e brezave që do të vinë edhe pas nesh. Vargu i shqiptarëve të rënë në luftën për liri, është shumë i gjatë dhe i vazhdueshëm deri në kulmim të organizimit ushtarak të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjaku i derdhur për liri, na obligon të gjithëve që të punojmë më shumë dhe më me ngulm në jetësimin e amanetit të tyre, ndërtimin, zhvillimin dhe përparimin e vendit”, tha ndër të tjerash në fjalën e tij nënkryetari Rexhep Kadriu. Kurse ish-komandanti i Zonës Operative të Karadakut, Ahmet Isufi, ka thënë se kjo ditë është shumë e madhe për Gjilanin, është ditë e dhimbjes, e murrjes, e krenarisë por edhe ditë e kujtimit të veprës për ata të cilët sot nuk janë në mesin tonë.



Nis asfaltimi i rrugës që lidhë Gjilanin me Kamenicën e Bujanocin

19
SHTATOR

Pos realizimit të projekteve në rrjetin e kanalizimit dhe ujësjellësit, Komuna e Gjilanit po vazhdon realizimin e projekteve edhe në ndërtimin e rrugëve. Kësisoj, sot ka nisur asfaltimi i rrugës 2.2 kilometra që e lidhë Gjilanin me Kamenicën dhe Bujanocin e që kalon nga fshati Përlepnice. Kryetari Lutfi Haziri, i shoqëruar nga nënkryetari Rexhep Kadriu, ka vizituar punimet dhe e ka vlerësuar projektin jashtëzakonisht të rëndësishëm. “Jemi në realizimin e rrugës që e lidhë Komunën e Gjilanit me Komunën e Kamenicës përmes Ropotovës dhe Bujanocin, po ashtu. Është një projekt jashtëzakonisht i madh, jo vetëm për Komunën tonë, por edhe për komunat fqinje me investim qind për qind i buxhetit të Komunës së Gjilanit”, tha Haziri, duke shtuar se Komuna është në vllug të punimeve në realizimin e katërshes infrastrukturore në qytet dhe fshatra. “Jemi në vllugun e realizimit të punimeve, jo vetëm në këtë zonë, por edhe në qytet dhe fshatra, Zhegër, Bresalc e fshatra të tjerë. Me ndërtimin e rrugëve, krahas ndërtimit të ujësjellësit dhe kanalizimeve si infrastrukturë bazike, këtë vit po e përmbyllim fazën e fundit të projektit më të madh të infrastrukturës që ka pasur Komuna e Gjilanit”, u shpreh Haziri. Ai theksoi se përderisa më herët Gjilani ka qenë i përjashtuar nga investimet e qeverisë, tash situata është krejt ndryshe. “Gjilani ka qenë i përjashtuar nga investimet në vitet e kaluara, ndërkaq tash duke u kombinuar investimet e Komunës sonë me qeverinë dhe donatorët siç është qeveria zvicerane, gjermane etj., realisht ne po i përmbushim kërkesat elementare. Jam shumë i kënaqur me realizimin e këtyre objektivave”, ka përfunduar i pari i gjilanasve, Lutfi Haziri.



Lutfi Haziri, takim pune me ambasadorin amerikan Greg Delawie

21

SHITATOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka zhvilluar sot një takim pune për ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës, Greg Delawie, i cili për herë të parë po qëndron në vizitë në Gjilan, ku USAID-i ka bërë investime të konsiderueshme në disa fusha. I pari i gjilanasve, Lutfi Haziri, pasi e ka falënderuar ambasadorin ameri-

kan për vizitën, e ka njoftuar atë për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm të Komunës me programet e USAID-it dhe prezencën amerikane në fushën e sigurisë në Gjilan. Përndryshe, Gjilani njihet si Komuna që ka përfituar shumë nga qeveria amerikane në fushën e arsimit, infrastrukturës dhe sigurisë.



Bunjaku-Rexhepi: Kuvendi ka bashkëpunim shumë të mirë me ekzekutivin

21

SHTATOR

Në një tryeze mbi “Rolin mbikëqyrës të organeve legjislativ”, të organizuar nga Qendra Rajonale e OSBE – së në Gjilan për bashkëpunimin mes Kuvendeve Komunale dhe ekzekutivit në kuadër të këtij regjioni, në të cilin hyjnë 11 Komuna, ku të pranishmit, respektivisht kryesuesit e Kuvendeve Komunale, drejtorët e drejtorive të Buxhetit, Arsimit dhe Shëndetësisë, kanë debatuar mbi bashkëpunimin në përgjithësi, llogaridhënien, raportimin dhe planifikimin më të mirë në shërbim të qytetarëve dhe zhvillim të Komunave veç e veç. Me këtë rast në këtë takim e pranishme ishte edhe kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, Valentina Bunjaku – Rexhepi, e cila shoqërohej nga ekzekutivi, respektivisht drejtori i buxhetit, Zjadin Maliqi, ai i arsimit, Nazmi Musa dhe drejtori i shëndetësisë, Nexhat Hajrullahu, ka thënë se bashkëpunimi mes legjislacionit dhe ekzekutivit në Gjilan është shembulli më i mirë që dëshmon për angazhim maksimal, në shërbim të planifikimit më të mirë të mundshëm, por edhe llogaridhënie para Kuvendit të Komunës si organ i përfaqësimit të qytetarëve. “Bashkëpunimi mes legjislacionit dhe ekzekutivit në Komunën e Gjilanit është në nivelin më të mirë të mundshëm. Të gjitha punët i bëjmë në bashkëpunim dhe koordinim me ekzekutivin, në mënyrë që përmes projekteve, planifikimit dhe programeve të qeverisjes lokale, qytetarët të jenë përfituesit më të mëdhenj. Në trupat profesionale të Kuvendit – Komitetet, (pozitë – opozitë) jepet kontribut shumë i madh me rekomandime, vërejtje, sugjerime që të ndikohet në ekzekutivin e Komunës, për intervenime dhe investime në fusha të ndryshme. Gjithashtu një kontribut shumë të madh janë duke e dhënë edhe këshillat e fshatrave, për organizime të ndryshme, konsultime dhe adresime të kërkesave në institucione, për probleme të ndryshme të komunitetit në pjesë të ndryshme të komunës”, tha ajo. Po ashtu, sipas Bunjaku-Rexhepit, raportimet nga ana e pjesës ekzekutive të Komunës së

Gjilanit janë gjithashtu pjesë e planit të punës, që jepen para këshilltarëve komunal duke komentuar dhe debatuar hapur edhe me opozitën e cila kontribuon vazhdimisht në këtë drejtim. Ajo ka uruar që këtë kulturë të bashkëpunimit dhe transparencë për të cilën edhe është shpërblyer legjislativi, ta ndjekin edhe komunat tjera. Ndërsa nga ana e tij, drejtori i OSBE-së në Gjilan, Ulrich Biffar, ka thënë se roli mbikëqyrës i organeve legjislativ ndaj ekzekutivit është shumë me rëndësi, kur kemi parasysh kompetencat e mëdha që kanë kryetarët e Komunave. “Llogaridhënia është me shumë rëndësi. Kryetarët e Komunave në Kosovë kanë kompetenca ekzekutive më të mëdha, krahasuar me vendet e regjionit. Raportimi i tyre para Kuvendit është me shumë rëndësi, sikur që e rëndësishme është edhe përfshirja e trupave të Kuvendit në organizim të planifikimit të buxhetit dhe organizimit të debateve me qytetarë për projektet dhe zhvillimet në Komunat tuaja. Në kuadër të kësaj, përmes legjislacionit duhet të fuqizohen edhe më shumë Kuvendet Komunale sepse Kuvendet janë përfaqësimit e drejtpërdrejta të qytetarëve”, tha ndër të tjerash në fjalën e tij, drejtori Biffar. Ndryshe, në këtë tryezë kanë kontribuar me përvojat e tyre profesionale edhe drejtorët e drejtorive komunale nga komunat e ndryshme të regjionit të Gjilanit, duke potencuar praktikën e bashkëpunimit në mes ekzekutivit dhe legjislativit, në shërbim të qytetarëve, përpos Komunës së Parteshit e cila ka prezantuar një mungesë totale të bashkëpunimit në mes të kryetarit të kësaj Komune dhe Kuvendit si organ legjislativ. Kurse, Afrim Nesreti, udhëheqës i këtij programi dhe Fatmir Zylfijaj nga Njësia për Qeverisje Lokale, kanë dhënë rekomandimet për bashkëpunim më të madh dhe më përmbajtësor mes dy organeve, legjislativ dhe ekzekutiv, duke bashkëpunuar me trysni dhe koordinim për ndikim më të madh të përbashkët në nivelin qendror, për planifikim edhe më të mirë në zhvillim të komunave dhe mbështetje më të madhe buxhetore.



Gjiłani është Komuna më e sigurt në Republikën e Kosovës

21
SHTATOR

Është inauguruar sot objekti i ri i Prokurorisë Themelore në Gjiłan, ngjarje kjo në të cilën mori pjesë kryetari i Komunës së Gjiłanit, Lutfi Haziri, kryeministri Isa Mustafa me një pjesë të kabinetit, ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie, kryeprokurori i Gjiłanit Jetish Maloku, kryeprokurori i shtetit, Aleksandër Lumezi sikurse edhe përfaqësues të BE-së. Në fjalën e rastit, kryetari i Komunës së Gjiłanit, Lutfi Haziri, pasi uroi për inaugurimin e objektit të ri të prokurorisë, tha se fatmirësisht në dy vitet e fundit në Gjiłan nuk ka pasur asnjë lloj krimi. “Dëshiroj ta konfirmoj para kryeministrit Mustafa se Gjiłani është njëra nga komunat më të sigurta të Republikës së Kosovës. Dy vitet e fundit në Gjiłan nuk ka pasur asnjë lloj krimi. Në dy vitet e fundit Gjiłani ka hyrë në agjendën e qyteteve të sigurta falë angazhimit, përkushtimit dhe ndërtimit të infrastrukturës siç është sot ndërtimi i objektit të prokurorisë. Po presim edhe përfundimin e objektit të policisë për ta rrumbullakuar infrastrukturën e organeve të rendit në Gjiłan. Ju konfirmoj nevojën

për ta rritur sundimin e ligjit dhe bartë si këtij instrumenti janë institucionet e drejtësisë”, tha Haziri. Ai theksoi se “falë angazhimit të prokurorisë dhe gjykatës, ne në vitin e kaluar kemi arritur të inkasojmë të hyra si rezultat i sundimit të ligjit dhe përmbartimit të lëndëve”. “Uroj dhe besoj shumë që kjo ditë e shënuar për drejtësinë në Gjiłan të vazhdojë të sjell edhe më shumë projekte dhe investime të tjera”, tha kryetari Haziri. Kryeprokurori në Prokurorinë Themelore të Gjiłanit, Jetish Maloku, tha se është ditë e veçantë për Gjiłanin dhe Anamoravën sepse nga sot do të kenë kushte më të favorshme dhe efikasiteti do të jetë më i lartë. Hajredin Kuqi, ministër i Drejtësisë, ka deklaruar tha se përrurimi i kësaj ndërtese është një lajm i mirë për gjyqësorin e Anamoravës, ndërkaq ambasadori amerikan Greg Delawie tha se SHBA do të vazhdojë të përkrahin Kosovën në fushën e drejtësisë, e cila sipas tij, duhet të jetë pasqyrë për të shërbyer në interes të qytetarëve, duke shtuar se edhe Barak Obama e ka thënë se Kosova do të ketë përkrahjen e SHBA-ve.



Bizneset amerikane shprehin interesim për investime në Gjilan

22
SHTATOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri priti, sot një delegacion të biznesit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilët ishte takuar në vizitën e fundit në SHBA. Si rezultat i vizitës së Hazirit në SHBA në muajin korrik, kompania amerikane e njohur ndërkombëtarisht për produkte të mbrojtjes ka ardhur sot në Gjilan për të vazhduar procesin e bashkëpunimit deri në realizimin të projektit që do të krijonte dhjetëra vende pune. “Gjilani është i hapur dhe i mirëpret bashkëpunimet dhe investimet e jashtme. Ne si Komunë do të bëjmë gjithçka që është e mundur për të ndihmuar në këtë proces, veçanërisht kur është në pyetje një kompani amerikane serioze dhe me reputacion ndërkombëtar”, ka thënë Haziri. Nga ana tjetër, pronarja e kompanisë në fjalë, znj. Becky, e shoqëruar nga bashkëpunëtorët e saj, znj. Eronida dhe z. Bislimi, ka thënë se “interesi im për të punuar këtu është për t’ju ndihmuar njerëzve të Kosovës duke krijuar vende pune, veçanërisht për gratë”.

Në fund, Faton Bislimi e falënderoi kryetarin Haziri për mikpritjen dhe ofertën e hapur të bashkëpunimit për të bërë Gjilanin një vend favorit të investimeve të huaja, e veçanërisht atyre amerikane. “Edhe unë edhe pronarët e kompanisë amerikane jemi të lumtur që sot po e vazhdojmë procesin e bashkëpunimit në fushën e krijimit të vendeve të punës. Asgjë më shumë se zhvillimi ekonomik nuk e ndihmon Gjilanin dhe Kosovën. Asgjë më shumë se lidhjet dhe miqësitë ndërkombëtare nuk na ndihmojnë në këtë drejtim. Si rezultat i këtij angazhimi, jam i lumtur që sot kryetari Haziri ia dorëzova edhe ftesën zyrtare për të marrë pjesë në Konferencën e radhës Ndërkombëtare të ICMA-së në Seattle, SHBA”, është shprehur Bislimi. Konferenca e 102-të Ndërkombëtare e ICMA-se (International City Management Association), me temë mbi zhvillimin ekonomik dhe bashkëpunimit në mes qyteteve në këtë drejtim, do të mbahet në fund të Shtatorit 2015 në Seattle, WA, SHBA.



Gjilani në fokus të kryetarëve të komunave të Europës për trashëgiminë kulturore

22
SHTATOR

Gjatë ditës së sotme, Gjilani ka qenë në fokus të autoriteteve përfshirë kryetarë komunash nga Europa, e përfaqësues nga organizatat e rëndësishme për trashëgiminë kulturore. Pas seminarit dyditor që ka nisur sot në Gjilan për trashëgiminë kulturore, kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, ka pritur sot në takim kryetaren e komunës Beaulieu-lès-Loches të Francës, Sophie Matadier, njëherësh kryetare e asociacionit të komunave për trashëgiminë kulturore, kryetarin e Komunës së Velesit në Maqedoni, Cadiev Slavko, zëvendës ambasadorin e Francës, sikurse edhe përfaqësues nga Ministria

e Kulturës, Muzeu i Kosovës dhe organizata që merren me trashëgiminë kulturore. Temë qendrore e takimit ka qenë krijimi i rrjetit të komunave për trashëgiminë kulturore, për ruajtjen dhe avancimin e këtij sektori shumë të rëndësishme të shoqërisë. Delegacioni i sipërpërmendur ka vazhduar me vizita në objektet me rëndësi kulturore në Gjilan. Ndërkohë, nesër seminari për trashëgiminë kulturore i vazhdon punimet, ku edhe do të dalin konkluzione se si të vepohet në funksion të zbulimit, ruajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore.



Ambasadorja e Francës mbështet përfshirjen e Gjilanit në rrjetin e qyteteve historike të Europës

23

SHTATOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, sot është takuar me Ambasadoren e Francës në Kosovë, Maryse Daviet, të cilën e ka informuar për zhvillimet e përgjithshme në Gjilan, duke marrë mbështetjen dhe përkrahjen e fuqishme të saj, për përfshirjen e Gjilanit në rrjetin e qyteteve historike të Europës. Me këtë rast kryetari Haziri, ka thënë se ambasadores Daviet i ka dhënë informacionet e përgjithshme për Gjilanin, zhvillimet dhe punët që janë duke u bërë në shumë fusha, nga e cila ka marrë edhe mbështetje për Gjilanin si Qytet Historik. "Sot takova ambasadoren e Francës në Kosovë, të cilën e kam informuar për Gjilanin në përgjithësi, për zhvillimet e ndryshme që kanë ndod-

hur e po ndodhin, për aspektet e pasura historike që ka Komuna jonë, por edhe për çështje të tjera të rëndësishme që janë vlera krenarie e Gjilanit. Nga ky takim kam marrë mbështetjen e fuqishme të autoritetit të ambasadores, për përfshirjen e qytetit Gjilanit në rrjetin e gjerë të qyteteve historike të Europës. Kemi me çka të prezantohemi në këtë rrjet, duke nisur nga monumentet dhe elemente të ndryshme e të shumta historike, kulturore, fetare, etj, që si Komunë me rëndësi strategjike për pozitën gjeografike që ka, është interesante dhe me karakteristika që ofrojmë, do të jemi qytet tërheqës me një vëmendje të veçantë në këtë rrjet të qyteteve historike", tha për këtë takim kryetari i Gjilanit Lutfi Haziri.

Kuvendarët e Gjilanit miratuan me kushte buxhetin 2016



29

SHITATOR

Kuvendi Komunal i Gjilanit, të martën, në mbledhjen e radhës për këtë vit, të cilën e ka drejtuar Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese, ka miratuar me kushte buxhetin për vitin 2016 si dhe pika të tjera të rendit të punës. Kuvendi miratoi edhe vendimin për shpalljen “qytetar nderi” të zonjës Hanife Mala, bashkëshorte e dëshmorit Rexhep Mala, si nismë e kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri si dhe të Rexhep Berishës, baba i dëshmorit Nuhi Berisha, që u propozua nga opozita, për të mos i ndarë këto dy familje emblematike të Gjilanit dhe u përkrah edhe nga pozita. Kuvendarët miratuan edhe vendimin për përbërjen e Komitetit konsultativ të ekspertëve të planifikimit hapësinor, me gjithë kërkesën e opozitës (PDK e VV) për ta përsëritur konkursin, me arsyetim se përzgjedhja e bërë nuk është profesionale, rregulloren për tatimin në pronë, raportin e komisionit të aksionarëve për ndërmarrjen “Stacioni i Autobusëve”, ndërkaq e shtynë për një seancë tjetër raportin për “Ecohigjiena”, me që mungoi kryesuesi i Komisionit. Kuvendi miratoi edhe vendimin për kompensimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, që përbëhet prej 15 anëtarëve, në vlerë prej 2 mijë euro për secilin, për gjithë punën e bërë deri tani, sikurse miratoi edhe raportin e korrije-shirjeve, që e prezantoi drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani si dhe diskutoi për raportin e auditimit për pasqyrat financiare në komunën e Gjilanit, për vitin 2014. Kuvendi i dha mandat kryetarit të Komunës, përmes një letre mbështetëse, për nënshkrimin e marrëveshjeve që kanë të bëjnë me projektet e energjisë së përsëritshme. Kuvendi u plotësua me një anëtar të ri, Refik Shala (LDK), i cili zëvendësoi Zijadin Maliqi, që para disa ditësh u emërua drejtor për Buxhet dhe Financa. Sa i përket buxhetit, Zijadin Maliqi, drejtor për Financa, ka thënë se buxheti i përgjithshëm i planifikuar për vitin 2016, është 21.354.701 euro. Këto mjete do të sigurohen nga granti qeveritar - 17.354.701 euro dhe nga të hyrat vetanake - 4.000.000 euro. “Ky është buxhet i mundësive, jo i nevojave”, ka thënë Maliqi. Pos ta pagat, te kategoritë tjera ka ulje të shpenzimeve për 12 për qind, me qëllim të mos preken investimet kapitale, ka thënë Maliqi, duke shtuar se buxheti i ka kaluar të gjitha procedurat e parapara, përfshirë edhe dëgjimet publike. Sipas Maliqit, ndarja në bazë të formulës, është e drejtë, por sa i përket vetë formulës, ajo mund të diskutohet te granti i arsimit, sepse duke e marrë parasysh numrin e nxënësve dhe jo të normave mësimore, komuna e Gjilanit po dëmtohet te ky pozicion. Avdyli Aliu (LDK) ka thënë se ky planifikim buxhetor bazohet në mundësitë reale, duke shtuar se është bërë një punë e mirë që janë ulur shpenzimet dhe nuk janë prekur

investimet kapitale. Riad Rashiti (PDK), tha se ky është buxhet i mbijetesës dhe jo buxhet i zhvillimit, gjë që sipas tij, dëshmon se edhe qeveria e Isa Mustafës po e anashkalon Gjilanin. Krenare Latifi (VV) tha se buxheti nuk ka trend rritje në vitin 2016, por përkundrazi shënon një ulje për 2.22 për qind dhe kjo është për brengosje. Ibish Ibishi (AAK) ka kërkuar të dijë sa janë marrë parasysh kërkesat e qytetarëve nëpër debate publike në planifikimin buxhetor. Shukrije Rapuca (PDK) kundërshtoi zvogëlimin e buxhetit për bujqësi, sikurse bëri edhe Fatbardha Selmani (PDK) sa i përket buxhetit për shëndetësi. Vërejtje për investimet kapitale pati edhe Fehmi Sylejmani (VV) duke thënë se ato janë të vogla, ndërkaq disa sektorë nuk përmenden fare, sikurse janë ulur edhe subvencionet. Arben Maliqi (LDK) tha se nuk ka zvogëlim të buxhetit, sepse ai mbetet i njëjtë, ndërkohë që kërkoj nga deputetët e kësaj ane që të jenë më të zëshëm në përfaqësimin e interesave të komunës së tyre në Parlamentin e Kosovës. Zijadin Maliqi sqaroi se komuna e Gjilanit nuk dëmtuar aspak te ndarja e buxhetit, madje qëndron më mirë se komunat tjera sa i përket grantit qeveritar. Ai ka nënvizuar faktin se kufijtë buxhetor nuk mund të thyhen, por thyerja e kufijve është bërë përmes linjave ministrore. Maliqi ka siguruar se kërkesat e qytetarëve do të përfshihen në planin e prokurimit. Kuvendi miratoi edhe rregulloren për tatimin në pronë, që sipas Zijadin Maliqit, drejtor financiar, mbetet e njëjtë me vitin 2015. Siç dihet, Komuna e Gjilanit, nga viti 2015 ka bërë uljen e normës, për rreth 15 për qind. Përndryshe, në pjesën e debatit, Sahit Abazi tha se PDK nuk heq dorë nga kërkesa për kërkim falje nga kryetari i Komunës, për akuzat e bëra ndaj këtij subjekti, pas rastit të shpimit të gomave të disa veturave zyrtare, sikurse as nga kërkesa për një informatë për ndërtimet pa leje, për projektin e lumit Mirusha, derisa kërkoj që të intervenohet në Malësinë e Zhegocit në riparimin e rrugëve, të cilat janë dëmtuar nga reshjet dhe kanë vështirësuar transportin e nxënësve. Bujar Nevzati (PDK) përsëriti kërkesën për një informatë për gjendjen në arsim, për punësimet, për ndërtimet pa leje, për raportet e ekzekutivit me investitorë dhe të tjera, duke kërkuar ballafaqim me kryetarin e Komunës për të gjitha këto pyetje. Valentina Bunjaku-Rexhepi tha se informatat për fillimin e vitit shkollor dhe për ndërtimet pa leje, do të ofrohen në seancën tjetër të Kuvendit Komunal, ndërkaq sa i përket mungesës së kryetarit të Komunës në seancën e sotme, ajo sqaroi se bëhet fjalë për disa probleme shëndetësore në familje, përndryshe kryetari i Komunës është i gatshëm të ballafaqohet çdo herë me opozitën në Kuvend Komunal, ka thënë ajo.



“Gjilani i ri” në diskutim publik me qytetarë

29

SHTATOR

Komuna e Gjilanit ka mbajtur mbrëmë një debat publik me qytetarët e ish- kampit “Monteith” për të diskutuar lidhur me planin rregullues, ku ka marrë pjesë nënkryetari Rexhep Kadriu, drejtori për Urbanizëm, Valon Shefkiu dhe drejtori për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë, Sadudin Berisha. Në debatin, në të cilin morën pjesë shqiptarë e serbë, nënkryetari Kadriu tha se Komuna ka një plan shumë të mirë zhvillimor të kësaj lagjeje, të cilën e ka quajtur “Gjilani i Ri”. “Politikat zhvillimore të Komunës në krye me Lutfi Hazirin, janë që brendësia e kësaj zone të zhvillohet dhe kostoja e pronave tuaja do të shumëfishohet. Ky është interes i juaj sepse po e bëjmë një zonë të re që do të quhet “Gjilani i ri”. Shumë shpejt do të nis rruga Gjilan-Bujanoc, e cila do të bëhet me standarde europiane”, tha Kadriu. Ai ka garantuar qytetarët se shpronësimi do të bëhet në mënyrë më të mirë të mundshme dhe se vlerësimin do ta bëjë një Komision Qeveritar, ndërsa ka shtuar se zhvillimi i

kësaj lagjeje përkthehet me zhvillim ekonomik dhe hapje të vendeve të reja të punës. Ndërkaq, Valon Shefkiu, drejtor për Urbanizëm, the se në kuadër të kësaj zone është paraparë plani për banim kolektiv dhe individual, pastaj hapësirat publike, shkollat, çerdhet, ambulancat dhe specifike më e veçantë është planifikimi për ndërtimin e kompleksit universitar tek kazerma e FSK-së. Sadudin Berisha, drejtor për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, ka pohuar se kompensimi do të bëhet në mënyrë më të mirë, duke u thirrur në ligjet që e rregullojnë këtë fushë, për të shtuar se vetëm me bashkëpunim të ndërsjellë do të arrijnë ta realizojmë këtë plan për këtë lagje, i cili sipas tij, është shumë modern dhe funksional. Shumë pyetje dhe interesime kanë shprehur qytetarët si: Imri Murtezi, Momqillo Stankovic, Mehmet Krasniqi, Endrit Stublla, Musli Krasniqi etj., të cilët kryesisht u interesuan për detaje rreth shpronësimit, e të cilëve me kënaqësi u janë përgjigjur përfaqësuesit e Komunës së Gjilanit.

Gjilani pranohet në Konventën e kryetarëve të Komunave në Bruksel

02

TETOR

Pas projektit të fituar muaj më parë për implementimin e efijencës së energjisë, përkatësisht për hartimin e SEAP, Komuna e Gjilanit është pranuar sot në Konventën e kryetarëve të Komunave në Bruksel. Gjilani është Komuna e parë në Kosovë që bëhet pjesë e kësaj organizate ndërkombëtare, ku deri tani janë pranuar vetëm kryeqytetet. Pranimin në këtë Konventë do ta nënshkruaj kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, më 15 tetor 2015 në konferencën vjetore të BE-së për një Europë me energji të qëndrueshme. Kryetari Haziri ka shprehur zotimin që të shkojë përtej objektivave të vendosura nga BE për vitin 2020, duke reduktuar emetimin e CO2 për 20 për qind, të paraqesë një Plan Veprimi të Energjisë së Qëndrueshme, të paraqesë një raport të zbatimit të paktën çdo të dytin vit pas dorëzimit të Planit të Veprimit për qëllime të vlerësimit, monitorimit dhe verifikimit, të organizoj Ditet e Energjisë, sikurse që do të marrë pjesë dhe të kontribuoj në konferencën vjetore të BE-së për kryetarët e Komunave për një Europë me energji të qëndrueshme. Ndryshe, Komuna e Gjilanit është e para në nivel vendi që është pranuar në Konventën e kryetarëve të Komunave në Bruksel, ndërkaq në vendet e rajonit vetëm kryeqytetet janë të pranuar në këtë organizatë.



Historia e Gjilanit e përmbledhur në një libër

03
TETOR

Botim serioz, i veçantë dhe i shkruar me shumë besnikëri, puna e autorit Aliriza Selmani është kolosale, nëpërmjet të të cilës ai ndriçon objekte e monumente, është i thellë në shpjegimin e fenomeneve dhe nuk është vetëm një përshkrues i thjeshtë, por bënë krahasime të thella e të thukhtë dhe ndriçon të kaluarën e Gjilanit me rrethinë, ka thënë dr. Daut Bislimi. Abetare për historinë e Gjilanit, kështu është vlerësuar libri “Gjilani me rrethinë prej themelimit deri në gjysmën e parë të shekullit XX”, i autorit Aliriza Selmani, i cili është promovuar këtë të shtunë në ndërtesën e Teatrit të Qytetit në Gjilan i mbështetur dhe financuar nga kryetari i Komunës, Lutfi Haziri. Me këtë rast, Valentina Bunjaku - Rexhepi, kryesuese e Asamblesë Komunale, në emër të kryetarit Haziri, ka thënë se duke ditur vlerat që ka ky libër, komuna e ka përkrahur botimin e tij, ndërsa për studentët është material me rëndësi gjatë studimeve të tyre. Ajo ka thënë se ky libër mbush një boshllëk në historinë e Gjilanit. Ajo këtë libër e ka cilësuar botim serioz, të veçantë dhe të shkruar me shumë besnikëri, kurse punën e autorit e ka cilësuar kolosale. Kurse, Daut Bislimi, recensent i librit ka thënë se nëpërmjet këtij ndriçohen objekte e monumente, është i thellë në shpjegimin e fenomeneve dhe nuk është vetëm një përshkrues i thjeshtë, por bënë krahasime të thella e të thukhtë dhe ndriçon të kaluarën e Gjilanit me rrethinë. “Aliriza Selmani bëri një vepër të afërt, të duhur e të mirëpritur. Një botim serioz dhe i pari i tillë me këso përmbajtje”, ka thënë Daut Bislimi. Adem Murati, ka folur për biografinë e autorit, për të cilin tha se gjithmonë në punimet dhe veprat e tija ka pasur një qëndrim të drejtë sa i përket çështjes shqiptare. Për Gjilanin dhe të kaluarën e tij foli edhe Enver Gjinolli, njëri nga pinjollët e familjes Gjinolli, që konsiderohen si themelues të Gjilanit. Ai foli për Konakun e dikurshëm të Gjinollëve që nuk është më, sikurse edhe për shumë monumente që tashti i



mungojnë Gjilanit. Vetë autori Aliriza Selmani, ka theksuar se njeriu gjithmonë i ka borxh vendlindjes së tij, andaj kjo ka qenë arsyeja që i është rrekur punës për të shkruar një libër që flet për të kaluarën e Gjilanit dhe në hartimin e tij është bazuar në intervistat që ka bërë me njerëz në vitet tetëdhjeta, në dokumentet e shumta dhe në bibliografinë e bollshme. Autori është mbështetur në hulumtimet arkeologjike të bëra, por edhe në dokumentet dhe sidomos në defterët osmane, ku ka të dhëna për popullsinë dhe jetën që zhvillohej në Gjilan e rrethinë. Sipas tij, Gjilani si qytet (kasaba) është themeluar në gjysmën e dytë të shekullit XVIII nga familja feudale e Gjinollëve. Ai flet edhe se si Gjilani me kohë u bë një qendër zejtare, bujqësore e blegtorale, për t'u shndërruar më pas në një nga qendrat kryesore të Kosovës me një rëndësi strategjike, ekonomike e politike, gjë të cilën e përmendin edhe shumë misionarë diplomatikë, udhëpërshkrues e shkencëtar të kohës., që lanë shënime për këtë qytet. Autori trajton edhe aspektin gjeografik, administrativ, onomastik dhe aspekte të tjera, duke përshkruar tërë historinë nëpër të cilën kaloi ky qytet, i cili në fund të shekullit XIX kishte një hapësirë të gjerë me mbi 200 fshatra dhe ku kryqëzoheshin rrugë të rëndësishme me karakter ekonomik dhe strategjik e ushtarak. Ai flet edhe për zhvillimin e tregtisë e zejtarisë, veprimtarinë ekonomike, zhvillimin urban, atë kulturor, arkitekturën e shtëpive, objekteve të kultit, haneve, të objekteve, të infrastrukturës rrugore, të rrugëve të shtruara me kall-drëm dhe të infrastrukturës tjetër, e cila tashti i mungon këtij qytetit. Autori flet edhe për arsimin , për shkollat e dikurshme, për Gjilanin në periudha të ndryshme, për atë se si dukej në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, gjatë dhe pas Revolucionit Xhonturk, për kohën kur u shtrua çështja e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, gjatë kohës së luftërave për çlirim e për këtë territor deri në gjysmën e parë të shekullit XX.



Bashkësitë fetare pastrojnë xhaminë dhe kishën në Dunav

04
TETOR

Me iniciativë të kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, bashkësitë fetare në Gjilan kanë pastruar sot Xhaminë e njohur si “Xhamia e Mulla Idriz Gjilanit” e ndërtuar në vitin 1936 dhe Kishën “Shën Ana”, e ndërtuar në vitin 1938 në fshatin Dunav të Karadakut. Në aktivitetin e parë të “Muajit të Tolerancës dhe Solidaritetit” ka marrë pjesë Naim Aliu nga Bashkësia Islame në Gjilan, Dom Dominik Qerimi nga Kisha Katolike, Naim Bllaca nga Kisha Protestante, si kurse edhe besimtarët e tri besimeve fetare. “Është ide e kryetarit Haziri që Komuna të organizoj aktivitete të përbashkëta me bashkësitë fetare me qëllim të zhvillimit dhe kultivimit të tolerancës ndërfaqetare dhe ndëretnike”, ka thënë këshilltari i kryetarit Haziri, Halit Rexhepi. Tre përfaqësuesit e Komuniteteve fetare kanë shprehur falënderim për nismën e kryetarit Lutfi Haziri për këto aktivitete, duke thënë se Gjilani është shembull sa i përket tolerancës fetare dhe ndëretnike në nivel vendi. “Fshati Dunav është i vetmi që ka edhe xhami edhe kishë dhe e falënderoj kryetarin Haziri që na ka bërë bashkë për pastrimin e objekteve fetare, e që tregon se Gjilani është qyteti më tolerant në aspektin ndërfaqetare në Kosovë. Që nga Lufta e Dytë Botërore në Gjilan nuk mbahet në

mend që ka pasur ndonjë problem mes besimtarëve të feve dhe dallimeve fetare. Do të jemi pjesëmarrës në të gjitha aktivitetet që do të organizohen në kuadër të muajit të tolerancës”, ka deklaruar Naim Aliu, përfaqësuesi i Bashkësisë Islame në Gjilan. “Rindërtimi, pastrimi ose përpjekja për të përmirësuar gjendjen e objekteve fetare është një shenjë simbolike që tregon se është marrëdhënia jonë njerëzore, e cila, duhet të jetë rindërtim dhe një rifillim i një dialogu, ku ne duhet të punojmë së bashku në ndërtimin e shtëpisë së Zotit. Uroj që muaji tetor të bëhet tradicional sikurse “Flaka e Janarit”. Iniciativa e tillë e ndërmarrë mendoj se është një karakteristikë e Komunës së Gjilanit”, është shprehur nga ana e tij Dom Dominik Qerimi, përfaqësues nga Kisha Katolike në Gjilan. “Është për t’u përshëndetur ky hap i kryetarit Haziri sepse është një promovim i tolerancës dhe ndërtim i fuqishëm i marrëdhënieve njerëzore në mesin e komuniteteve fetare. Kjo tregon se Gjilani është shembull i kultivimit të tolerancës fetare”, ka thënë Naim Bllaca, nga Kisha Protestante “Ringjallja” në Gjilan. Në kuadër të Muajit të Tolerancës dhe Solidaritetit, në Gjilan do të organizohet edhe një turne futbollit, një ekspozitë dhe një tribunë me temën “Toleranca ndërfaqetare në Komunë dhe me gjerë”.



Bunjaku-Rexhepi: Opozita së pari duhet t'i fitojë zgjedhjet dhe pastaj të caktojë agjendën e Kuvendit

13
TETOR

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendi Komunal, e thirrur me kërkesën e opozitës, për të diskutuar për gjendjen në arsim, ka dështuar të mbahet për shkak të mungesës së numrit të nevojshëm të anëtarëve. Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, pas verifikimit të prezencës së këshilltarëve, ka konstatuar, se nuk ka kuorum për të mbajtur seancën, duke nënvizuar se kjo do të thotë që LDK-ja si partia më e madhe cakton agjenda dhe mund të thërras seancën. Ftesës për seancë të jashtëzakonshme i ishin përgjigjur 13 anëtarë të Kuvendit nga radhët e PDK-së, VV-së dhe disa subjekteve të vogla, ndërkaq munguan përfaqësuesit e LDK-së, AAK-së dhe Lëvizjes “Vatra”, që përbëjnë koalicionin qeverisës. Në mesin e atyre që munguan kishte edhe prej atyre që kishin nënshkruar kërkesën për seancë të jashtëzakonshme. Në një konferencë me gazetarë, kryesuesja e Kuvendit Komunal, Valentina Bunjaku-Rexhepi, së bashku me dy shefat e grupimeve politike në koalicion LDK-AAK, Avdyl Aliu e Selami Xhemajli, ka sqaruar se opozita, së bashku me disa parti të vogla, kishte mbledhur 16 nënshkrime për të ftuar seancë të jashtëzakonshme, por siç u pa disa prej tyre munguan. “Opozita nuk pati numra për të mbajtur seancën. Ata së pari duhet t'i fitojnë zgjedhjet dhe pastaj mund t'i caktojnë agjendat e Kuvendit Komunal”, ka thënë ajo. Bunjaku-Rexhepi ka thënë se nënshkrimet për seancë të jashtëzakonshme ishin mbledhur në mënyrë tinëzare, për të shtuar se opozita duhet ta kuptojë fuqinë e saj në Ku-

vend Komunal, ku agjendën e cakton partia fituese e zgjedhjeve – LDK, bashkë me partnerin e koalicionit, AAK-në. Ajo ka mohuar akuzat e opozitës se është në shërbim të LDK-së, duke thënë se në Kuvend u ka krijuar mundësi të barabarta diskutimi të gjitha subjekteve politike e sidomos opozitës, por nuk e mohon se i përket këtij subjekti politik, përmes të cilit e ka marrë besimin e qytetarëve për të qeverisur dhe për çka i falënderon ata. Sa i përket gjendjes në arsim, Bunjaku-Rexhepi ka thënë se nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Drejtori i tashëm i Arsimit e ka ndaluar të keqen e madhe në arsim, që e kishte shkaktuar qeverisja e PDK-së, duke lënë 138 të punësuar në mënyrë të paligjshme. “Opozita nuk ka të drejtë morale të akuzoj të tjerët për gjendjen në arsim, kur e di mirë se në çfarë gjendje e ka lënë këtë sektor dhe çfarë barre të rëndë i ka lënë qeverisjes sonë, me një numër kaq të madh të të punësuarve jashtë kritereve”, ka thënë Bunjaku-Rexhepi. Kryesuesja e Kuvendit Komunal ka paralajmëruar se për problematikat në arsim do të diskutohet në seancën e radhës së Kuvendit Komunal, në pikën nën të ndryshme dhe opozita do të ketë rast t'i shpreh mendimet e saj, sikur e ka pasur këtë mundësi gjithmonë dhe për të gjitha çështjet. Sa u përket protestave, të cilat janë përmendur nga opozita si mundësi, në një konferencë me gazetarë të mbajtur nga PDK e VV, Bunjaku-Rexhepi ka thënë se opozita mund të dalë në rrugë, të thyej e shkatërroj, por duhet ta kuptojë se me sjellje të tilla mund t'i humb edhe këto pak vende që i ka në asamblenë komunale.



Haziri e Bajrami, projekte të përbashkëta për të përmirësuar mirëqenien e qytetarëve

14
TETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga kryesuesja Valentina Bunjaku Rexhepi, nënkryetari Rexhep Kadriu dhe drejtori i DZHE-së, Agim Zuzaku, ka pritur sot në një takim ministren e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, me të cilën kanë biseduar për zhvillimin ekonomik, nevojën për hapjen e një zone industriale, komunitetin e biznesit dhe çështje tjera të këtij lëmi. Kryetari Haziri, në adresimin para mediave, e ka falënderuar ministren Bajrami për vizitën, për të cilën tha se e ka nderuar sot Gjilanin, e cila do të bisedojë edhe me komunitetin e biznesit lidhur me zhvillimin lokal ekonomik. “E njoftova ministren për mundësitë tona, për potencialet e Gjilanit dhe natyrisht ajo që do të bisedoj me bizneset dhe ndërmarrësit në Gjilan. E nënvizova rëndësinë e madhe që e ka Gjilani në zhvillimin lokal ekonomik. Mbështetja e ministres shumë e rëndësishme dhe në interes për Komunën tonë”, tha kryetari Haziri. Ministrja e MTI-së, Hykmete Bajrami, e ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen ka ardhur në Gjilan dhe përkrashjen që ka ofruar për komunitetin e bi-

znesit. “Sot kemi ardhur të bisedojmë me përfaqësuesit e bizneseve të Gjilanit dhe natyrisht e pamë të arsyeshme të bashkëbisedojmë fillimisht me kryetarin e Komunës. Konsideroj se në bashkëpunim me Komunën mund të bëjmë shumë projekte të mira si, krijimin e zonave industriale, tërheqjen e investimeve të huaja, në mënyrë që të lëvizim tutje agjendën ekonomike. Me kryetarin Haziri u zotuam që të punojmë në projekte të përbashkëta në mënyrë që të përmirësohet mirëqenia e qytetarëve të kësaj pjese”, është shprehur ministria Bajrami. Më pastaj, ministria Bajrami dhe përfaqësues të Komunës së Gjilanit kanë marrë pjesë Konferencën Informative për Zhvillimin e Sektorit Privat, ku edhe janë shpërblyer tri kompanitë të cilat kanë qenë tatimpagueset më të mira si dhe për suksesin në veprimtarinë e tyre: “Agro Market KS”, “Flexograf” dhe “ABC Design”. Ndërkohë, kryesuesja Bunjaku Rexhepi, nënkryetari Rexhep Kadriu dhe ministria Bajrami kanë vizituar tri kompani në Gjilan, të cilat janë rrëfime të suksesit, “Enrad”, Flexograf” dhe “Palma”, ku kanë parë nga afër punën e mirë që po bëhet në veprimtaritë e tyre.

Kadriu: Çdo vend i ri pune është shumë i rëndësishëm për zhvillim

15
TETOR

Investimet e donatorëve në Gjilan, si në sektorin privat, po ashtu edhe në atë publik, janë të shumta dhe në disa fusha. Një pjesë e tyre është finalizuar, kurse pjesa tjetër janë në proces e sipër. Nënkrjetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, ka thënë se çdo vend pune është i mirëseardhur për ne, duke shtuar se këto biznese punësojnë nga disa punëtorë. “Investimi në sektorin privat, është investim në punësim”, ka thënë përfaqësuesi i BE në Kosovë, Christof Stock. Sot në Gjilan ka qëndruar përfaqësuesi i BE – së në Kosovë, Christof Stock, Besian Mustafa, Drejtor Ekzekutiv i KIESA në Ministrinë e Tregtisë, Arta Musa - Krasniqi, Task Manager në zyrën e BE-së në Kosovë dhe përfaqësuesit e IOM – it (MSME ekipi për Grante), të cilët kanë vizituar dy bizneset, rrobaqepësen “Festa”, e cila bënë prodhimin e veshjeve për femra, dekorimin e ambienteve etj., dhe biznesin tjetër “Gan Dizajn”, që merret me dizajnë të ndryshme, gravim, shtyp dhe produkte të tjera të llojllojshme. Me këtë rast, përfaqësuesi i BE – së në Kosovë, Christof Stock, gjatë vizitës në këto biznese ka thënë se angazhimi i grave në punësim në njërin biznes, në një formë është pavarësia ekonomike e tyre dhe siguri më e madhe, sikur që edhe angazhimi në dizajn i biznesit tjetër është një hap tjetër drejt modernizimit të shtypit të këtij lloji. “Investimi në biznesin privat, është investim në punësim, siç ka ndodhur me këto dy biznese. Zyra jonë Rajonale në Gjilan gjatë të ardhmes do të ketë edhe grante të tjera që do të ndihmojnë bizneset e reja apo ato ekzistuese në zgjerim dhe zhvillim, me qëllim të punësimit të qytetarëve”, tha Stock, ndër të tjerash,

derisa është ndarë i kënaqur me punën dhe angazhimin që bëhet në këtë drejtim. Kurse nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, në emër të kryetarit Lutfi Haziri, ka thënë se punësimi i vetëm një qytetari është i mirëseardhur për ne, por kur këto biznese deklarojnë për punësime prej disa punëtorëve, kjo është edhe më mirë. “BE, IOM dhe qeveria e Kosovës me investimet e tyre dhe angazhimin tonë, sot po shohim dy biznese që janë në vllugun e punës në fusha të ndryshme. Pamë me shumë vllug të punës prodhimin e veshjeve për femra dhe realizimin e kërkesave të ndryshme që aty janë nga restorantet më të mëdha në Gjilan, po ashtu edhe biznesi tjetër që merret me dizajn dhe shtyp modern të logove, mirënjohjeve, medaljeve të shumta, punën në gravim në material të ndryshme etj. Është fat shumë i mirë se pos këtyre dy bizneseve kemi edhe disa të tjera që janë përfitues dhe që janë në proces të finalizimit të punës së tyre dhe aktivizimit si biznese. Në të njëjtën kohë, sot në Gjilan kemi edhe projekte të tjera publike që janë të investuara nga BE, qeveria dhe Komuna, e të implementuara nga IOM”, tha Kadriu, duke shtuar se Komuna e Gjilanit është një ombrellë e gjerë e mbështetjes për sektorin privat të biznesit, sepse janë pikërisht bizneset ato që kanë mundësi më të mëdha të punësimit të qytetarëve me një mbështetje më të fuqishme institucionale. Biznesi për prodhimin e veshjeve për femra, tashmë ka disa kontrata të lidhura me restorantet e Gjilanit për prodhimin sipas kërkesave të tyre, që e bënë edhe më të sigurt këtë prodhues, sikur që ka ndikuar të rrisë veprimtarinë nga 2 punëtorë në gjashtë me kontrata të rregullta, e gjatë sezonit të verës ky numër arrin në 11 punëtorë. Pretendimet sipas menaxhmentit janë rritja e mëtutjeshme në disa punëtorë dhe kalimin në rangun e bizneseve të mesme, sepse kërkesat tashmë kalojnë kufijtë e shtetit të Kosovës dhe në këtë drejtim ka porosi dhe interesime edhe nga Shqipëria, Maqedonia dhe Serbia. Kurse, Gani Kastrati nga biznesi “Gan Dizajn”, ka thënë se investimi që ka bërë BE, së bashku me qeverinë, IOM – in dhe me mbështetjen e Komunës së Gjilanit, kanë bërë të mundur që të rris numrin e produkteve, kapacitetet prodhuese dhe modernizimin e punës me shtyp dhe dizajn. Kastrati, ka thënë se me këto pajisje dhe me mbështetje edhe të Komunës së Gjilanit bëhet e mundur avancimi i veprimtarisë së tij. Ai ka potencuar se janë kryesisht porosi që punohen për institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, por edhe për të interesuar të tjerë.



Haziri nënshkruan anëtarësimin e Gjilanit në Konventën e Kryetarëve në Parlamentin European

15
TETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në ambientet e Parlamentit European në Bruksel sot zyrtarisht ka nënshkruar aktin e anëtarësimit të Komunës në Konventën e Kryetarëve të Komisionit European- një lëvizje europiane që përfshinë autoritetet lokale dhe rajonale. Anëtarë të kësaj Konvente janë edhe Londra dhe Parisi, dy kryeqendra të rëndësishme botërore. Kryetari Haziri ka shprehur zotimin që të shkojë përtej objektivave të vendosura nga BE për vitin 2020, duke reduktuar emetimin e CO2 për 20 për qind, të paraqesë një Plan Veprimi të Energjisë së Qëndrueshme, të paraqesë një raport të zbatimit të paktën çdo të dytin vit pas dorëzimit të Planit të Veprimit

për qëllime të vlerësimit, monitorimit dhe verifikimit, të organizoj Ditet e Energjisë, sikurse që do të marrë pjesë dhe të kontribuoj në konferencën vjetore të BE-së për kryetarët e Komunave për një Europë me energji të qëndrueshme. Po ashtu, anëtarësimin në Konventën e Kryetarëve e ka nënshkruar edhe Komuna e Podujevës, përkatësisht kryetari i saj, Agim Veliu. Vlen të theksohet se anëtare të Konventës së Kryetarëve të Komisionit European është edhe Londra e Parisi. Ndryshe, ky anëtarësim vjen me ndërmjetësimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës me institucionet europiane dhe me mbështetjen e organizatës gjermane GIZ / Fondi Rajonal për Zhvillim.



Bemporad: Jam i impresionuar me tolerancën ndërfetare dhe ndëretnike në Gjilan

17
TETOR

Me iniciativë të kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, është organizuar sot një pritje për një delegacion të Qendrës Joprofitabile për Mirëkuptim Ndërfetar (CIU), me seli në SHBA, në kuadër të muajit të tolerancës dhe solidaritetit. Nënkr-yetari i Komunës, Rexhep Kadriu ka nënvizuar faktin se Komuna e Gjilanit ka një traditë të gjatë të promovimit të tolerancës ndërfetare dhe këtë vlerë e ka ruajtur edhe pas luftës. Në këtë takim ka marrë pjesë nënkryetari Rexhep Kadriu, kryesuesja Valentina Bunjaku Rexhepi, drejtori i Qendrës Joprofitabile për Mirëkuptim Ndërfetar (CIU) me seli në SHBA, Jack Bemporad, apo Rabin – prijës i komunitetit fetar hebraik, anëtarë të KKSB, përfaqësues nga bashkësitë fetare, nga Policia e Kosovës, FSK dhe qytetarë të shumtë. Në emër të kryetarit Haziri ka folur nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, i cili e ka falënderuar z. Rubin Jack Bemporad për ardhjen me delegacionin e tij në Gjilan, i cili është i njohur për punën dhe aktivitetin e tij të gjatë në promovimin e paqes, tolerancës ndërfetare dhe bashkëjetesës në mes të grupeve të besimeve të ndryshme. “-

Komuna e Gjilanit ka një traditë të gjatë të promovimit të tolerancës ndërfetare, e cila traditën ka vazhduar edhe në periudhën e pasluftës, duke iu ofruar kushte jetese dhe ushtrim të aktiviteteve fetare të gjitha besimeve fetare. Këtë më së miri e dëshmon edhe prania e grupeve të ndryshme fetare në këtë takim”, u shpreh Kadriu. Ndërkaq, në adresimin para të pranishmëve, drejtori i Qendrës Joprofitabile për Mirëkuptim Ndërfetar (CIU) me seli në SHBA, Rubini Jack Bemporad, ka thënë se është impresionuar me tolerancën ndërfetare e ndëretnike që e ka gjetur në Gjilan. “Gjatë vizitës në Gjilan i kam takuar krerët e besimeve fetare dhe në secilin takim kam pranuar një ngrohtësi apo thënë më ndryshe një përqaftim. Jam i impresionuar me tolerancën ndërfetare e ndëretnike që e kam gjetur në Gjilan, sikur edhe me bashkëpunimin dhe bashkëjetesën në mes tyre”, ka deklaruar Rubini Jack Bemporad. Në këtë takim ka folur edhe kryesuesi i KKSB-së, Halit Rexhepi dhe komandanti i policisë lokale, Remzi Azemi, të cilët thanë se në Gjilan nuk ka asnjë incident të natyrës etnike apo religjioze, duke u shprehur krenarë për këtë.



Akademi përkujtimore për Metush Krasniqin

17
TETOR

Nën organizimin e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, sot është mbajtur akademia përkujtimore kushtuar 29-vjetorit të vdekjes së heroit Metush Krasniqi, i cili ishte në krye të organizimit të Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare. Nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, ka thënë se rezistenca gjithë shqiptare kundër okupatorit serb ishte organizuar dhe projektuar nga heroi Metush Krasniqi. “Vlerat kombëtare dhe organizimet ishin të projektuara dhe të prira nga vet Metushi i cili rrjedh nga një familje me traditë dhe e dëshmuar për atdhedashuri. Meqë atdhetari ynë Metush Krasniqi gëzonte një autoritet të madh në mesin e rinisë shkollore dhe universitare, në Kosovë e në Maqedoni, ai kishte formuar një rreth të gjerë shokësh besnikë, me të cilët edhe ka vepruar ndër vite si me: Hasan Dermaku, Rexhep Mala e Skënder Kastrati, Njazi Korça nga Gëmica, Kadri Zeka nga Poliçka, Ethem e Fehmi Bajrami nga Malishe-

va e Gjilanit, Rexhep Elmazi e Rafet Bajrami nga Gjilani, Jusuf Gërvalla, Zeqir Gërvallën e Sabri Novosellën në Prishtinë, Shefqet Jasharin e shumë të tjerë. Në nëntor të vitit 1958 Metush Krasniqi u burgos dhe u dënua me 18 vjet burg të rëndë prej të cilave i mbanë 8 vjet. Pas daljes nga burgu Metush Krasniqi i kaloi disa vite në fshatin e lindjes në Dajkoc. Ai ishte mësues dhe më vonë edhe drejtor shkolle, por me vendime të njëanshme të sistemit serb ai largohet nga procesi edukativo - arsimor. Krasniqi, ishte një figurë frymëzimi për të rinjtë e kësaj kohe, që të vazhdohet edhe më tutje në organizim dhe ngritje kundër sistemit serb, i cili kishte nën shënjestër figurat si Krasniqi”, tha ndër të tjera Kadriu. Nexhat Rexha u paraqit me studimin publicistik, kurse Blerim Haziri, me një studim historik për figurën e Metush Krasniqit. Në emër të familjes, Lule Krasniqi, falënderoi Komunën e Gjilanit për organizimin, kurse të pranishmit, për nderimin që i bënë figurës së Metush Krasniqit.

Ambasada Amerikane ndan diploma për vijuesit e “Access Program”



17
TETOR

Organizuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, sot në Gjiilan janë ndarë diplomat për nxënësit të cilët kanë përfunduar programin “English Access Microscholarship Program”, për vitin 2013 – 2015, si dhe fillimin e këtij programi nga nxënësit tjerë për vitin 2015 – 2017. Vijuesit janë nxënës nga Komuna e Gjiilanit dhe Kamenicës, të përkatësive të ndryshme etnike, si shqiptarë, serbë, romë dhe komunitete të tjera. Ambasadori Amerikan në Prishtinë, Gregory Delawie, ka thënë në këtë ceremoni se ndjehet shumë mirë që është duke folur para një grupi të madh të të rinjve, të cilët në një të ardhme të afërt, do të jenë udhëheqës biznesi, profesor, mjekë, politikan, madje ndoshta edhe diplomat. “Ky grup nga Gjiilani dhe Kamenica që po marrin diplomat sot dhe atyre që do të ndjekin programin në dy vitet e ardhshme, do të jenë kuadrot të përgatitura për të ardhmen e tyre dhe ndikimin pozitiv në zhvillim dhe në ngritje të vlerave demokratike në Kosovë. Sot përpara po shoh të rinj që në të ardhmen e afërt do të jenë, biznesmen, profesor, mjekë, politikan apo edhe diplomat të ardhshëm. Ju mund të vini nga shkolla dhe komunitete të ndryshme, por ju do të jeni ata që do ta bëjnë Kosovën një shtet të gjallë multietnik. Të diplomuarve të sotëm u them urime pas dy vjet pune dhe studimi intensiv. Ky sot është vetëm një moment nga rrugëtimi juaj i gjatë që do ta keni para vetes. Access do t’u duhet gjatë gjithë jetës, njohurit që keni fituar për dy vite do t’i përdorni tërë jetën”, ka thënë ndër të tjerash ambasadori Delawie. Ndërsa kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjiilanit, Valentina Bunjaku – Rexhepi, ka thënë se ky program dhe ky organizim nga Ambasada Amerikane, është një element shumë i fuqishëm në ngritjen dhe zhvillimin e shtetit të Kosovës. “Sot po shënojmë një sukses të të rinjve tanë. Është moment shumë i mirë të shohim këto rezultate të arritura për vetëm dy vjet të stu-

dimeve tuaja. Ambasada Amerikane, e përmes saj populli Amerika, janë ata të cilët që nga viti ’99, nuk janë ndalur asnjëherë së ndihmuari vendin tonë, në zhvillim, ndërtim, në integrim, në ngritje të vlerave demokratike etj. Gjatë gjithë kësaj kohe ne kishim një mbështetje të fuqishme nga kjo ambasadë, nga populli amerikan, USAID dhe mekanizma të tjerë në investime në të gjitha fushat, që na bënë rrugën tonë më të sigurt dhe më të lehtë. Në çdo program apo punë që mbështet ose organizon Ambasada Amerikane, secili nga ne shohim përherë shumë shembuj të mirë dhe ju porosis veçanërisht juve nxënësve që të merrni maksimumin e asaj që mund të mësoni nga ky program në pasurimin e memories suaj, sepse ta dini që çdo mësim i sotëm do t’u shërbej gjatë gjithë jetës”, përfundoi ajo. Me këtë rast edhe Kushtrim Morina koordinator i këtij grupi ka thënë se programi Access, është program i unifikimit dhe i bashkimit të të gjitha komuniteteve. “Programi access është program i bashkimit të të gjithë të rinjve nga komunitete të ndryshme, i unifikim të vlerave të përbashkëta. Për dy vjet me radhë nxënësit e të rinjtë nga komunitete të ndryshme kanë mësuar për kulturën amerikane, për vlerat demokratike, ndjeshmërinë ndaj dallimeve kulturore, duke bërë kështu që të përvetësojnë shumë mirë gjuhën angleze. Gjatë dy viteve, dy klasë, të vetmet në Kosovë, kanë punuar së bashku, kanë mësuar për kulturën e njëri – tjetrit, kanë krijuar miqësi dhe e gjithë kjo ishte falë programit access. Gjatë 360 orë mësimdhënieje, sa kanë ndjekur nxënësit për dy vite, mësuanglishten rrjedhshëm, si në ambiente formale ashtu edhe në ambiente joformale. Vlerësimet zyrtare tregojnë se këta nxënës janë kandidat të fuqishëm për studimet në Ballkan”, tha ai ndër të tjerash. Gjithashtu janë organizuar edhe pjesë teatrale dhe deklamime të ndryshme që janë produkt i studimeve në këtë program.



Haziri: Nëntë muajt e qeverisjes, me sfida e progres

20
TETOR

Nën udhëheqjen e kryetarit të Komunës së Gjiçanit Lutfi Haziri, është mbajtur sot mbledhja e radhës e bordit të drejtorëve, për të diskutuar për 9-mujorin e punës së vitit 2015. Kreu i Gjiçanit paralajmëroi se tre muajt e fundit të këtij viti, do të jenë edhe më dinamik në realizimin e projekteve, për t'ua bërë jetën më të mirë qytetarëve të kësaj komune. Raporti i punës do t'u dorëzohet edhe këshilltarëve komunalë. Në takim, kryetari Haziri, pasi ka dëgjuar raportimet e të gjithë drejtorëve, ka konkluduar se nëntë muajt e qeverisjes së tij gjatë këtij viti ishin plot sfida, por që tha se e gëzon fakti që ka progres në shumë fusha, duke shtuar se ka vazhduar qeverisjen me dyer të hapura, duar të pastra dhe me një dietë të ashpër sa u përket shpenzimeve. Prej sukseseve më të mëdha gjatë nëntë mujorit të punës është vlerësuar ndërtimi 17-të shtëpive për familjet që kanë probleme me banim. Kryetari Haziri tha se do të vazhdohet me këtë ritëm, derisa siç tha, “t'i nxjerrim të gjitha familjet nga gjendja e rëndë e banimit”. Te sektori i arsimit, u tha se ka progres sa i përket ngritjes së cilësisë, e që e dëshmon edhe suksesi i nxënësve gjilanas, që gati në të gjitha garat janë kthyer me vendin e parë, të dytë ose të tretë. Ndërkohë, mbi 200 mijë euro janë inkasuar më

shumë krahasuar me vitin e kaluar nga lejet e ndërtimit në kuadër të urbanizmit, pastaj është filluar me hapjen e rrugëve në “Fidanishte” për të vazhduar me “Monte-ith” e “Livadhet e Arapit”. Në këtë mbledhje u vlerësuan reformat në administratë, rritja e cilësisë së shërbimeve përmes avantazheve të teknologjinë informative, rritja e performancës, implementimi i projektit “Telework” etj. Gjatë kësaj mbledhjeje të kryetarit Haziri me drejtorët komunalë, është vlerësuar suksesi në implementimin e katërshes së prioritetëve, ku po vazhdohet me heqjen e lloçit dhe vadave gjithandej territorit të komunës së Gjiçanit. Po ashtu, janë përmendur edhe sukseset në sektorin e bujqësisë, bie fjala për rritjen e subvencioneve, dhënia e mekanizimit bujqësor, ndërtimi i rrugëve të arave, ndërkaq u paralajmërua se këto ditë pritet të fillojë shpërndarja e farës së grurit. Në mbledhje janë përmendur sukseset në shëndetësi, kadastrë e gjeodezi, kulturë, rini e sport etj. Kreu i Gjiçanit, Lutfi Haziri, paralajmëroi se tre muajt e fundit të këtij viti do të jenë edhe më dinamik në realizimin e projekteve për t'ua bërë jetën më të mirë qytetarëve. Ndryshe, raporti i kryetarit Haziri për nëntë mujorin e punës do t'i dorëzohet me shkrim asamblistëve të Kuvendit Komunal të Gjiçanit, në seancën e radhës.



Ndahen certifikata për zejtarët

23
TETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga nënkryetari dhe drejtorët e drejtorive komunale, kanë bërë sot ndarjen e certifikatave nga trajnimi i më shumë se 50 zejtarëve të profileve të ndryshme, në kuadër të programit që financohet nga Komisioni Evropian dhe Komuna e Gjilanit, për bashkëpunimin, mbështetjen dhe zhvillimin e këtyre zejeve që janë pasuri e kulturës gjilanasë. Me këtë rast kryetari Haziri, ka thënë se me këtë program që po realizohet me mbështetjen e fuqishme edhe të Komisionin Evropian, qëllim ka valorizimin e vlerave tradicionale që i ka Komuna jonë. “Ky projekt që është mbështetur nga Komisioni Evropian, në Komunën e Gjilanit dhe Çairit, qëllim ka valorizimin e zejeve – vlerave tradicionale, duke i dhënë mbështetje sa më të madhe zejtarëve në forma të ndryshme, për të ruajtur zanatin e trashëguar. Pretendojmë të krijojmë hapësirë për trashëgimi duke absorbuar vlerat e përbashkëta. Trashëgimia nuk i takon individit, grupit apo etnisë, por është e përgjithshme dhe u takon gjithë popujve kudo që janë, sepse këto vlera që ju i punoni dhe ruani, janë vlera të njerëzimit. Këto vlera kanë përballuar sfida të rënda gjatë jetës, por,

tashmë do të jenë kushte më të mira dhe mundësi më të mëdha. Gjatë ditës së sotme do të publikohen edhe kriteret për grante që mundësojnë dhe do të jenë një garant i mundësive më të mëdha për zhvillimin e zejeve në Gjilan”, tha në fjalën e tij kryetari Haziri, duke paralajmëruar se gjatë të ardhmes ky program që sot është në fazën e parë do të zgjerohet edhe më tutje. Në emër të zejtarëve Shyqeri Sahatçiu ka falënderuar Komunën dhe Komisionin Evropian për angazhimin dhe mbështetjen e madhe që u është bërë zejtarëve në këtë fazë, duke u zotuar se zejtarët do të punojnë edhe më tepër në ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre zanateve me vlera të larta. Kurse, në emër të kompanisë konsulente MDA (management and development associates), drejtori Rinor Gjonbalaj, ka thënë se puna që kanë bërë me këta zejtarë do të jetë e paharruar. “Kemi punuar me këtë grup të zejtarëve të Gjilanit që janë të shkëlqyeshëm. Janë grupi më special që nga paslufta që kemi punuar me njerëz të cilët janë të përkushtuar kaq shumë në punën e tyre. Ky është grup që bënë ruajtjen e vlerave kulturore dhe krijimin e vendeve të reja të punës”, ka thënë Gjonbalaj.



Haziri: Gjilani ka një të kaluar të lashtë dhe krenare

23
TETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në debatin e organizuar të premten nga klubi i gazetarëve “Beqir Musliu” me temën “Rinia dhe kujdesi ndaj trashëgimisë kulturore në Anamoravë”, ka deklaruar se Gjilani dhe Anamorava janë regjione të pasura me vlera të trashëgimisë. “Gjilani duhet të ndihet krenar sepse ka vlera të pashtershme në fushën e trashëgimisë, e cila garanton vlerat njerëzore dhe realisht për këto vlera duhet të kujdesemi të gjithë dhe jo vetëm institucionet. Dua ta theksoj faktin se roli i të rinjve në këtë aspekt është shumë i madh”, tha Haziri. I pari i Gjilanit e ka vlerësuar hap shumë domethënës inkuadrimin e Kosovës në UNESCO. Haziri tha se Gjilani ka pika frekuentuese në këtë segment duke nisur nga Kalaja e Pogradit, Kalaja e Artanës dhe janë monumentet e objektet tjera që rinia duhet t’i njoh dhe t’i vizitojë. “Ne e kemi Sahat Kullën si pjesë të memories së Gjilanit dhe tani e kemi listën e objekteve të ruajtura apo mbrojtura që janë edhe pjesë e UNESCO-s, por që me kohë ato do të verifikohen dhe identifikohen. Edhe muzeu i qytetit është fytyra e Gjilanit, pastaj atik xhamia, Tuma e Llashticës e shumë vende tjera të rëndësishme”, është shprehur kryetari i Gjilanit. Haziri ka kërkuar nga të rinjtë që të punojnë për ta njohur më mirë dhe më shumë qytetin e Gjilanit, ndërkaq ka dhënë zotimin se sikur deri tash që e ka mbështetur botimin historike, Komuna do të vazhdojë të mbështesë të gjithë ata që shkruajnë libra, që publikojnë fotografi dhe materiale të tjera që zbardhin trashëgimisë pasur historike e kulturore të Gjilanit. “Punoni për të ardhmen e Gjilanit dhe punoni për të ndriçuar të kaluarën e lashtë e krenare të Gjilanit. Unë do ju mbështes në këtë fushë qoftë me punime, projekte, dokumentar e zhvillime tjera që lidhen me trashëgiminë”, tha ai. Në këtë debat kanë pasur diskutime edhe Rexhep Kadriu, nënkryetar i Komunës, pastaj Xhevat Bajrami, Bujar Haziri, Artan Hoxha, Nazmi Muji etj.



Sigurohet mbështetje për kategoritë që kanë nevoja të veçanta për trajtim

23
TETOR

Komuna e Gjilanit ka nënshkruar të premten një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe “Caritas-in” gjerman për mbështetje në realizimin e një programi të punës për kujdesin primar shëndetësor. Aktin e nënshkrimit e ka bërë kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, ministri i Shëndetësisë, Imet Rrahmani dhe përfaqësuesi i “Caritas-it” në Kosovë, Don Viktor Sopi. “Është një program shumë i rëndësishëm për komunën e Gjilanit. E falënderoj ministrin Rrahmani dhe Don Viktorin për mbështetjen që i japin Komunës në realizimin e një programi të punës për kujdesin primar shëndetësor, duke zgjeruar bazën e kujdesit për kategoritë e rrezikuara, kategoritë e vetmuara dhe kategoritë e veçanta në vendbanime të territorit të komunës sonë. Në këtë projekt përfshihen vendbanime të larta, përkatësisht kodrinore-malore”, ka deklaruar pas nënshkrimit të marrëveshjes kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri. Nga ana e tij, ministri i Shëndetësisë, Imet Rrahmani, tha se ky është një hap i mirë mes Ministrisë së Shëndetësisë, Komunës së Gjilanit dhe “Caritasit” gjerman në Kosovë, me synim ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për grupet që kanë nevoja të veçanta

për trajtim. “Qëllimi është që të forcojmë kujdesin parësor shëndetësor, për mbështetjen sidomos në projekte të cilat kanë synim ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për grupet që kanë nevoja të veçanta për trajtim. Ne i dimë vështirësitë e komunave, por me këtë bashkëpunim që kemi filluar sot, ne do të mundohemi që të krijojmë kapacitete të reja që këto shërbime të mbërrijnë atje ku ka më së shumti nevojë, tek ta që nuk kanë mundësi të shpeshta t’i frekuentojnë institucionet shëndetësore”, ka thënë ministri Rrahmani. Don Viktor Sopi, përfaqësues i “Caritas-it” gjerman në Kosovë, ka falënderuar kryetarin Haziri dhe ministrin Rrahmani për gatishmërinë që të mbështeten njerëzit që kalojnë një jetë të vështirë e të vetmuar. “Duke falënderuar kryetarin Haziri dhe ministrin Rrahmani që falë “Caritasit” gjerman, i cili mbështet këtë projekt për kujdesin primar apo shtëpiak për njerëzit që kalojnë një jetë të vështirë e të vetmuar, ne në selinë tonë në Bruksel kemi objektivin parësor njeriun, edhe atë në të gjitha vendet ku vepron “Caritas-i” si organizatë humanitare. Sot ndihem mirë që do të mendojmë më me përkushtim dhe përgjegjësi për personat e vetmuar në komunë dhe rrethinë”, ka thënë Don Viktor Sopi.



“Help” ndihmon 40 biznese

26
TETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nënshkruar sot një marrëveshje bashkëpunimi me organizatën gjermane “Help”, në kuadër të projektit “Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të sektorit të mikrobiznesit në Kosovë”, i financuar nga qeveria gjermane. Në këtë projekt, që ka vlerën 121 mijë euro, Komuna e Gjilanit participon me 16 mijë euro. Kryetari Haziri, me të nënshkruar këtë marrëveshje, ka falënderuar organizatën “Help” dhe qeverinë gjermane për mbështetjen në zhvillimin e ndërmarrësisë dhe ndërmarrjeve të vogla, që përket me rritje të punësimit dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Haziri tha se ndjehet shumë i lumtur që është arritur kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga e cila do të përfitojnë 40 biznese gjilanasë. Shqipe Breznica, koordinatore e projektit, është shprehur se do të mbështeten 40 biznese në synimet për të filluar zhvillimin e tyre, që përfshihen donacione të pajisjeve në vlerë prej 2000 euro, pastaj organizim i biznesit dhe trajnimet profesionale sipas nevojave të klientit, sikurse edhe do të bëhet monitorimi i bizneseve të mbështetura. “Bizneset e reja, bizneset e vogla ekzistuese që kanë nevojë për ndihmë shtesë, gra të papuna, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, grupeve të komuniteteve dhe kategoritë me më pak mundësi të punësimit do t’u jepet konsideratë e veçantë në realizueshmërinë e ideve të sugjeruara të biznesit”, tha Breznica. Vlera e përgjithshme e këtij projekti është 121 mijë euro, ndërkaq Komuna e Gjilanit merr pjesë me 16 mijë euro.



Interesim i jashtëzakonshëm i rinisë për tolerancën fetare

27
TETOR

Numër rekord i të rinjve të Gjilanit i janë përgjigjur ftesës së kryetarit Lutfi Haziri, në tryezën “Rinia dhe Toleranca Ndërfetare”, e cila është mbajtur në kuadër të Muajit të tolerancës dhe solidaritetit. Gjilani vlerësohet një shembull i mirë i tolerancës ndërfetare dhe ndëretnike. “Muaji...” vazhdon me një debat për rolin e gruas në tolerancën ndërfetare. Interesimeve e pyetjeve të shumta të të rinjve në këtë tryezë i janë përgjigjur kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, kryetari i Bashkësisë Islame në Gjilan, Sylejman Osmani, përfaqësuesi i Kishës Katolike, Dom Dominik Qerimi, përfaqësuesi i Kishës Protestante, Naim Bllaca, sikurse edhe përfaqësuesi i Kishës Ortodokse, Dragan Kojiç, ndërkaq pjesëmarrës kanë qenë edhe përfaqësues nga Policia e Kosovës dhe KFOR-i turk. Kryetari Haziri tha se kjo tryezë e organizuar, vije pas takimeve të shumta të nisura para gati dy vitesh me inicim të tij, në funksion të kultivimit të tolerancës dhe dialogut ndërfetar. “Ky takim me përfaqësues të të gjitha feve në Gjilan, dëshmon se sa tolerant jemi në këtë fushë për çka jam krenar, sikurse që më gëzon faktin se ka dy vite që në komunën tonë nuk ka ndodhur asnjë lloj krimi. Pra qytetarët tanë janë të sigurt për të jetuar dhe vepruar. E falënderoj rininë gjilanase, që në numër kaq të madh iu ka bashkangjitur ftesës sonë për këtë tryezë të rëndësishme”, tha Haziri. Ai paralajmëroi

se më 1 nëntor Komuna e Gjilanit do të fillojë pastrimin e varrezave myslimane dhe katolike, sikurse që tha se do të bëhet edhe konservimi i këtyre varrezave, pasi Komuna do të bëjë vend për varrezat e reja të qytetit si për komunitetin mysliman, ashtu edhe për atë katolik dhe protestant. Kryetari i Bashkësisë Islame në Gjilan, Sylejman Osmani, tha se iniciativës së kryetarit Haziri për t’i mbledhur të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve fetare u janë bashkangjitur me kënaqësi, duke shtuar se forma e organizimit të këtyre takimeve është model i mirë për të gjithë. Dom Dominik Qerimi, përfaqësues i Kishës Katolike, tha se për dallim që më herët këso takime organizonte KFOR, OSBE etj., tash është e rëndësishme që po i bashkon Komuna e Gjilanit, duke bërë thirrje që Muaji i Tolerancës dhe Solidaritetit të bëhet tradicional sikurse “Flaka e Janarit”. Ndërkaq, Dragan Kojiç, përfaqësues i Kishës Ortodokse është shprehur se takimet e tilla tregojnë se Gjilani është në rrugë të mirë, duke bërë thirrje tek të zhvendosurit që të kthehen në shtëpitë e tyre, sepse siç tha, këtu ka jetë, bashkëpunim dhe harmoni me njëritjetrin. Përfaqësuesi i Kishës Protestante në Gjilan, Naim Bllaca, tha se këto debate e organizime në funksion të tolerancës po bëhen falë nismës së kryetarit Haziri, për të shtuar se Gjilani është Komuna e parë në nivel vendi që po merr iniciativa të tilla.



Edhe gratë kanë kontribuar në tolerancën fetare

28
TETOR

Në kuadër të Muajit të tolerancës dhe solidaritetit që po organizohet në tetor, me iniciativë të kryetarit Lutfi Haziri, në Gjilan është mbajtur sot një tryezë me temën “Ndikimi i gruas në tolerancën fetare”, i realizuar në bashkëpunim me organizatën “UN Women”. Valentina Bunjaku Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, ka thënë se gruaja ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në sferën e tolerancës fetare. Në takim ka marrë pjesë kryesuesja Valentina Bunjaku Rexhepi, krerët e bashkësive fetare në Gjilan, përfaqësues të policisë lokale dhe regjionale, sikurse edhe përfaqësues të organizatave të ndryshme të grave. Në emër të kryetarit Haziri, ka folur kryesuesja Valentina Bunjaku Rexhepi, e cila vlerësoi se gruaja ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në aspektin e tolerancës fetare. Poashtu, Bunjaku-Rexhepi tha se vetë fakti që qytetarët i kanë besuar asaj pozitën e kryesueses, tregon për tolerancën dhe avancimin e gruas në Gjilan. Sylejman Osmani, kryetar i Bashkësisë Islame në Gjilan, theksoi rëndësinë

që gruaja në Gjilan ka pasur në avancimin e tolerancës, duke shtuar se në ligjëratat e tyre ka vëmendje të duhur trajtimi i gruas. Ai tha se debatet e tilla i japin mundësi që t’i promovojnë vlerat e mira të fesë, tolerancës dhe bashkëjetesës mes të gjitha komuniteteve. Përfaqësuesi i Kishës Katolike, Dom Dominik Qerimi, ka pohuar se tryezat e tilla shërbejnë që të afroheni me njëri-tjetrin, ndërkaq përfaqësuesi i Kishës Protestante, Naim Bllaca është shprehur se përmes këtyre takimeve kanë parë se sa shumë gjëra kanë nevojë t’i diskutojnë mes vete. Komandanti i Policisë lokale në Gjilan, Remzi Azemi, ka thënë se toleranca fetare në Gjilan ka nevojë që të shtrihet në të gjitha sferat e jetës dhe këtu kontribut shumë të rëndësishëm mund të japin krerët e bashkësive fetare. Ndryshe, kryetari Haziri ka paralajmëruar se më 1 nëntor Komuna e Gjilanit do të fillojë pastrimin e varrezave myslimane dhe katolike, sikurse që do të bëhet edhe konservimi i këtyre varrezave, pasi Komuna do të sigurojë një lokacion tjetër.



Ministria e Infrastrukturës prezantoi projektin e autostradës Prishtinë-Gjilan

28
TETOR

Zyrtarë të Ministrisë së Infrastrukturës kanë prezantuar sot në Gjilan projektin ideor të autostradës Prishtinë-Gjilan-Konçul. Në prezantimin e këtij projekti tejet të rëndësishëm ka marrë pjesë kryetari Lutfi Haziri së bashku me bashkëpunëtorët e tij, i cili ka falënderuar me këtë rast zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës për prezantimin e projektit nacional, i cili, e lidhë Gjilanin me korridorin e kombit dhe korridoret ndërkombëtare. Haziri tha se ky është një projekt gjigant që pritet

të sjell përfitime të mëdha për qytetarët e Gjilanit dhe do të ndikoj në zhvillim të hovshëm ekonomik, duke shtuar se me këtë projekt do të zhvillohet edhe Malësia e Zhegocit, Bresalci, Përlepnica etj., meqë sipas projektit ideor, autostrada kalon përmes Bresalcit tek “Bunari i Përlepnicës”, për të vazhduar drejt ‘Crepit’ në Kamenicë e deri tek fshati Konçul i Kosovës Lindore. “Gjilani më nuk është qytet i harruar dhe i anashkaluar sepse e kemi kthyer kujdesin e Prishtinës në investime”, ka thënë Haziri.



Nis projekti “Gjilani Riciklon”

29
TETOR

Komuna e Gjilanit, në bashkëpunim me Organizatën Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), ka filluar sot zyrtarisht realizmin e projektit “Gjilani Riciklon”, i cili është mbajtur në shkollën fillore “Selami Hallaqi”. Fillimisht “Klubi i Gjelbër” i nxënësve të kësaj shkolle ka demonstruar ndarjen e mbeturinave, sikurse edhe zëvendësimin e qeseve me çanta, të cilat nxënësit i kanë punuar aty për aty me rroba të trupit. Hapjen zyrtare të këtij projekti e ka bërë kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, i cili ka thënë se me fillimin e projektit, Gjilani hynë në qytetet e para që të jetë qyteti pastër dhe i gjelbër. “Programi i nisur në këtë shkollë për ndarjen e mbeturinave do të vazhdohet të zbatohet në tërë territorin e Komunës së Gjilanit, në mënyrë që institucionet dhe objektet ku mund të fillojnë ta aplikojnë programin, të jetë i pranueshëm dhe të jetë pjesë e kulturës sonë”, tha

Haziri. “Synim yni është që ta kthejmë jo vetëm ambientin dhe oborret shkollave dhe institucioneve tona publike në ambiente të gjelbra e të pastra, por këtë kulturë ta bartim në lagjet tona e në qytet dhe Gjilani hynë në qytetet e para që të jetë qyteti pastër dhe i gjelbër”. Ai tha se Gjilani është shpallur nga GIZ-i gjerman qyteti me hapësirë të gjelbër më të madhe në territorin e Kosovës, ndërkaq ka shtuar se do të vazhdohet me logjikën e ndërtimit, zgjerimin dhe kujdesin e hapësirave të gjelbra. Driton Vatovci përfaqësues i organizatës GIZ, tha se është kënaqësi të punohet me Komunën e Gjilanit, duke përgëzuar për nisjen e këtij projekti, i cili shërben për brezat e rinj se si të ndahen dhe riciklohen mbeturinat për një mjedis më të pastër. Përveç Komunës së Gjilanit dhe GIZ-it, në implementim të këtij projekti është e përfshirë edhe “Ecohigjiena”, OJQ “Green Art Center” si dhe kompania private “Riciklimi”.

Tryezë: Komunikimi ndërinstitucional

29
TETOR

Zyra Rajonale e OSBE-së në Gjilan, në bashkëpunim me Komunën e Gjilanit kanë organizuar sot një tryezë me zyrtarë të ekzekutivit dhe vendimmarrjes në procesin e krijimit të legjislacionit dhe politikave, me temën “Rritja e performancës së komunikimit brenda institucional”. Kristina Jovanovska nga Zyra Rajonale e OSBE-së në Gjilan, ka thënë se ky takim do të shërbejë si forum për identifikimin e sfidave, por edhe për të formuluar rekomandime adekuate për vitin e ardhshëm. Nënkryetari Rexhep Kadriu e falënderoi OSBE-në për organizimin e sotëm, duke shfaqur zotimin se të gjitha ato që diskutohen në këtë tryezë do të merren si rekomandime, duke shtuar se do të shërbejnë që ekzekutivi dhe legjislativi të kenë një performancë



sa më të mirë karshi qytetarëve. Ndërkaq, kryesuesja e Kuvendit Komunal të Gjilanit, Valentina Bunjaku Rexhepi, ka thënë se do të merren parasysh nga Kuvendi Komunal të gjitha rekomandimet nga tryeza e sotme, duke i bërë thirrje për bashkëpunim në këtë aspekt pozitiv e opozitës. “Do të mundohemi t’i përmirësojmë lëshimet, nëse kemi, me dëshirë që puna e Kuvendit të shkojë sa më mirë. Unë jam shumë e kënaqur me punën e trupave mbështetëse të Kuvendit pasi të gjitha kërkesat e qytetarëve i kanë shtjelluar dhe i kanë dorëzuar në Komitetin për Politikë dhe Financa”, ka thënë Bunjaku-Rexhepi. Në këtë tryezë kontributin e tyre e kanë dhënë edhe Sadri Arifi, shef i Sekretarisë së Kuvendit dhe Hevzi Matoshi, shefi i Zyrës Ligjore.



Kuvendarët e Gjilanit, me vlerësime kontradiktore për gjendjen në arsim

30
TETOR

Kuvendi Komunal i Gjilanit, të premtën, në mbledhjen radhës për këtë vit, të cilën e ka drejtuar Valentina Bunjaku Rexhepi, e ka ndryshuar rendin e ditës për të diskutuar për arsimin, me çka ka treguar mirëkuptim ndaj kërkesës së opozitës, por nuk janë dakorduar aspak për gjendjen në këtë sektor. Kuvendi vendosi të mos diskutojë për raportin e kryetarit, për periudhën janar-shator 2015, meqë nuk është obligues për 9-mujor dhe për arsye se kryetari ndodhej në një agjendë tjetër, që kishte të bënte me nënshkrimin e marrëveshjes për vazhdimin e projektit të bibliotekës regjionale në Gjilan. Valentina Bunjaku-Rexhepi e ka vlerësuar këtë një lajm të mirë për Gjilanin, sepse po vazhdon një projekt i lënë në gjysmë prej kohës së qeverisjes së kaluar. Bujar Nevzati, në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së, ka thënë se gjendja në arsim është e rëndë dhe sipas tij, ky sektor është politizuar skajshëm. Nevzati tha se nuk janë zbatuar kriteret për regjistrim të nxënësve, nuk është shpallur konkurs për të gjitha vendet e lira, pastaj pati vërejtje për ekskursionet si dhe çështje të

tjera në arsim, ndërkohë që sa i përket një videoje që ka të bëjë me drejtorin e arsimit, për kohën kur ai ka qenë mësimdhënës, ku shihet duke e nxjerrë një nxënës nga klasa në mënyrë të dhunshme, ka kërkuar dorëheqjen e tij. Te akuzat e opozitës për ekskursionet, ku përmendet edhe emri i kryesues së Kuvendit Komunal, Valentina Bunjaku-Rexhepi ka reaguar duke thënë se ajo e ka dërguar rastin në prokurori dhe e pret ditën që të përballlet me ata që kanë shpifur për të pa asnjë fakt të vetëm. Arben Mehmeti, shef i grupit të këshilltarëve të LDK-së, ka thënë se situata në arsim është e zakonshme dhe tendenca e opozitës për të mbajtur seancë të jashtëzakonshme, kishte prapavijë politike. Ai ka nënvizuar faktin se të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me arsimin e që kanë qenë interes i opozitës, janë diskutuar në Komitetin e Arsimit dhe asnjëherë nuk ka pasur vërejtje prej tyre. Për më tepër, ai tha se zërat nga opozita për gjendjen e keqe në arsim, janë një alarm i rrejtshëm, sepse arsimi është shumë më mirë se sa ka qenë në kohën e PDK-së, e cila e ka politizuar arsimin dhe ka përdorë fshesën kundër

kuadrove të LDK-së. Kurse Nevzad Isufi, shef i grupit të këshilltarëve të VV-së, tha se vend për punë dhe për përmirësime në arsim, ka gjithmonë dhe gjithandej Kosovës, duke shtuar se edhe në Gjilan, ka parregullsi, siç janë punësimet pa konkurs, regjistrimi i nxënësve, anulimi i bursave për studentë, ekskursionet dhe të tjera. Këtyre shqetësimeve u ka dhënë përgjigje Nazmi Musa, drejtor i Arsimit. Vërejtjet e opozitës për gjendjen në arsim, ai i cilësoi si zhurmë të panevojshme, kurse videon e ka quajtur një shantazh ndaj tij. Pasi i ka numëruar radhazi punët dhe projektet e realizuara gjatë këtij viti dhe më herët, Musa ka thënë se gati në të gjitha shkollat e Gjilanit, drejtorët dhe z/drejtorët kanë qenë të PDK-së në kohën kur ai ka ardhur në krye të DKA-së, ndërkohë që tani ka edhe drejtorë edhe të subjekteve tjera. Ai është shprehur kategorik se drejtorët dhe as zyrtarët e lartë të arsimit nuk do të ndërrohen për arsye politike, por ata mund të largohen nëse bëjnë shkelje ligjore, siç ka ndodhur në shkollën e Bujqësisë, ka thënë ai. Sa u përket punësimeve, ai tha se nuk është në krye të arsimit për të plotësuar dëshira, por për të zbatuar ligin, derisa ka shtuar se sistemimi i mësimdhënësve që kishin ngelur tepriçë teknologjike, është bërë sipas rekomandimeve të MASHT-it dhe brenda mundësive ekzistuese. Ndërkaq për ekskursionet e nxënësve, ai ka thënë se janë të parapara me ligj dhe ai nuk mund t'i ndalojë. Musa mohoi që në Mjekësi të jenë hapur paralele të reja, për t'i regjistruar nxënësit që kanë mbetur jashtë dhe nuk duan të shkojnë në shkolla tjera. Kurse sa i përket një videoje, ku ai shihet duke e nxjerrë jashtë klase një nxënëse, që ka ndodhur para 4-5 vitesh, Musa kërkoi falje për sjellje jo pedagogjike dhe sqaroi se ajo është publikuar nga mësimdhënësi Xhelal Bislimi, si formë presioni e shantazhi ndaj tij, për faktin se ka dërguar në komision disiplinor, meqë ka munguar një muaj në punë pa arsye. Musa tha se ky person ka tentuar ta korruptojë e shantazhojë disa herë, por meqë nuk ka mundur, atëherë e ka përdorë edhe këtë formë. Kërkesave të opozitës për dorëheqje, Musa iu është përgjigjur duke thënë se nuk do ta bëjë këtë për diçka që ka ndodhur para 4-5 vitesh dhe që nuk ka pasur asnjë reagim asokohe, ndërkohë që i ka rikujtuar ata se në Kosovë ka njerëz që janë në burg dhe mbajnë pozitën e kryetarit të Komunës. Fehmi Sylejmani (VV) tha se drejtorit të Arsimit nuk mund t'i kërkohet përgjegjësi për një rast që ka ndodhur kur ai nuk ka qenë në këtë pozitë, por atij do t'i kërkohet përgjegjësi për kohën sa udhëheq arsimin dhe ku nuk ka menaxhuar mirë. Kuvendarët, po ashtu kanë miratuar edhe raportin financiar janar-shtator 2015, që e ka prezantuar drejtori i Buxhetit, Zijadin Maliqi, i cili ka thënë se të hyrat e kësaj periudhe janë për 1.4 për qind më të mëdha se ato të periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, kurse në krahasim me planin vjetor, ato janë realizuar deri më tani për rreth 70 për

qind. Arkëtimi i të hyrave nga tatimi në pronë, që ka ngecur për shkak të faljes së borxheve dhe pagesat e gjobave, që vijnë prej gjykatave, do ta përmirësojë dukshëm këtë parametër deri në fund të vitit. Sa u përket shpenzimeve, Maliqi thotë se ka një ulje të dukshme, në të gjitha kategoritë ku reduktimet kanë qenë të mundshme. Shpenzimet e kësaj periudhe janë për 34 për qind më të ulëta se planifikimi. Kurse investimet kapitale janë në proces e sipër dhe plani pritët të realizohet qind për qind, thotë Maliqi. Përndryshe buxheti i planifikuar për vitin 2015, është afër 22 milionë euro. Për shpenzime kapitale janë planifikuar rreth 3.6 milionë euro. Të hyrat vetanake janë mbi 3.8 milionë euro. Nga shefi i grupit të këshilltarëve të LDK-së, Avdyli Aliu, raporti është vlerësuar një paraqitje reale e punës së ekzekutivit në aspektin financiar, kurse Riad Rashiti, në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së tha se te disa kategori, të hyrat janë të kënaqshme, te disa ka ngecje, kurse shpenzimet, sipas nesh, janë të njëjta me vitin e kaluar. Ai ka ngritur dyshime sa u përket investimeve të raportuara në konferencë bujqësi, duke thënë se në raport nuk figurojnë. Për këtë ka dhënë sqarime drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, duke thënë se në raport nuk janë pasqyruar grantet e qeverisë dhe donatorëve, me të cilat investimet në këtë sektor arrijnë në 2.5 milionë euro. Krenare Latifi (VV) tha se te disa kategori e të hyrave vetanake ka një ngritje të lehtë, por te investimet kapitale ka rënie. Zijadin Maliqi ka thënë se në raporte periodike nuk mund të dihet saktësisht se sa janë përmbyshur objektivat, por kjo do të shihet qartë në raportin përfundimtar. Sa u përket borxheve, ai ka thënë se qytetarët nuk po kërcënohen, siç po thuhet nga opozita, por ata po luten që t'i kryejnë obligime e tyre. “Shpenzimet e përgjithshme janë më të vogla se vitin e kaluar, kurse shpenzimet për dreka zyrtare nuk kanë qenë asnjëherë më të vogla se tani. Investimet do të shihen në fund të vitit, sepse një numër i mirë i projekteve janë në proces e sipër”, ka thënë Maliqi. Kuvendi miratoi edhe vendimin për këmbimin e një pjesë të pronës komunale me pronë private, për nevoja të rrugës publike në lagjen “Zabeli...”, të cilin e arsyetuan Nevzad Rushiti, kryetar i Komitetit të Pronës si dhe drejtori i Kadastrës, Sadudin Berisha. Kuvendi miratoi edhe statutin e QKMF-së, si rekomandim nga Komiteti për Politikë dhe Financa, ku ky akt normativ ishte diskutuar dhe shqyrtuar paraprakisht, në një seancë të veçantë, por këshilltarët e PDK-së e kanë lëshuar sallën në këtë pikë, për shkak të ndryshimit të renditjes së pikave. Me vërejtje dhe pas një diskutimi të gjerë u miratua edhe raporti për gjendjen në ndërmarrjen publike “Ecohigjiena”, të cilin e ka prezantuar kryetari i Komisionit të aksionarëve, Xhelal Jestishi. Përndryshe, këtë seancë, Kuvendi Komunal e ka mbajtur në sallën e re, e cila është përrurua sot.



Haziri: “Darka e Lamës” është falënderim ndaj Zotit dhe ndaj bujqve

30
TETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka hapur zyrtarisht festën tradicionale të falënderimeve “Darka e Lamës”, ku pati pjesëmarrje të jashtëzakonshme të qytetarëve të Gjilanit. “Darka e Lamës” është falënderim ndaj Zotit për begatinë që na ka dhënë, falënderim për bujqit, familjet tona dhe të gjithë ata që kanë punuar ditë e natë që ky bereqet të jetë në sofrën e qytetit të Gjilanit. “Këto të mira, që prej ujit, mjaltit e deri te buka, pemët, perimet dhe industrinë e ushqimit në Gjilan, janë marka dhe brendi më i mirë që kanë gjilanasit dhe tregojnë qartë se ne duhet t’i konsumojmë këto prodhime. Sofrën tonë duhet ta mbajmë me prodhimet tona”, ka thënë Haziri. Ai ka falënderuar të gjitha familjet bujqësore dhe kompanitë që kanë pasur sukses sivjet me prodhimet e tyre, falë mbështetjes komunale. “I falënderoj të gjithë, në veçanti kompanitë të cilët po bë-

jnë shumë që t’i blejnë, t’i marrin të gjitha prodhimet, t’i ruajnë dhe t’i shesin si: “Calabria”, “Ask Food”, “Moea”, “Consoni”, “Kabi”, “Fluidi”, “Dea”, mishoret: “Luli”, “Malësia” e “Gazi” si dhe të gjitha të tjerat që në Gjilan janë brendi i shqiptarëve. Zoti e bekoftë këtë sofrë”, ka shtuar kryetari Haziri. Drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, ka falënderuar të gjithë fermerët për të mirat që i kanë sjellë kësaj tryezë. “Ky vit ishte mjaft i bereqetshëm”, ka thënë Ramadani, duke përmendur edhe rendimentet: grurë - mbi 11 mijë tonë, misër - 9 mijë tonë, mish - 410 tonë, qumësht - afro 17 mijë tonë, mollë - 4000 mijë tonë, kumbull - 39 tonë, mjaltë - 48 tonë, domate - 1800 tonë, specia - 750 tonë, patate - 2000 tonë etj”. Përndryshe, bujqit e Gjilanit, gjatë vitit 2015, janë mbështetur me afro 2.5 milionë euro. Ramadani tha se mbështetja do të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm.

Konferencat për media të drejtorëve



Musa: Gjilani krenohet me arsimin dhe rezultatet në arsim

21
TETOR

Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Nazmi Musa, ka mbajtur sot konferencë të rregullt për media, në të cilën ka prezantuar punën 9-mujore të dikasterit më të madh në nivelin lokal të qeverisjes. Ai u shpreh i kënaqur me punën e bërë në këtë periudhë dhe përgjithësisht në këto dy vite. “Puna që është bërë për këto dy vjet, është pakrahasueshëm më e mirë se në vitet paraprake dhe qeverisjet e mëparshme, sikur që ka edhe shumë për t’u bërë drejt modernizimit dhe ngritjes së mëtutjeshme të cilësisë në arsim”, ka thënë drejtori. Më tej Musa ka folur edhe për suksesin e nxënësve në testin e maturës dhe arritshmerisë, që dëshmojnë për sukses shumë të mirë të nxënësve tanë në nivel vendi. “Testi i maturës këtë vit, ka shkuar shumë mirë dhe rezultatet janë mjaft të mira, kur bëhen krahasime në nivel vendi. Këto rezultate shihen edhe në raporte të ndryshme dhe në gara

shtetërore e ndërkombëtare, ku nxënësit e Gjilanit kanë zënë vendet e para, dyta e treta. Përgatitjet janë përherë në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë, në mënyrë që të kemi kualitet edhe më të madh në shkollat tona”, tha drejtori Nazmi Musa. Drejtori Musa, gjithashtu tha se në këtë periudhë është bërë regjistrimi i nxënësve në klasat e para dhe të dhjeta, sipas normativit nga Ministria e Arsimit. “Kemi nxënës më pak të regjistruar në klasën e parë, që kur krahasohet me vitin paraprak, diferenca është mbi 100 nxënës. Ndërsa, në klasat e dhjeta, nuk ka më klasa me më shumë se 32 – 35 nxënës, që për dallim prej viteve të tjera, kjo shifër në shumë klasa kalonte numrin 40 – 45 nxënës. Këtë vit kemi rritje të numrit të nxënësve në shkollën e Agrobiznesit, për shkak të stimulimit me bursa”, tha Musa. Ai ka thënë se është kryer edhe emërtimi i disa shkollave, që për vite tëra kishin mbetur pa emra.

Ramadani: Për nëntë muaj, mbi 2.5 milionë euro kemi investuar në bujqësi

22
TETOR

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari, Ramiz Ramadani, në një konferencë për media, të mbajtur sot, ka prezantuar investimet që janë bërë në vitin 2015. Ramadani ka thënë se rreth 3.500 fermerë kanë përfituar subvencione e grante, në vlerë mbi 2.5 milionë euro. Kurse, në këshilla profesionale dhe trajnime janë përfshirë 900 fermerë. Subvencionet e Ministrisë së Bujqësisë, në vlerë 1.7 milion euro, ku ka përfituar një numër i konsiderueshëm i fermerëve, kanë ndikuar në rritjen e sipërfaqeve me drithëra dhe shtimin e fondit të



bagëtisë. Bashkëpunimi ka qenë i mirë edhe me donatorët dhe vlera e përgjithshme e investimeve nga kjo kategori kap shumën mbi 90 mijë euro. “Nga donatorët në Gjilan kemi përfitues të 17 fermerë, të cilët kanë përfituar serra prej 500 metra katrorë, me sistem të ujitjes dhe foli të zezë, për kultivimin e sallatës, pastaj kultivues për bimë mjekësore dhe aromatike, me sipërfaqe prej 0.30 – 0.70, ha, por edhe dy përfitues të tharësve për bimë mjekësore, aromatike, kërpudhave dhe frutave të pa kultivuara më parë”, tha Ramadani. Po ashtu në bashkëpunim me “Tika”

turke është realizuar projekti për furnizimin e 155 bletarëve me pajisje të ndryshme për bletarinë, sikurse edhe 40 lavërtarë, të cilët kanë përfituar shpërndarës plehu. Vlera e projektit ishte 25 mijë euro. Ndërsa nga buxheti i Komunës së Gjilanit, është bërë shpërndarja e 15 atomizerëve për spërkatjen e pemëve, në vlerë prej mbi 16 mijë euro. Me farë të misri janë mbështetur 583 fermerë, në vlerë prej 33 mijë euro. Në rregullimin me zhavorr të rrugëve bujqësore janë investuar 105 mijë euro. “Jemi duke vazhduar me punime edhe në fshatrat Gumnishtë, Kravaricë dhe Livoç i Epërm”, ka thënë ai. Në tremujorin

e fundit, janë shpërndarë llaktofrizë me kapacitet 350 litra për dhjetë fermerë, projekt i cili është realizuar në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me qumështoren “Kabi” dhe vlera e tij është 20 mijë euro. “Jemi në pritje të nënshkrimit të kontratës, ngase tashmë janë zhvilluar të gjitha procedurat e prokurimit. Vlera e këtij projekti është 50 mijë euro. Ndërsa, numri i aplikuesve për furnizim me farë gruri është 857. Sa i përket mekanizmit bujqësor, përfitues janë 30 fermerë me spërkatëse për kultura lavërtare, 10 rotofreza, 10 kositëse rrotulluese dhe 10 grumbulluese të barit, që në vlerë financiare është mbi 52 mijë euro.

Gagica: Për 20 muaj qeverisje, u arritën objektivat katër vjeçare të administratës

27
TETOR

Nazim Gagica, drejtori i Administratës së Përgjithshme, ka thënë se 9-mujori i këtij viti karakterizohet me rritje të cilësisë së shërbimeve, modernizim të administratës përmes projekteve të ndryshme, siç janë “tele – work”, “e-kiosqet” si dhe shërbimet “on-line”. Drejtori i Administratës, ka pohuar se ka rritje të efikasitetit në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve dhe deri më tani kemi 96 % në dhënie të përgjigjeve dhe mbylljen e lëndëve deri në këtë periudhë. Ai theksoi se edhe sa i përket shfrytëzimit të veturave zyrtare, ka përmirësime të dukshme në këtë sektor dhe ulje të shpenzimeve përditë e më shumë dhe rritje të shërbimeve në të njëjtën kohë. “Në sektorin e autoparkut krahasimi i periudhës së njëjtë të këtij viti me vitin paraprak, pra me vetveten është për 5



mijë litra derivate më pak të harxhuara, por krahasuar me vitin 2013 është 15 mijë litra më pak, që dëshmon kujdesin dhe përkushtimin që kemi në ruajtjen e parasë publike dhe uljen e shpenzimeve të luksit”, ka thënë drejtori i Administratës së Përgjithshme, Nazim Gagica. Siç ka potencuar ai, për vetëm 20 muaj të qeverisjes, është arritur që të realizohen objektivat e parapara të kësaj Drejtorie. “Kjo është arritur falë angazhimit të stafit dhe mbështetjes së fuqishme të kryetarit Lutfi Haziri, tash do të vazhdojmë tutje, modernizimin e arkivit dhe hapësirën shtesë për arkivin e të gjitha dokumenteve të drejtorive komunale”, tha ai. Drejtori i Administratës ka informuar se gjatë kësaj jave do të bëhet edhe hapja e sallës së re të Kuvendit të Komunës, e cila është adekuate për mbledhje të Kuvendit.



Berisha: Mbi 18 mijë lëndë janë shqyrtuar nga drejtoria e Kadastrës

28
TETOR

Në një konferencë për media, drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë, Sadudin Berisha, ka bërë prezantimin e punës nëntë mujore, duke nënvizuar se gjatë kësaj periudhe janë trajtuar mbi 18 mijë lëndë. Edhe sa i përket përgatitjes së elaboratit për shpronësim, Berisha ka thënë se është bërë një punë e madhe, duke pohuar se për tri zona sipas Planit Rregullues Detal Urbanistik. “Elaboratet për shpronësim janë përgatitur për tri zona, “Fidanishte”, “Monteith” dhe “Livadhet e Arapit”. Kështu në këto tri zona kemi të bëjmë me 1208 parcela kadastrale dhe sipërfaqja shpronësuese vetëm për infrastrukturë rrugore kap shifrën prej mbi 31 ha, pa u llogaritur këtu edhe shpronësimet që do të ndodhin më pas për infrastrukturën përcjellëse”, tha ai. Berisha ka thënë se drejtoria ka bërë përpunimin e shënimeve edhe për rrugën Gjilan – Prishtinë, deri tek rruga qarkore, pastaj korrigjimin e të dhënave kadastrale në objektin e “Soliterit”, sepse me rastin e rikonstruimit, janë konstatuar gabime nga kompania kontraktuese në vitet e mëhershme, duke gjetur shpërputhje të të dhënave kadastrale dhe gjendjes faktike. Ai ka thënë se si drejtori kanë bërë një sërë shënimesh kadastrale. “Kemi bërë shënimin kadastral të palestës së sporteve në fshatin Zhegër, pastaj

të rrugës “Mulliri i Arapit” në Zabel, pastaj sipas planit urbanistik është bërë shënim i rrugës Gjilan – Preshevë deri në fshatin Velekincë, pastaj i rrugës Gjilan – Bujanoc, Gjilan – Prishtinë dhe Gjilan Ferizaj. Në shënimin e këtyre rrugëve është konstatuar se nuk kemi cenim të pronës publike”, ka thënë ai, duke potencuar se aktivitete të tilla kanë vazhduar edhe në shënimin e rrugëve fushore në zonat rurale si në Zhegër, Lladovë, Nasalë, Cërrnicë dhe Përlepnicë, me një gjatësi prej mbi 8 mijë metra gjatësi. Ai gjithashtu ka informuar se deri më tani kanë përfunduar 16 incizime në terren të pronës komunale, për të vazhduar edhe më tutje deri në incizimin e pronave komunale në përgjithësi, si të objekteve komunale, shkollave, ambulancave, fusha sportive, ku janë konstatuar se ka objekte që janë të vendosura në pronat shoqërore që janë të parregulluara në fushën e marrëdhënieve pronësore – juridike dhe do të vazhdohet tutje deri në përfundimin e të gjitha incizimeve. “Kemi mbi 30 pronarë të pronave private të cilët në funksion të hapjes së rrugëve publike i kanë falur pronat e tyre për këtë qëllim, si në Livoç të Epërm, 22 pronarë me sipërfaqe prej 2114 metra katrorë, Lladovë 6 pronarë me sipërfaqe prej 825 metra katror, një në Bresalc me 452 metra katror”, ka thënë ai.

Kqiku: Projektet e parapara për sivjet realizohen deri në fund të vitit

29
TETOR

Drejtori i Departamentit të Prokurimit, Salih Kqiku, në një konferencë për media, ka paraqitur punën nëntë mujore të këtij dikasteri komunal. Ai ka thënë se bazuar në ligjin për prokurim publik, më 9 janar është dorëzuar në AQP planifikimi final i prokurimit publik për vitin 2015. Projektet e parapara për sivjet realizohen deri në fund të vitit, ka thënë Kqi-



ku. Kqiku tha theksoi se raporti final i monitorimit dhe mbikëqyrjes i përpiluar nga ekspertët e Komisionit Rregullativ të prokurimit që i është dorëzuar këtij departamenti në mars, flet për rekomandimet e dhëna që kanë të bëjnë me avancimin e procesin e prokurimit publik në harmoni me ligjet në fuqi. Ndërkaq, nga monitorimi i punës nëntë mujore nga ana e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI)

dhe pas analizave të bëra nga ky monitorim, drejtori Kqiku tha se Komuna e Gjilanit është shpallur më e mira në rregullsinë e proceseve të prokurimit në nivel vendi. “Gjatë kësaj periudhe nëntë-mujore, janë udhëhequr procedurat tenderuese në vlerë prej 3.860.769.99 euro dhe janë nënshkruar kontratat për projektet e financuara nga Ministria e Infrastrukturës. Për asfaltimin e rrugëve në fshatra janë nënshkruar pesë kontrata në vlerë prej 476.025.73 euro dhe tri janë në procedurë. Për projektet

në qytet të financuara nga MI janë nënshkruar kontratat për pesë projekte në vlerë 1.238.766.05 euro”, ka thënë Kqiku. Përveç tjerash, ai ka deklaruar se gjatë kësaj periudhe janë dhënë edhe vërejtje për disa kompani që nuk i kanë kryer punët sipas kontratës, me ç’rast dhe janë shkëputur disa kontrata, duke marrë edhe vendime për dënim të një kompanie me 10 %. Kqiku është shprehur se të gjitha punët në këtë dikaster, si asnjëherë më parë, janë bërë me një transparencë të plotë.



02
NËNTOR

Drejtori për Zhvillim Ekonomik, Agim Zuzaku, ka paraqitur punën nëntëmujore të kësaj drejtorie, duke thënë se këtë periudhë e karakterizon angazhimi maksimal në hartimin e politikave zhvillimore për bizneset private dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës, sikur që edhe bashkëpunimi me donatorë, në projekte të ndryshme zhvillimore për Gjilanin. “Jemi duke punuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve, duke u fokusuar në zhvillimin lokal dhe mbështetjen përmes shërbimeve në ngritjen dhe zhvillimin e biznesit privat”, ka thënë Zuzaku. Ai ka publikuar edhe statistikën e regjistrimit të bizneseve të reja dhe numrit të të punësuarve. “Për këtë periudhë kohore kemi 403 biznese të reja në Gjilan, ku janë punësuar 660 punëtorë të rinj”, ka thënë ai. Kurse në kuadër të investimeve dhe bashkëpunimit me donator, ai ka sqaruar se janë një numër i madh i projekteve dhe programeve që po vazhdojnë për zhvillim të Gjilanit. “Në sektorin e investimeve kapitale kemi rreth 520 mijë euro të investuara në këtë periudhë, sikur që edhe nga donacione të ndryshme që kemi një vlerë prej mbi 85 mijë eurove. Aktiviteti me donatorë është në projekte të ndryshme dhe me donatorë të shumtë. Jemi duke punuar së bashku me USAID-in në projektin për punësim dhe zhvillim ekonomik, pastaj në programin tjetër për përkrahjen e ndërmarrjeve në Kosovë

Zuzaku: Për 9 muaj janë regjistruar 403 biznese të reja

dhe Komunën e Gjilanit, ku është siguruar hapësirë e shkëlqyeshme në panair për kompanitë kosovare”, tha ai. Me UNDP-në dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale jemi në programin e tregut të punës, që financohet nga qeveria e Finlandës. Projekti tjetër është ai për Zhvillimin e Rinisë në Kosovë, që po mundësohet përmes KYDO (Kosovo Youth Development Projekt) dhe financohet nga Banka Botërore. Zuzaku ka informuar edhe për financim të projekteve për ndërmarrësit e rinj në sektorin e turizmit dhe përpunimit të ushqimit që po zbatohen nga Promoting Private Sector Employment, ku përkrahja do të jetë nga 10 mijë euro deri në 100 mijë euro. Edhe projekti “Gjilani riciklon” po tregohet shumë i suksesshëm në shkollat e përzgjedhura. “Programi me Komisionin Europian është duke vazhduar me sukses në bashkëpunimin ndërkufitar, për valorizimin e tregtisë tradicionale dhe potenciali socio – ekonomik, që financohet nga BE dhe programe të tjera e të shumta nga donator dhe partner të shumtë si GIZ që është për shumë vite në Gjilan”, ka thënë ai, duke bërë të ditur edhe nënshkrimin e marrëveshjes së mbështetjes së stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të mikro – bizneseve në Kosovë, ku si Komunë në kuadër të zhvillimit ekonomik, Gjilani përfiton 121 mijë euro dhe do të përfitojnë 40 biznese.



Korça: Për nëntë muaj realizuam qindra projekte infrastrukturore

03
NËNTOR

Drejtori i Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Banimit, Naser Korça, në një konferencë për media, ka bërë prezantimin e punëve që janë bërë në këtë sektor për nëntë muaj, duke nisur nga investimet në asfaltime të rrugëve, trotuareve, kanalizimit, ujësjellësit, ndriçimit publik e deri tek mirëmbajtja dhe inspektimet komunale në kuadër të kësaj drejtorie. Me këtë rast, Korça ka thënë se janë të përkushtuar në ngritjen e ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe mbështetjen përmes investimeve të projekteve në infrastrukturën publike. “Qëllim yni, pos aspektit të përgjegjësisë që ka kjo drejtori, është edhe ngritja e ofrimit të shërbimeve më të shpejta ndaj qytetarëve. “Projektet kapitale, jashtëzakonisht të rëndësishme për qytetarët e Gjilanit, duke nisur nga mirëmbajtja verore e rrugëve, pastrimit dhe kujdesin për hapësirat e gjelbra, sinjalizimin horizontal e vertikal, ndriçimin publik dhe mirëmbajtjen e tij, investimi në rrugët e rendit të tretë dhe investime të tjera në fshatë dhe qytet, janë pjesë e angazhimit të përditshëm të zyrtarëve të kësaj drejtorie, në mënyrë që qytetarët të marrin këto produkte përditë e më të mira”, tha Korça, duke shtuar se kjo është vetëm një pjesë nga përgjegjësia shumë e madhe që i takon kësaj drejtorie. “Kemi mbi 14 mijë metra katrorë rrugë të sanuar, pastaj rreth 14 mijë metra katrorë shtresë të asfaltit, rreth 600 trupa të ri ndriçues me rreth 40 km kablllo elektrik për ndriçim, janë hapur dhe trajtuar

me zhavorr mbi 70 rrugë në fshatra, pastaj mbi 80 km rrugë të rinovuara dhe shtruara dhe shumë aktivitete të tjera nga kjo fushë”, ka thënë ai. Ai tha se edhe projekti për ofrimin e shërbimeve të varrimit është duke shkuar në bazë të kontratës, nga kompania e cila ka këtë përgjegjësi. Drejtori i Shërbimeve Publike ka dhënë edhe detaje të tjera sa i përket projekteve të vogla dhe inspektimit. “Në këtë fazë raportuese të vitit 2015, janë rregulluar mbi 600 metra rrjet i ujërave të zeza, rreth tre mijë metra katrorë kubëza betoni dhe trotuar. Projektet tjera që kanë nisur apo presin të nisin e që janë realizuar me Departamentin e Prokurimit, e që tani janë përgjegjësi e kësaj drejtorie, janë edhe investimet dhe realizimi i rrugëve në drejtim të Zabelit të “Sahit Agës”, asfaltimi i rrugëve në krahun kah deponia e mbeturinave, asfaltimi i rrugës në fshatin Përlepnice, rrugës në drejtim të Bujanocit, rrugëve në fshatin Shillovë, Zhegër, Arbëri, Dobërçan, Livoq i Ulët, Velekincë, dhe rrugë të shumta në qytet. Pas angazhimeve dhe përkushtimit është në realizim rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe angazhime që bëjnë të rrisin vllugun e punës dhe gatishmërinë për investime shtesë”, ka thënë Korça, duke potencuar se në realizim janë rregullimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik në rrugën Gjilan – Velekincë, pastaj në fshatin Dobërçan, projekti për ujërat atmosferike në rrugën “15 Qershori”, kanalizimi në lagjen e vishnjave dhe projekte të tjera me rëndësi për Gjilanin.

Shefkiu: Nga lejet e ndërtimit kemi inkasuar mbi 500 mijë euro

04
NËNTOR

Valon Shefkiu, drejtor për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në konferencë për media, ka thënë se për nëntë muaj të këtij viti janë shënuar përparime në Gjilan, duke nënvizuar se gatishmëria e qytetarëve është më e madhe se asnjëherë më parë në zyrtarizimin e ndërtimeve të reja. “Është fat shumë i mirë gatishmëria e qytetarëve për pajisje me leje ndërtimore është shumë e madhe që ndikon edhe në të hyrat e drejtorisë, por edhe në ruajtjen e hapësirave të planifikuara. Gjithashtu, pas kalimit të inspektorëve të ndërtimit në kuadër të drejtorisë sonë, kemi më të lehtë kontrollimin e ndërtimeve që bëhen në Gjilan. Është fat i mirë që tashmë qytetarët janë vetëdijesuar dhe në shumë raste nuk nisin ndërtime pa marrë edhe lejen nga drejtoria jonë”, tha Shefkiu. Gjithashtu, drejtori i Urbanizimit ka bërë të ditur se edhe shqyrtimi i lëndëve që drejtohen në këtë drejtori bëhet sipas ligjit dhe me efikasitet të plotë. “Gjatë kësaj periudhe kohore kemi 177 kërkesa për parcelim të truallit, 82 kërkesa për kushtet e ndërtimit, 101 leje ndërtimore, një leje përdorimi etj. Kështu vetëm pagesat për lejet e ndërtimit për nëntë muaj shënon rritje të lartë në krahasim të të gjitha vitet paraprake, sepse deri më tani kemi mbi 580 mijë euro, që përkthyer në shifra del se janë dhënë leje për më shumë se 98.183.5 metra katror. Kjo na jep sinjalin e qytetarisë së përgjegjshme ndaj ligjit, planifikimit dhe përgjegjësisë”, ka thënë, ndër të tjerash, Shefkiu, duke i garantuar të gjithë që t’i drejtohen urbanizmit, ngase shërbimet do të jepen me shpe-



jtësinë më të madhe të mundshme në shërbim përsëri të qytetarit. “Në sektorin e inspeksionit të ndërtimit ka një vllug të madh të punëve, është bërë inspektimi i rasteve në proces të ndërtimit, hartimi i procesverbaleve të ndërtimit, hartim i procesverbaleve – shiritimit të objekteve. Pastaj vendime për ndërprerje të punëve, dorëzim të vendimeve për rrënim të objekteve, gjoba mandatore, kallëzime penale – gjykatë si dhe shqyrtim të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve. Nga puna e këtij sektori në terren del se kemi rreth 500 inspektime në terren, që kanë të bëjnë kryesisht me përgjegjësinë e këtij sektori”, tha në paraqitjen e tij drejtori Shefkiu. Ai ka thënë se si Drejtori dhe me mbështetje edhe të kryetarit Haziri, kanë bërë hapjen e rrugëve sipas planit të miratuar në Kuvendin e Komunës për hapjen e rrugëve në zonën “Fidanishte”, kanë bërë përgatitjet për hapjen e trasesë së rrugëve edhe në hapësirën e planifikuar në kampin “Monteith” dhe “Livadhet e Arapit”, duke potencuar se në këtë mënyrë, po mundësohet ruajtja e planifikimit. Shefkiu është shprehur se objektivat e drejtorisë janë të shumta, por vëmendje e veçantë edhe në muajt në vazhdim i kushtohet shqyrtimit të drejtë dhe efikas të kërkesave të ndryshme të qytetarëve, hartimit të elaboratit të shpronësimeve – interesave publike brenda PRRU-të aprovuara, implementimin sa më efikas në teren të PRRU -ve të miratuara, hapjen e korridoreve të reja – rrugëve lidhëse dhe përmbledhëse dhe hapësirave tjera publike në kuadër të PRRU etj., ka përfunduar Shefkiu.



Hajrullahu: Shërbimet shëndetësore dhe mbështetja sociale nuk kanë qenë asnjëherë më të mira

05

NËNTOR

Nëntë muajt e këtij viti, në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, karakterizohen me punë të shumta, përfshirë mbështetjen e një numri të madh të familjeve të skemës sociale, përkudjesjen për sigurimin e banimit për familje me gjendje të rëndë ekonomike, përmes pagesës së qirasë, ndërtimit të shtëpive, rinovimeve, sikur që në shëndetësinë primare është bërë punë shumë e madhe në dhënie të shërbimeve për qytetarët, pastaj kontrollimi sistematik i nxënësve dhe të tjera. Kështu ka thënë në konferencën e rregullt për media, drejtori Nexhat Hajrullahu. “Në Gjilan përkundër angazhimit të kryetarit Haziri që të zgjidhet problemi i banimit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, ende kemi shumë raste që e kanë këtë problem”. Në Gjilan, këtë gjendje, sipas Hajrullahut e kanë rënduar edhe dyndjet e mëdha të qytetarëve nga komunat të tjera. Sa i përket shëndetit publik, është duke u bërë punë e vëllimshme në dhënie të shërbimeve dhe rekomandimin për Ministrinë e Shëndetësisë. “Nga skema për subvencionimin e personave me probleme shëndetësore, familjarëve ose të afërmeve të tyre, që lidhet me nevojën e mjekimit dhe trajtimit shëndetësor të tyre për vitin 2015, janë parashtruar dhe shqyrtuar 641 kërkesa,

ndërsa janë referuar për Ministri të Shëndetësisë mbi 100 kërkesa. Sa i përket shërbimeve shëndetësore, QKMF dhe QMF-të janë duke dhënë shërbime cilësore në shëndetin primar gjatë 24 orëve”, tha ai, duke theksuar se është dhënë mbështetje e fuqishme për kategori të ndryshme të qytetarëve që kanë probleme shëndetësore. Hajrullahu tha se deri në këtë periudhë, mbi 160 mijë shërbime shëndetësore kanë marrë qytetarët, që përfshijnë kontrollet e ndryshme shëndetësore dhe stomatologjike, sikurse edhe referimet. “Kështu gjatë kësaj periudhe janë shpërndarë mbi 4500 vaksina për të rritur dhe 50 për fëmijë, ndërsa me insulina në baza mujore shërbehen 860 pacientë, nga 5 lloje të insulinave, që në total arrin numrin e 2700 insulinave deri në këtë periudhë. Por, në formë të tjera subvencionet për barna kapin vlerën mbi 45 mijë euro, si dhe për Shoqatat me Nevoja të Veçanta, si HANDIKOS, Shoqata e të Verbërve, Shoqata e Shurdhmecëve, PEMA, OVL-UÇK e të tjera, përmes Memorandumeve të Mirëkuptimit, përfitojnë subvencione në vlerë afër 30 mijë euro”, tha ai ndër të tjerash. Ai ka potencuar edhe përkrahjen financiare për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të UÇK dhe UÇPMB-së, nga 130 euro mujore, në vlerë mbi 20 mijë euro vjetore.

Kadriu: Gjendja e sigorisë në Gjilan është stabile

06

NËNTOR

Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Ensar Kadriu, ka thënë në një konferencë me gazetarë se ky vit ka nisur me përballje të menaxhimit të gjendjes pas vërshimeve, që edhe përkundër kapaciteteve të kufizuara që kishin si drejtori kanë menaxhuar në mënyrë të kënaqshme situatën. “Ky vit, Gjilanin sikur



edhe komunat e tjera, i ka përcjellë me reshje të mëdha të shiut, që ka kërkuar edhe angazhime të vazhdueshme për të ruajtur gjendjen stabile. Si Drejtori kemi pasur kapacitete të kufizuara, por përsëri është arritur që situata të menaxhohet kënaqshëm. Kemi intervenuar nëpër shtëpi dhe oborre të ndryshme nëpër fshatra por edhe në

qytet, në largimin e ujit duke u dalë në ndihmë qytetarëve tanë”, tha ai. Furnizimi me ujë të pijes në fshatrat dhe familjet e prekura nga reshjet e mëdha nuk ka munguar asnjëherë deri në normalizimin e kushteve atmosferike, ka njoftuar drejtori Kadriu. Ai ka thënë se si drejtori kanë hartuar planin e vlerësimit të rrezikut nga vërshimet të cilin Komuna është duke e zbatuar. “Në këtë plan janë vlerësimet e rreziqeve të mundshme nga shtëpitë e amortizuara e të pabanuara në rrugën “Abdullah Presheva” dhe lagje tjera të qytetit. Janë evidentuar edhe lumenjtë dhe përroskat që rrezikojnë daljen nga shtrati, për shkak të hedhjes së mbetjeve të ndryshme”, ka thënë Kadriu. Zjarret, krahasuar me periudhën e njëjtë të viteve të tjera, kanë shënuar një rënie dhe kjo është rezultat i vetëdijesimit dhe përgjegjësisë që kanë qytetarët e Gjilanit për ruajtjen e ambientit dhe të pasurisë private dhe shtetërore. Ai ka pohuar se në këtë Drejtori kanë pranuar donaci-

one me vlerë të madhe në modernizimin e makinerisë, që po mundësojnë edhe intervenime më të shpejta dhe të sakta. “Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim përmes bashkëqytetarëve tanë që punojnë në Zvicër të pajisen me disa mjete elementare (një automjet komandues, pompa për thithjen e ujit) si dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme, një automjet profesional për fikjen e zjarreve fushore edhe me një automjet sulmues, mjete këto të cilat ngritin kapacitetet intervenuese si dhe sigurojnë intervenime efikase dhe cilësore”, ka thënë drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim. “Në kuadër të vlerësimit të rrezikut nga shembja-rrëshqitja e dheut, është identifikuar një lokacion me rrezikshmëri të lartë në fshatin Dobërçan, i cili është mënjeluar në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, si dhe një rast tjetër ku shembja ka ndodhë po ashtu në fshatin Dobërçan e që fal intervenimit janë mënjeluar pasojat e mëtutjeshme”, tha ai.



Maliqi: Auditori i Përgjithshëm nuk ka dhënë asnjë vërejtje për Drejtorinë e Buxhetit

09
NËNTOR

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Zija Maliki, në një konferencë me gazetarë, ka informuar për të hyrat dhe shpenzimet e parash publike. Në këtë periudhë 9-mujore, Drejtoria ka përgatitur raportin financiar detal, sipas ligjit për vitin 2014, që është aprovuar në fillim të vitit nga Kuvendi i Komunës. Po ashtu gjatë këtij viti janë përgatitur 39 raporte javore dhe 9 raporte mujore, kurse para Kuvendit kanë dalë tri raporte financiare tremujore. Po ashtu në këtë periudhë janë mbajtur edhe takime me qytetarë duke përfshirë edhe fshatrat, ku është diskutuar për përgatitjen e buxhetit 2016 si dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2016 – 2018. Sa i përket shpenzimeve, në këtë periudhë kohore, janë zotuar 4017 lëndë, kurse janë certifikuar dhe bërë shpenzime 3800 lëndë, të dikastereve të ndryshme buxhetore brenda Komunës. Në sektorin e Tatimit në Pronë,

nga ku gjenerohet një pjesë e madhe e të hyrave veta-nake, gjendja është e njëjtë me vitin e kaluar. “Për nëntë muaj të këtij viti, sektori i Tatimit në Pronë ka shpërndarë mbi 31 mijë fatura, në vlerë 1,519,117 euro, sikur që janë lëshuar mbi 19 mijë vërtetime të ndryshme nga ky sektor. Të hyrat e planifikuara për vitin 2015 janë 1,360,953 euro, kurse në këtë periudhë janë inkasuar 935,738 euro, apo rreth 69 për qind e të hyrave të planifikuara”, ka thënë Maliqi. Borxhi që qytetarët i kanë Komunës është mbi 7 milionë euro. Me hyrjen në fuqi të ligjit mbi faljen e borxheve, në korrik të këtij viti, rreth 5 milionë euro mund të falen, ka thënë Maliqi. Drejtori për Buxhet dhe Financa ka theksuar se Auditori i Përgjithshëm nuk ka dhënë asnjë vërejtje dhe rekomandim për këtë Drejtori, duke potencuar se gjithçka është në rregull.



Bashkësitë fetare pastrojnë varrezat myslimane e ortodokse dhe mbjellin fidanë

01
NËNTOR

Me iniciativë të kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri, sot në Gjilan ka nisur pastrimi i varrezave të qytetit, myslimane dhe katolike, duke mbjellë qindra fidanë. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Bashkësisë Islame, Kishës Katolike dhe asaj Ortodokse, sikurse edhe nxënësit e Gjimnazit. Kryetari Haziri ka thënë me këtë rast se aksioni i sotëm për pastrimin e varrezave myslimane dhe ortodokse si dhe mbjellja e fidanëve shënon përmbylljen e “Muajit të Tolerancës dhe Solidaritetit”. Pasi ka falënderuar të gjitha bashkësitë fetare që kanë marrë pjesë në aktivitete, Haziri theksoi se varrezat e qytetit tashmë do të konservohen dhe Komuna do të sigurojë vend tjetër për varrezat e reja. Tre përfaqësuesit e bashkësive fetare në Gjilan,

Naim Aliu nga Bashkësia Islame, Dom Albert Jakaj nga Kisha Katolike dhe Dragan Kojić nga Kisha Ortodokse, kanë falënderuar kryetarin Haziri për iniciativën e sotme për pastrimin e varrezave të qytetit, duke shfaqur zotimin se do t’iu përgjigjen të gjitha thirrjeve të Komunës së Gjilanit, sa herë që është e nevojshme të jenë në shërbim të besimtarëve. Ndryshe, “Muaji i Tolerancës dhe Solidaritetit” ka nisur me pastrimin e xhamisë dhe kishës në Dunav të Karadakut dhe ka vazhduar me turneun e futbollit, një ekspozitë me punime të artit figurativ, nga nxënësit e shkollave të ulëta të mesme, me tematikë “Toleranca ndërfetare dhe solidariteti”, sikur që janë mbajtur edhe dy debate, ku është folur për rolin e të rinjve dhe grave në sferën e tolerancës fetare.



Haziri hapi zyrtarisht projektin e rrugës Gjilan-Bujanoc

03
NËNTOR

Ka nisur sot ndërtimi i rrugës me katër krosi Gjilan-Bujanoc, projekt ky, i cili realizohet me financim qind për qind të Komunës së Gjilanit.

Hapjen zyrtare të këtij projekti të hyrje-daljes Gjilan-Bujanoc e ka bërë kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri me bashkëpunëtorë, i cili ka thënë se Gjilani duhet të kapërcej nga kjo infrastrukturë që e ka aktualisht, në një infrastrukturë modern. “Kjo ditë shënon hapjen e rrugës më të madhe Gjilan-Bujanoc me investim qind për qind nga Komuna. Prej sot ne fillojmë lirimimin e trotuareve, si dhe largimin e të gjitha reklamave e mureve, shtyllave të ndriçimit, rrjetit mbrojtës të FSK-së dhe të “Don Bosko”. Unë i falënderoj të gjithë për bashkëpunim sepse Gjilani duhet të kapërcej nga kjo infrastrukturë që e ka aktual-

isht në një infrastrukturë moderne dhe të qarkullueshme me mundësi të hapjes së korridoreve”, ka thënë Haziri të martën. I pari i gjilanasve ka kërkuar nga operatorët privat që të mos e pengojnë punëkryesin në realizimin e planit dinamik, ndërkaq ka paralajmëruar se në vitin e ardhshëm do të nis edhe ndërtimi i hyrje-daljes Gjilan-Prishtinë si dhe Gjilan-Ferizaj. Punëkryes është kompania “Zuka” nga Gjilani, pronari i së cilës Muhadin Zuka është zotuar se punët do të kryhen sipas planit dinamik për 90 ditë pune. Ndërtimi i kësaj rruge e cila nis nga kazerma e FSK-së ka gjatësi prej 1260 metra, me gjerësi 27 metra dhe do të ketë brez të gjelbërimit, ndriçim dhe të gjitha kërkesat tjera urbane. Vlera e projektit kap shifrën e afro 900 mijë euro.



Gjilani dhe Bursa thellojnë bashkëpunimin

03
NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot një delegacion nga Bursa e Turqisë, të cilit i printe drejtori i Arsimit në këtë qytet, Veli Sarikaya. Qyteti i Gjilanit ka bashkëpunim të mirë me Bursën, ndërsa me Jellderemin, një komunë e këtij regjioni, edhe është binjakëzuar. Bursa njihet për shkolla profesionale, ku në të ardhmen mund të orientohen edhe nxënës nga Kosova. Pasi iu uroi mirëseardhje, kryetari i Komunës së Gjilanit theksoi bashkëpunimin e mirë që Gjilani ka me Bursën dhe komunat tjera. “Gjilani ka një traditë bashkëpunimi me Bursën dhe Komunat tjera të këtij qyteti. Besoj që kjo vizitë do të shërbej në të mirë të bashkëpunimit mes vete. Ju falënderoj shumë për ardhjen

tuaj”, ka thënë gjatë takimit kryetari Lutfi Haziri. Kurse drejtori i Arsimit në Bursa, Veli Sarikaya, ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen miqësore, duke thënë se qëllimi i vizitës është që të lidhen ura bashkëpunimi mes Gjilanit dhe Bursës në aspektin e edukimit cilësor të nxënësve. Sarikaya tha se në një të ardhme të afërt pritet që shumë nxënësve të Ballkanit dhe konkretisht Kosovës, t’u jepen mundësi shkollimi në shkolla profesionale në këtë qytet, duke i hequr të gjitha shpenzimet, sikurse edhe akomodimin. Në takim kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të sektorit të Arsimit nga komuna e Yilderimit dhe Osmangazit, sikurse edhe drejtore shkollash të profileve të ndryshme.



Haziri viziton projektet infrastrukturore në Zhegër, Velekinçë e Arbëri

05
Nëntor

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, së bashku me nënkryetarin Rexhep Kadriu dhe drejtorët komunalë, Salih Kqiku e Naser Korça, ka vizituar sot dhjetëra projekte infrastrukturore që janë përfunduar në fshatin Zhegër, Velekinçë dhe në lagjen “Arbëria”. Haziri fillimisht ka vizituar gjashtë rrugë të asfaltuara në fshatin Zhegër sipas standardeve, me gjatësi prej afro dy kilometra dhe me kosto mbi 100 mijë euro. “Janë gjashtë rrugë të realizuara me buxhet të Komunës, në kuadër të programit për infrastrukturë në fshatra dhe qytet. Mbikëqyrja ka për qëllim edhe që t’i ftojme operatorët që t’i përfundojnë punimet sipas kalendarit, dinamikës dhe kontratës në mënyrë që ta përmbysim këtë vit buxhetor sa më shpejt sepse është në interes të qytetarëve që të përfundoj infrastruktura”, tha kryetari Haziri. Ai është zotuar se do të vazhdohet me investime në Zhegër në rrugë, kanalizime e ujësjellës sepse, siç tha, duhet të trajtohet kjo zonë e Karadakut në mënyrë meritore. Me këtë rast, kryetari i Këshillit të fshatit Zhegër, Shemsedin Elezi, e ka falënderuar kryetarin Haziri për trajtimin e Grykës së Karadakut për investimet e mëdha në infrastrukturë si në rrugë, kanalizim, ujësjellës e ndriçim. Në ndërkohë, kreu i Gjilanit ka parë nga afër ndërtimin e fushës sportive në fshatin Velekinçë dhe është ndarë i kënaqur me cilësinë e punimeve sipas standardeve. Haziri tha se pos kësaj, janë ndërtuar edhe pesë fusha të tjera në disa fshatra që kapin shifrën e 115 mijë eurove. “Jemi në përfundim të infrastrukturës sportive, të cilat shfrytëzohen edhe për nevojat e shkollës dhe të qytetarëve. Shpresojmë shumë që ta rumbullakojmë infrastrukturën shkollore, sportive dhe në veçanti

ky ambient do të jetë në shfrytëzim të fëmijëve dhe të rinjve në Velekinçë. Të njëjtin model janë ndërtuar fushat sportive në Livoç të Ulët, Llashticë, Uglar, Kmetoc dhe Ponesh”, u shpreh Haziri. Drejtori i Shkollës fillore “Mulla Idriz Gjilani”, Fatmir Latifi, pasi ka falënderuar qeverinë komunale për këtë investim, tha se ky është një terren jashtëzakonisht i mirë dhe i ndërtuar sipas standardeve europiane. Përveç kësaj fushe, në fshatin Velekinçë janë në realizim e sipër edhe 3 rrugë me kosto prej mbi 50 mijë euro. I pari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka vizituar edhe disa rrugë që janë përfunduar në lagjen “Arbëria”, duke shprehur kënaqësinë që po i përmbushë zotimet që i ka dhënë në fushatën elektorale. “Unë jam shumë i lumtur që sot është mbajtur një premtim për banorët duke investuar në këtë zonë, që janë familja më e vjetër në lagje, e cila ka qenë e anashkaluar. Përfundimisht, ne po e përmbysim ciklin e infrastrukturës në këtë pjesë dhe do të vazhdojmë edhe në pjesë të tjera në lagjen “Arbëria”. Është sukses edhe i qeverisë komunale edhe i operatorit, kompanisë “Tali”, i cili suksesshëm i ka kryer punët këtu dhe në pjesë tjera. Unë apeloj tek operatorët që të marrin këtë shembull të kësaj kompanie dhe t’i realizojnë punët sepse nuk ka kohë”, tha Haziri. Nga ana e tij, Islam Shkodra, i cili jeton në këtë lagje tha se për banorët e atyshëm ka filluar një jetë e re pas këtyre investimeve. “Në këtë lagje kemi pasur problem me ujërat e shiut, me pluhur, por tash po na duhet se ka filluar një jetë e re për këtë lagje. E falënderoj kryetarin që e mbajti premtimin”, ka thënë Shkodra. Ndryshe, në lagjen “Arbëria” janë asfaltuar edhe tri rrugë që kapin shumë e mbi 50 mijë eurove.



Gjilani nënshkruan marrëveshje mirëkuptimi me OJQ-në “NOPM”

09
NËNTOR

Komuna e Gjilanit ka nënshkruar sot një marrëveshje mirëkuptimi me organizatën joqeveritare Network of Peace Movement (NOPM), si përzgjedhëse për implementimin e projektit të financuar nga programi AKT LS I USAID-it e titulluar “Rritja e pjesëmarrjes së publikut në buxhetim përmes përfshirjes gjinore, të rinjve dhe komunitetit pakicë”. Në emër të kryetarit Haziri, marrëveshjen e ka nënshkruar nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu si dhe drejtoresha ekzekutive e NOPM, Besime Tusha. Nënkryetari Kadriu tha se Komuna e Gjilanit e udhëhequr nga Lutfi Haziri është gjithmonë e gatshme të bashkëpunojë me organizatat siç është “NOPM”, qëllimi i projektit të së cilës është rritja e pjesëmarrjes së grave, të rinjve, komuniteteve pakicë në çështjet komunale dhe jetën publike, me fokus të veçantë në planifikimin dhe përgatitjen e buxhetit. Përfaqësuesja e OJQ “NOPM”, Besime Tusha –Maliqi, ka falënderuar Komunën e Gjilanit për bashkëpunim në këtë projekt i cili zgjat 11 muaj, me synim në arritjen e objektivave duke organizuar tryeza të rumbullakëta, punëtori, trajnime me ekzekutivin dhe legjislativin, radio debate/spote, vizita në terren, debate buxhetore, monitorim dhe avokim me theks të veçantë përfshirjen e të rinjve, grave si dhe komuniteteve pakicë në proceset buxhetore.

Bunjaku-Rexhepi: Kemi bërë punë jashtëzakonisht të rëndësishme për qytetarët



11
NËNTOR

Kuvendi Komunal i Gjilanit ka bërë punë jashtëzakonisht të rëndësishme në këtë nëntëmuor të vitit dhe në këtë drejtim mbetet i përkushtuar të punojë edhe në të ardhmen, duke e ftuar edhe opozitën që të bashkëpunojë për të mirën e qytetarëve, por jo duke u munduar të imponojë agjendat e punës së organit vendimmarrës, sepse kjo e drejtë i takon partisë më të madhe. Kështu ka thënë të mërkurën, Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, në një konferencë me gazetarë, ku ajo ka prezantuar aktivitetin e organit vendimmarrës dhe trupave të tij, në këtë 9-mujor të vitit. Gjatë kësaj periudhe kohore, Kuvendi Komunal ka mbajtur 7 seanca, ku ka miratuar 58 vendime dhe 2 rregullore, ndërsa komitetet, si trupa ndihmëse të tij, kanë mbajtur 62 takime dhe kanë bërë 52 rekomandime. Në punë e sipër është edhe Komisioni për emërtimin e rrugëve, i cili deri tani ka mbajtur 15 takime, ndërkaq Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 4 takime. Të gjitha vendimet e miratuara janë dërguar në MAPL dhe në asnjë rast nuk është konstatuar se ka pasur shkelje ligjore ose procedurale, gjë që dëshmon se Kuvendi Komunal ka punuar në mënyrë plotësisht ligjore, ka thënë Bunjaku-Rexhepi. Ndërkaq, duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve rreth raporteve me opozitën, gjuhën e përdorur në Kuvend Komunal, nga disa këshilltarë si dhe zgjatjen e seancave nga disa orë, Bunjaku-Rexhepi ka thënë se asnjëherë nuk ka treguar arrogancë ndaj opozitës, ndonëse opozita shpeshherë po e tepron me sjelljet e saj dhe po tejkalon çdo limit,

ka thënë ajo. Kryesuesja e Kuvendit tha se edhe në seancën e fundit e ka respektuar opozitën dhe e ka futur në rend dite informatën për arsimin, por ata nuk u treguan mirënjohës, duke u sjellë sikur këtë ishim të detyruar ta bënim. Ajo kërkoi nga opozita të jetë më e përgjegjshme në raport me obligimet që ka ndaj qytetarëve dhe të mos demonstrojë arrogancë në seancat e Kuvendit, nëse do të mos i tregohen dyert, në rastet kur ngrihet në këmbë dhe nuk lejon vazhdimin e punës. “Ne mund ta vazhdojmë punën edhe pa opozitën, sepse i kemi numrat e mjaftueshëm, por nuk e dëshirojmë këtë gjë”, ka thënë Bunjaku-Rexhepi. Sa i përket gjuhës, ajo tha se gjuha në Kuvendin Komunal të Gjilanit, është më e mira në të gjitha kuvendet komunale të Kosovës. Në Kuvendin Komunal të Gjilanit, ndonjëherë ka metafora, por ato janë në funksion të debatit. Zgjatja e seancave deri vonë, tregon se Kuvendi Komunal i Gjilanit është transparent, ku respektohet fjala e lirë e secilit dhe jo rastësisht, vitin e kaluar është renditur i pari për transparencë në nivel të vendit, nga shoqëria civile. Kurse sa i përket pyetjes për zgjedhjen e zëvendës kryesuesit të Kuvendit Komunal nga radhët e komuniteteve, ajo sqaroi se ligji nuk e obligon Komunën e Gjilanit, sepse komunitetet nuk përbëjnë mbi 10 për qind të popullsisë së përgjithshme. Megjithatë, kryetari i Komunës ka treguar vullnet për t’ua dhënë komuniteteve këtë pozitë, por komunitet nuk kanë mundur të merren vesh mes vete. Sidoqoftë ne jemi në shërbim të gjithë qytetarëve, përfshirë edhe komunitetet, ka thënë Bunjaku-Rexhepi.



Në infrastrukturë publike do të investohen 22 milionë gjatë vitit 2016

12

NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në një konferencë për media, ka prezantuar punët e periudhës 9-mujore. Haziri paralajmëroi fillimin e ndërtimit të dy çerdheve si dhe projektit të rrethojës së shkollave të mesme, që do të realizohet në partneritet publiko-privat. “Gjatë këtij nëntë-mujori kemi arritur të realizojmë pjesën më të madhe të punëve publike, që përfshin të gjitha kategoritë e shërbimeve, kartelës sociale, e cila është duke u rinovuar dhe duke u adaptuar në përputhje me ligjin”, ka thënë Haziri. Ai tha se për çdo kontraktor siç është Komisioni European dhe organizatat tjera, Komuna e ke kushtëzuar pjesëmarrjen e punëtorëve nga qendra për punësimit. Haziri tha se sipas shënimeve, Komuna e ka trendin e njëjtë të ambientit ekonomik me vitin e kaluar, në regjistrimin e bizneseve të reja, krijimin e kushteve për zhvillim lokal ekonomik, numri i mbi 860 të punësuarve brenda këtij viti, që sipas tij është trend pozitiv, por jo i kënaqshëm për nevojat e Komunës së Gjilanit. Ai foli edhe për punën e madhe që është bërë në ofrimin e shërbimeve të qytetarëve në shërbim civil. “Përveç shërbimeve “online” që po shfrytëzohen edhe nga qytetarët e Gjilanit dhe nga jashtë, Komuna ka aplikuar tri shërbime më të shpejta në shërbim civil, siç është “One Stop Shop” i cili do të përfundoj këtë vit duke integruar edhe shërbimet kadastrale brenda objektit të njëjtë, pastaj kemi ofruar shërbimin e pagesës brenda objektit dhe kemi aplikuar metodën e punës nga distanca”, tha Haziri. Kreu i Gjilanit tha se arsimi dhe shëndetësia, si dy prioritetet e Komunës së Gjilanit, kanë treguar rezultate tejet pozitive gjatë këtij 9-mujori. “Kemi progres edhe në kuptimin e disiplinës në punë dhe vijueshmërisë. QKMF dhe shëndetësia primare, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, po e përmbyllin shtrirjen e organizimit primar në tërë territorin e Komunës së Gjilanit. Në sistemin e arsimit edhe më tutje ballafaqohemi me

probleme buxhetore si pasojë e mbipunësimit që ne e kemi trashëguar dhe po mundohemi ta zgjidhim me Ministrinë e Financave”, u shpreh Haziri. Kryetari i Gjilanit paralajmëroi se shumë shpejt do të fillojë ndërtimi i dy çerdheve, njëra në lagjen “Dardania” dhe tjetra në lagjen “Arbëria”, ndërkaq sot do të nënshkruhet kontrata për ndërtimin e kompleksit të shkollave të mesme, përmes partneritetit publiko-privat. Paralelisht, kemi filluar me ndarjen e Universitetit dhe objekti i shkollave të mesme, ku ky institucion duhet të kalojë në kompleksin universitar në kazermën e FSK-së”, ka deklaruar Haziri. Ai ka nënvizuar se shumicën e të hyrave komunale i ka orientuar në ndërtimin e infrastrukturës, e cila përfshinë kanalizime, ujësjellës dhe rrugë. “Tashmë ka nisur ndërtimi i aksit Gjilan-Bujanoc, kurse vitin e ardhshëm do të nis hyrja-dalja Gjilan-Prishtinë dhe Gjilan-Ferizaj. Ndërkaq, ndërtimi i autostradës Prishtinë-Gjilan-Bresalc-Dheu i Bardhë, do të bëhet me buxhet të qeverisë së Kosovës”, ka thënë Haziri. Në konferencën e të enjtes, Haziri ka paralajmëruar se me ndihmën e partnerëve, investimet në infrastrukturë në vitin 2016 kapin shifrën e mbi 22 milionë euro. Investimet do të bëhen në trajtimin e ujërave të zeza, rregullimin e rrjetit të kanalizimeve dhe infrastrukturës së ujërave atmosferikë”, tha ai. Investimet e jashtme vijnë si rezultat i disiplinës së ashpër buxhetore. “Ne partneritet me donatorët ndërkombëtarë, është rezultat i disiplinës buxhetore, uljes së shpenzimeve dhe kontrollit të madh buxhetor”, tha ai. Kreu i Gjilanit tha se Komuna po konkurren edhe në programe të reja me KE, duke shfaqur besimin se edhe për vitin e ardhshëm Gjilani do të jetë përfitues i disa programeve nga ky institucion. Një pengesë e madhe deri tani, kanë qenë borxhet e trashëguara, të cilat kanë marrë miliona euro, mjete këto të cilat do të mund të orientoheshin në infrastrukturë, ka thënë Haziri.

“Caritasi” zviceran ofron mbështetje për institucionet parashkollore

12
NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri dhe drejtori i Arsimit, Nazmi Musa, kanë nënshkruar të enjten marrëveshje me “Caritas-in” e Zvicrës për periudhën 2015-2017, përmes së cilës do të mbështeten klasat parashkollore, duke nisur nga furnizimi me pajisje moderne, trajnim profesional për edukatorët “Të mësuarit dhe zhvillimi i fëmijës përmes lojës”, deri te angazhimet në zhvillimin e strategjisë parashkollore në zbatimin e arsimit të detyrueshëm. Me këtë rast kryetari Haziri, ka falënderuar “Caritas-in” zviceran, që në bashkëpunim me drejtorinë e Arsimit, nënshkruam partneritet bashkëpunimi për periudhën dy vjeçare. “Sot Komuna e Gjilanit, respektivisht Drejtoria e Arsimit dhe “Caritas-i” zviceran, kanë nënshkruar marrëveshjen e partneritetit për mbështetjen për arsim, konkretisht Institucioneve Parashkollore. Falënderoj “Caritas-in” zviceran për mbështetjen e vazhdueshme që po i bënë institucioneve të arsimit. Unë i kam siguru-

ar që Gjilani për shkak të përqendrimit dhe prioritetit që ka në arsim, zotohet që ta përmbushë në interes të përgatitjes së gjeneratave më të reja, për ciklin shkollor dhe ciklin e jetës që i pret”, ka thënë në fjalën e tij kryetari Haziri. Ndërsa nga ana e tij, Kreshnik Basha, shef i “Caritas-it” zviceran në Kosovë, ka thënë se kjo organizatë do të mbështes klasat parashkollore në shkollat e Gjilanit. “Kjo marrëveshje parasheh mbështetjen në forma të ndryshme të klasave parashkollore. Po ashtu, do të ofrohet edhe një trajnim i certifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për edukatorët që janë të përfshirë në këtë cikël të arsimit. Theksoj se bashkëpunimi me Komunën e Gjilanit është i përkryer. Jemi të gatshëm që ta zgjerojmë këtë bashkëpunim edhe në vitet tjera. Në këtë Komunë, kjo do të jetë pakoja e dytë e ndihmave dhe nuk do të jetë e fundit, besojmë shumë se do të ketë edhe të tjera”, tha ai, pas nënshkrimit të marrëveshjes.

Libri “Kosova” ka zgjuar interes të jashtëzakonshëm përtej kufijve shqiptarë

17
NËNTOR

Në Gjilan sot është bërë prezantimi i librit “Kosova” i historianit Jusuf Buxhovi, libër ky që përmbledh historinë e Kosovës që nga pellazgët e deri në vitin 1999. Përmbledhja e historisë shqiptare “Kosova”, në tri vëllimet e para, tashmë është përkthyer edhe në gjuhën angleze dhe gjendet në bibliotekat më të mëdha botërore. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës së Gjilanit, ka thënë se Jusuf Buxhovi është publicist, shkrimtar, politikan dhe historian që ka lënë gjurmë me botimet e tij, duke zgjuar interesin shqiptar dhe më gjerë. “Jo rastësisht jemi së bashku sot në këtë promovim Gjilani dhe Presheva, që janë simbolikë e një Kosove që ka nevojë të shërohet dhe plotësohet ende. Ky vëllim i librit na plotëson dhe na zgjon interes të gjithë neve”, tha Haziri.



Ndërsa, në emër të botuesit ka folur Ramiz Tafilaj, i cili ka thënë se ky libër pos në trevat shqiptare, ka zgjuar një interesim shumë të gjerë edhe në botën përtej Atlantikut. “Ky botim ka ngjallur një interesim të jashtëzakonshëm gjithandej. Është prezantuar edhe në qendrën më të madhe ushtarake ku është pritur jashtëzakonisht mirë. Ne tashmë kemi se çka të prezantojmë para botës dhe kjo është falë përqendrimit të autorit Jusuf Buxhovi”, ka thënë ai. Ramadan Musliu, redaktor i librit, në mënyrë analitike ka folur për përmbajtjen që ka ky libër, duke potencuar prejardhjen shqiptare që nga antikiteti, lidhjen me pellazgët, elaborimin e periudhës së mesjetës, periudhën osmane, periudhën 1912 – 1945 pastaj periudhën deri në vitin ’99, duke potencuar faktografinë dhe per-

sonalitetet me rëndësi që autori ka spikatur e të cilët janë me prejardhje pikërisht nga vija iliro – dardane. Faton Bislimi, ka folur për jehonën e librit pas përkthimit nga shtëpia botuese “Jalifat Publisher” në bashkëpunim edhe të studentëve të shumtë shqiptarë në botën perëndimore që mundëson një prezantim më të lehtë dhe kualitativ të shqiptarëve. Ndërsa, Jusuf Buxhovi, ka thënë se promovimi në Gjilan lidhet për disa personalitete, siç është

Beqir Musliu, i cili është referencë e fuqishme e letërsisë shqipe, që me vargjet e tij ktheu letërsinë kah vlerat moderne dhe post moderne dhe Mulla Idriz Gjilani, i cili paraqet personalitetin më të rëndësishëm të lëvizjes anti-fashiste, anti-sllave dhe anti-komuniste në këtë hapësirë. Kjo lëvizje ishte e para në Europë kundër komunizmit, e bashkë me të edhe kundër okupimit të tokave shqiptare nga forcat sllavo – komuniste.



Haziri kërkon nga drejtorët zbatimin e rekomandimeve të ZAP-it

17
NËNTOR

Nën udhëheqjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, është mbajtur sot mbledhja e bordit të drejtorëve, me pikë të veçantë lidhur me rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) dhe atij të brendshëm, që janë dhënë për punën gjatë vitit 2014. Kryetari Haziri, me këtë rast, ka thënë se një pjesë e rekomandimeve janë përmbushur, ndërsa

pjesa tjetër janë në implementim e sipër. Haziri ka kërkuar nga drejtorët komunalë që sa më parë ta përmbushin edhe pjesën tjetër të rekomandimeve, të dala nga raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe atij të brendshëm të Komunës së Gjilanit. Ndryshe, Haziri tha se ndihet krenar që raporti i Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014 është më i miri në histori të institucionit të Komunës së Gjilanit.



Austria, 12 milionë euro për trajtimin e ujërave të zeza në Gjilan

17
NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nënshkruar sot një marrëveshje shumë të rëndësishme me kompaninë austriake “Ostap”, në vlerë prej 12 milionë euro, për trajtimin e ujërave të zeza dhe ujërave atmosferikë. Haziri, këtë marrëveshje e ka vlerësuar si më të rëndësishmen që Komuna e këtushme ka nënshkruar brenda dy vitesh dhe e cila do t’ua bëjë jetën më të mirë qytetarëve të Gjilanit. “Është një ditë jashtëzakonisht e rëndësishme, ku pas një pune gati dyvjeçare dhe të përbashkët, ne kemi nënshkruar sot marrëveshjen me kompaninë austriake “Ostap”, e cila hapë rrugën që Gjilani të marrë investimin më të madh nga qeveria e Austrisë në një aplikim prej 12 milionë euro. Gjilani e zgjedh problemin më të madh të ujërave të zeza. Me këtë rast, bëjë apel që edhe investitorët tjerë, qofshin privatë apo shtetërorë, të bashkëngjiten në këtë iniciativë, në mënyrë që investimet në komunën e Gjilanit të mos mungojnë”, ka thënë Haziri, në adresimin para mediave. Ai tha se ky projekt do të mundësojë që të largohet çdo lloj ndotësi në territorin e komunës së Gjilanit. “Ky projekt që përfshin 54 kilometra hapësirë dhe punime në trajtimin e ujërave të zeza dhe trajtimin e ujërave atmosferikë, i cili është problemi

më i madh në Komunën e Gjilanit, rregullimin e shtratit të lumit “Stanishkorka” dhe përfundimin e të gjitha kanalizimeve dhe integrimin e rrjetit të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferikë për territorin e Gjilanit, duke prekur edhe fshatra dhe vendbanime tjera, në mënyrë që ta largojmë çdo lloj ndotësi në Komunën tonë”, ka deklaruar kryetari Haziri. Ndërkaq, drejtori i kompanisë austriake “Ostap”, Christoph Gierlinger, ka shprehur gëzimin e tij që u nënshkrua kjo marrëveshje, përmes së cilës bëhet mbrojtja e mjedisit për qytetarët e Gjilanit. “Jam shumë i gëzuar që Komuna e Gjilanit ka vendosur të hartojë këtë projekt me kompaninë tonë “Ostap” dhe së bashku me qeverinë austriake, përmes bankës austriake, për këtë projekt shumë të rëndësishëm që do të jetë një hap shumë i madh për ardhmen për të mirë e qytetarëve të Gjilanit, për rregullimin e kanalizimit për zhvillimin lokal të infrastrukturës dhe për të tërë regionin, duke aplikuar standarde për mbrojtjen e ambientit. Kështu që ju përgëzoj për këtë vendim”, tha Gierlinger. Ndryshe, kryetari Haziri ka paralajmëruar se gjatë javës do të nënshkruaj marrëveshje tejet të rëndësishme edhe me qeverinë zvicerane dhe kompani tjera të huaja.

Haziri: Plani për integritet është dokument pune për administratën

19

NËNTOR

Komuna e Gjilanit ka prezantuar sot “Planin për Integritet 2015-2017”, i cili njihet edhe si plan kundër korrupsionit, që është realizuar në bashkëpunim me UNDP dhe Agjencinë Anti Korrupsion. Në këtë ngjarje ka marrë pjesë kryetari Lutfi Haziri, përfaqësues të UNDP-së, të Agjencisë Anti Korrupsion, të shoqërisë civile si dhe qytetarë të shumtë. Përfaqësuesja e UNDP-së, Shqipe Neziri, tha se ky plan specifikon kornizat kryesore që mund të përdoren për parandalimin e korrupsionit, për vendosjen e sistemit të integritetit në Komunë si dhe për ngritjen e transparencës për të qenë sa më afër qytetarëve. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës së Gjilanit, e ka falënderuar UNDP-në dhe Agjencinë Anti Korrupsion për ndihmën që të bëhet ky plan për integritet, me qëllim që të parandalohet çdo formë dhe tendencë korruptive, që mund që mund të vije si pasojë e ushtrimit të detyrës zyrtare. “Në këtë dokument janë objektivat strategjike, të cilat janë realizuar në mbështetje të plotë të ekipit të UNDP-së si dhe Agjencionin Anti Korrupsion, me qëllim që të parandalohet çdo formë dhe tendencë korruptive, që mund që mund të vije si pasojë e ushtrimit të detyrës zyrtare. Duke e rritur kodin e etikës dhe duke e rritur transparencën si dhe duke punuar shumë edhe në rritjen e disiplinës në zbatim të ligjit, disiplina buxhetore, disiplina në shpenzim të buxhetit, ne i kemi ndërmarrë disa veprime konkrete për të parandaluar mundësinë dhe tendencat që vazhdojnë ta sëmurin organizmit tonë shtetëror”, tha Haziri. Haziri tha se këto objektiva do të zbatohen pikë për pikë për të ndikuar në

përmirësimin e besimit qytetar dhe përmirësimin e shërbimeve për në përgjithësi. Ai ka vlerësuar se ky dokument është terapi për administratën që t’i zgjidhin problemet. “Organizmi ynë është i sëmurë ndaj kancerit të quajtur korrupsion. Kjo shërohet vetëm nëse e marrim terapinë me kohë dhe nëse ‘terapinë’ ia përshtatim problemeve tjera. Kjo terapi për ne është e obligueshme. Këtë dokument, në të cilin është punuar 1 vit, nuk duhet ta lëmë në sirtar. Ky dokument është doracak i punës dhe është terapi për administratën tonë që t’i zgjidhim problemet”, ka thënë kryetari Haziri. Ndërkaq, drejtori i Agjencisë Antikorrupsion, Hasan Preteni, e ka përgëzuar Komunën e Gjilanit për hartimin e këtij plani, duke specifikuar se Gjilani është vetëm komuna e tretë që e ka bërë këtë deri më tash. “E përgëzoj Komunën e Gjilanit për dokumentin që po e publikon sot, që lufta kundër korrupsionit dhe integriteti janë dy përpjekje për të përmirësuar cilësinë në administratës. Të gjitha institucionet duhet të kenë plan të detajuar të integritetit dhe shumë pak kanë punuar në këtë drejtim. Deri më tani Komuna e Gjilanit është vetëm Komuna e tretë që e ka bërë këtë plan. Arsytet e hartimit të këtyre planeve janë që të evitojmë këtë krizë morale që na ka kapluar, të ngrehim vetëdijen, të respektojmë ligjin, t’i profesionalizojmë zyrtarët, të shpenzojmë drejt parane publike dhe përfundimisht ta fuqizojmë kulturën e llogaridhënies dhe transparencës”, është shprehur Preteni. Në fund, kryetari Haziri ka ripërsëritur se do të shpërblehen me nga 2000 euro të gjithë qytetarët që e denoncojnë korrupsionin eventual.



USAID-i ndërton çerdhen në Dardani

20
NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri dhe drejtori i misionit të USAID-it në Kosovë, James Hope, kanë nënshkruar marrëveshjen për financimin e përbashkët të projektit të çerdhes në lagjen “Dardania”, në shumën mbi 500 mijë dollarë. USAID di të kontribuojë me 200 mijë, ndërkah Komuna me mbi 300 mijë dollarë. “Edhe deri më tani kemi punuar në Komunën e Gjilanit, mirëpo ky projekt të cilin po e fillojmë sot, është unik për arsye se USAID për herë të parë punon në një Komunë në mënyrë të drejtpërdrejt në Kosovë, siç është ndërtimi i objektit parashkollor në lagjen “Dardania”, ka thënë drejtori i USAID-it, James Hope. Ai tha se arsyeja pse është zgjedhur Gjilani, është për shkak se ka një udhëheqje të mirë dhe ka një përkushtim të fuqishëm në ofrimin e shërbimeve të mira ndaj qytetarëve. “Për të pasur një projekt të tillë me një Komunë, është një parakusht i domosdoshëm, që është një qeverisje e mirë, gjithashtu edhe transparenca dhe llogaridhënia. Kjo është pikërisht edhe arsyeja pse jemi sot në Gjilan sepse ka një udhëheqje të mirë dhe ka një përkushtim të fuqishëm në ofrimin e shërbimeve të mira ndaj qytetarëve, por gjithashtu edhe një përkushtim ndaj transparencës dhe llogaridhënies”, ka thënë Hope. Ndërkah, kryetari Haziri e ka falënderuar drejtorin e USAID-it për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje shumë të nevojshme. “Programi

“Qeveria-Qeverisë” nënkupton që mjetet e taksapaguesve amerikanë, drejtpërdrejt hyjnë në buxhetin e Komunës së Gjilanit, në një investim të përbashkët”, ka thënë Haziri. Ky investim e plotëson nevojën arsimore për këtë pjesë të qytetit dhe përfundimisht, partneriteti i Komunës së Gjilanit dhe USAID-it në Kosovë dhe tash i qeverisë amerikane, është tregues i qartë i përkushtimit tonë që të punojmë në partneritet për jetë më të mirë të qytetarëve. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje për financimin e çerdhes në “Dardani”, kryetari Haziri tha se USAID ka vlerësuar llogaridhënien, transparençën dhe disiplinën buxhetore të Komunës së Gjilanit. “Kërkesa ime e vazhdueshme si i zgjedhur i qytetarëve ka qenë gjithmonë që llogaridhënia, transparenca dhe disiplina buxhetore janë kritere të padiskutueshme në kryerjen e detyrave në komunën tonë dhe kjo sot po vlerësohet jashtëzakonisht shumë nga një mision, siç është USAID dhe po ofrohet një mbështetje financiare jashtëzakonisht me vlerë, e që Gjilani e bënë histori të misionit të USAID në Kosovë, duke qenë komuna e parë e cila përfiton në këtë projekt “Qeveria-Qeverisë. Ndërtesa e re do të ofrojë një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për 120 fëmijë të moshës parashkollore, të ndarë në dy nën-grupe të moshave: 45 fëmijë të moshës nga gjashtë muaj e deri në tre vjeç dhe 75 fëmijë që janë në mes të moshave tre dhe pesë vjeç.

Bashkëpunimi i Komunës me Policinë ka bërë që siguria publike të jetë në nivel

20

NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, së bashku edhe me nënkryetarin, Rexhep Kadriu dhe drejtorë të drejtorive komunale, kanë pritur sot në një takim të rregullt komandanten regjionale të Policisë së Kosovës në Gjilan, Elmina Mahmuti dhe komandantin e stacionit policor, Remzi Azemi, me të cilët ka biseduar për sigurinë publike dhe krijimin e ambientit të sigurt për qytetarët, pa dallime etnike, fetare, kulturore. Haziri ka falënderuar Policinë e Kosovës për angazhimin e saj në krijimin e ambientit të sigurt për qytetarët. “Policia e Kosovës është duke bërë punë të madhe në parandalimin e krimit, atakimin e pronës dhe problemeve të tjera, me të cilat ballafaqohet çdo

shoqëri”, ka thënë Haziri, duke shtuar se bashkëpunimi i Komunës së Gjilanit dhe Policisë ka bërë që siguria publike të jetë në nivel. Ai theksoi se Komuna do ta mbështes projektin e krijimit të qendrës së kontrollit të situatave, vendosjen e kamerave të sigurisë në komunikacion dhe integrimin e rrjetit të kamerave në institucionet publike. Ndërsa komandantja Elmina Mahmuti u shpreh e kënaqur sa i përket bashkëpunimit me Komunën e Gjilanit dhe departamentet vartëse të saj. “Çështja e sigurisë, parandalimi i akteve të dhunës, edukimi dhe shumë aktivitete të tjera, nuk do të ishin në këtë nivel, po të mos kishte një bashkëpunim shumë të mirë të Policisë me Komunën”, ka thënë Mahmuti.



Xhavit Ahmeti, njeri i madh në shërbim të bërjes së Kosovës shtet të pavarur

21

NËNTOR

Komuna e Gjilanit ka organizuar akademi përkujtimore për profesorin Xhavit Ahmeti, në 19-vjetorin e vdekjes së tij. Akademik Nexhat Daci tha me këtë rast se Xhavit Ahmeti ishte njeri i qetë, modest, profesionist i madh, politikan me virtyte të larta e çka jo tjetër. Ai tha se për Ahmetin i kishin folur fjalë të mira në të gjitha nivelet akademike, si në Sarajevë, Zagreb e gjetiu. Për Gjilanin është krenari që e kishte Xhavit Ahmetin. “Angazhimi profesional dhe politik i Ahmetit, janë shembull që duhet ndjekur edhe sot, për të mirën e vendit dhe të ndërtimit të shtetit”, ka thënë Daci. Ndërsa, në emër të qeverisë së Republikës së Kosovës, fjalë rasti ka mbajtur, ministri i Shëndetësisë, Imet Rrahmani, i cili ka thënë se Ahmeti ishte një kolos i punës për bërjen e shtetit. Ai, që nga studimet, deri në vdekje dha kontribut të pashoq në ngritjen dhe zgjerimin e arsimit shqip, në një kohë kur Kosova ishte e okupuar nga regjimi serb. Kurse, në emër të Komunës së Gjilanit, nënkryetari Rex-

hep Kadriu, ka thënë se doktor Xhavit Ahmeti, është një figurë e rëndësishme dhe zë një vend të veçantë në historinë kombëtare, e posaçërisht në atë të Kosovës dhe Gjilanit, përkrah Mulla Idrizit, Zija Shemsit, Agim Ramadanit dhe shumë veprimtarëve tjerë. Ai ka dhënë një kontribut shumë të madh në arsim, në shkencë, në politikë dhe gjithandëj. Ishte deputet në legjislaturën e vitit '96, ministër i Arsimit, detyrë që i është besuar nga presidenti historik, Ibrahim Rugova. Ishte njeri i përkushtuar për punë dhe personalitet që është krenari e Gjilanit dhe Kosovës. Kadriu ka bërë të ditur se kryetari Haziri i ka propozuar presidentes Atifete Jahjaga, që ta nderojë me mirënjohje këtë figurë me vlera të larta politike, kulturore e shkencore. Djali i tij, Bekim Ahmeti, ka thënë se kjo e lehtëson dhembjen e familjes. Xhavit Ahmeti ka humbur jetën tragjikisht më 21 nëntor 1996, gjatë një udhëtimi zyrtar për në Beograd, ku do të duhej të diskutohej për arsimin shqip dhe hapjen e shkollave shqipe.

Nis rregullimi i rrjetit të kanalizimit në Përlepnice



23
NËNTOR

Nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu i shoqëruar edhe nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, Valentina Bunjaku – Rexhepi, kanë marrë pjesë në nisjen e punimeve në rregullimin e rrjetit të kanalizimit në fshatin Përlepnice. Ky projekt kap një vlerë financiare prej 90 mijë euro dhe parashihet të përfundojë brenda 95 ditësh. Kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku – Rexhepi, ka thënë se programi qeverisës po dëshmohej përmes projekteve të ndryshme në infrastrukturën publike. “Trajtim të njëjtë do të kenë edhe fsha-

trat tjera të Gjilanit”, ka thënë ajo. Ndërsa, nënkryetari Rexhep Kadriu, ka thënë se kjo dëshmon që kryetari Lutfi Haziri, është i përkushtuar që infrastrukturën publike ta përfundojë gjatë vitit 2016, në gjithë hapësirën e Komunës. Kurse në emër të fshatit, Imami, Abdylaqim Shaqiri, ka thënë se të gjitha projektet që bëhen janë të mirëseardhura për banorët. “Rrjeti i kanalizimit, rruga, ura, investimi në rrugët bujqësore dhe projekte të tjera, janë shumë të rëndësishme për ne, sepse krijohen kushte më të mira për jetë”, ka thënë ndër të tjera Shaqiri.

Pjesëmarrja e qytetarëve në planifikim dhe vendimmarrje, mundëson zhvillim të qëndrueshëm

23
NËNTOR

Në tryezën e organizuar nga USAID-i, në kuadër të programit “Avancojmë Kosovën së Bashku”, fokus kryesor ishte pjesëmarrja e publikut në proceset vendimmarrëse komunale, duke përfshirë komunitetet pakicë, grupet e grave, rininë, bizneset dhe qytetarët në përgjithësi, me theks të veçantë bashkëpunimin e Komunës me këto grupe të interesit në procese të rëndësishme komunale. Në këtë takim, që kryesohej nga drejtoresha e programit, Amy Denkenberger, morën pjesë kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri si dhe drejtues e zyrtarë tjerë nga komunat Gjilan, Ranillug, Partesh e Killokot, përfaqësues të fshatrave, OJQ, grupe të grave, organizata rinore etj. Përfaqësimi gjinor në Komunën e Gjilanit u vlerësua pozitiv, sikur që edhe pjesëmarrja e qytetare. Me këtë rast drejtoresha Denkenberger ka thënë se programi ka një kohëzgjatje tri vjeçare dhe përqendrohet në tri fusha: pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë dhe bashkëpunimin e tyre me shumicën, nivelin e zhvillimit ekonomik, kapacitetet dhe mbështetjen e bizneseve të vogla dhe të

mesme, përfaqësimet e Komunave në raport me dy gjinitë dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje. “Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi mes Komunave dhe publikut, duke përfshirë pjesëmarrjen e grave, rinisë, shoqërisë civile, përfaqësuesve të ndryshëm nga fshatrat si dhe të qytetarëve, në përgjithësi, në planifikimet që janë afatgjate për zhvillim, mbështetje të bizneseve etj”, ka thënë ajo. Kurse kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, tha se pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje është shumë e rëndësishme për institucionet komunale. “Sa më të hapur dhe bashkëpunues të jemi, aq më lehtë mund të zgjidhen problemet që kanë grupet e ndryshme të përfaqësimeve qytetare”, ka thënë Haziri. Ai ka garantuar lëvizjen e proceseve përpara në vendimet të cilat janë interes i përbashkët i të gjithë qytetarëve, pa dallime etnike, fetare, gjinore apo të tjera. Ndërsa, Agim Salihu, zyrtar në USAID, ka bërë një prezantim, që përmbledhë statistika të ndryshme mbi pjesëmarrjen e publikut dhe rëndësinë e kësaj pjesëmarrje në proceset drejtuese.

Dhuna në familje duhet të zbres në pikën zero

25

NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar edhe nga kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku – Rexhepi, nënkryetari i Novobërdës, Bajrush Ymeri, kanë marrë pjesë në aktivitetin kundër dhunës në familje, që është organizuar nga Mekanizmi Koordinues Kundër Dhunës në Familje, mbështetur nga UN WOMEN. Me këtë rast, kryetari Lutfi Haziri, ka thënë se Gjilani sonte ka hyrë në shënimin e netëve portokalli, që është sinonim i kundërshtimit të dhunës në familje apo ndaj grave dhe femrave në veçanti. “Gruaja është shtylla kryesore -qeliza e familjes dhe e shtetit. Mekanizmi Koordinues është mekanizmi që është vlerësuar nga institucionet tjera, si mekanizëm shumë funksional, duke përfshirë autoritete zyrtare nga fusha të ndryshme. Gjilani, falë akterëve kryesorë të përfshirë në siguri dhe organeve të shtetit, mundësojnë që t’i japin mbrojtje dhe avancim gruas në çdo formë dhe është koha që bashkërisht, si institucione lokale, por edhe si shoqëri civile dhe si qytetarë, të jemi të portokalltë këtyre 16 ditëve. Kjo nuk përfundon normalisht vetëm në këto 16 ditë, por duhet të vazhdoj gjatë gjithë

vitit duke u angazhuar dhe punuar që ashtu siç jemi njerëz të butë në mbrojtje të femrës në të drejtat e saj barabartë me burrat, të punojmë që dhunën në familje, bashkërisht ta kthejmë në pikën zero”, ka thënë kryetari Haziri. Kryetari Haziri, ka përmendur edhe raste konkrete të grave të fuqishme ku pikërisht janë ato në krye të familjeve. “Sot janë bërë me shtëpi dy familje me jetimë, ku personi kryesor dhe i vetëm që kujdeset për rritjen e fëmijëve, është gruaja. Ato nuk dorëzohen në rrugën e tyre për edukim dhe rritje të fëmijëve”. Gjithashtu, gjatë kësaj jave do të shpallet qytetare nderi një grua e fuqishme, e cila përkundër faktit se burri i është vrarë gjatë luftës, ajo ka vazhduar jetën dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve”, ka thënë ai. Ndërsa, Kryesuesja Bunjaku – Rexhepi ka thënë se Anamorava dhe në veçanti Gjilani, kanë njerëz të ndershëm dhe të butë për nga natyra. “Në Gjilan njerëzit janë të butë dhe të ndershëm dhe problemet e dhunës në familje kryesisht nuk janë shumë të theksuara. Hapësira, mundësitë dhe kushtet ekzistojnë tashmë, duhet vetëm angazhim, ngase mbështetja është e sigurt”, ka thënë Bunjaku – Rexhepi.



Haziri e cilëson historike vizitën e ambasadorit izraelit në Gjilan

25

NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në një takim ambasadorin e Izraelit në Beograd, Yossi Levi, me të cilin ka biseduar për dialogun Kosovë – Serbi, për kulturën, traditat, bashkëjetesën e komuniteteve dhe tolerancën ndërfetare, si vlera të larta të demokracisë dhe rrugës për përmirësimin e marrëdhënieve ndërshtetërore të Kosovës me shtetet fqinje. Me këtë rast, kryetari Haziri ka thënë se ambasadorin e Izraelit e ka informuar për Gjilanin në përgjithësi. “Është nder i veçantë që sot në Gjilan kemi në një vizitë historike, për herë të parë një zyrtar të lartë, ambasadorin e Izraelit, i cili viziton Komunën e Gjilanit dhe qytetarët e saj. I kam dhënë informacione ambasadorit për Gjilanin, Anamoravën, për traditat, për bashkëjetesën, kulturën etj. Gjilani ka pasur një komunitet hebre, i cili ka qenë jashtëzakonisht i integruar dhe kontributdhënës në Gjilan dhe varrezat e qytetit janë të përbashkëta, për dallim nga të tjerët, ku në shumë raste,

ato janë të ndara. Pjesa e varrezave hebreje do të jetë në vazhdimësi nën kujdesin e Komunës”, ka thënë ndër të tjera Haziri. Kurse, ambasadori i Izraelit në Beograd, Yossi Levi, ka thënë se Gjilani është qytet i bukurive të shumta historike, sikur që në vete ka një histori shumë të pasur. Ndërkaq dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, ambasadori Levi, e ka vlerësuar shumë të mirë dhe të domosdoshëm për një të ardhme të sigurt. “Edhe shteti i Izraelit kishte probleme të natyrës së njëjtë me Kosovën, para më shumë se 6 dekadave. Mendoj se ajo që po bëhet me dialogun Kosovë-Serbi, është shembull i mirë i lëvizjes drejt zgjidhjes së problemeve. Dialogu përherë është perspektivë e një ardhmërie më të mirë për qytetarët e një vendi. Dialogu është nevojë për zgjidhjen e problemeve dhe hapjen e rrugës për zhvillim. Është hap shumë i rëndësishëm që pala kosovare dhe ajo serbe po bëjnë në këtë drejtim, për të mirën e qytetarëve të tyre”, u shpreh ambasadori Levi.



Apel qytetarëve që t`i paguajnë borxhet dhe të përfitojnë nga amnistia

25
NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri i shoqëruar edhe nga Task Forca për grumbullimin e borxheve, së bashku me drejtorin e Financave, kanë bërë publike detajet e fazës së parë për faljen e borxheve të tatimit në pronë. Me këtë rast kryetari Haziri, ka thënë se prej rreth 9 milionë eurove që janë borxhe ndaj Komunës, mbi 5 milionë do t`u falen qytetarëve, por me kusht që të kryhet pagesa e borxhit nga viti 2009 deri më 2014. Ai i ka ftuar qytetarët dhe bizneset që të përfitojnë nga ky ligj. Haziri tha se e ka suspenduar një vendim të ish-kryetarit, ku parashihej pagesa prej 50 për qind e obligimeve, si kushtëzim i pjesshëm. “Suspendimi i këtij vendimi nënkupton që tash e tutje iu nënshtrohemi rregullave të amnistisë së borxheve”,

ka thënë kryetari Haziri. Në rast se qytetarët hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me Komunën, atyre u falen edhe ndëshkimet dhe kamatat, të cilat i kanë specifikat e veta. Ndërsa, drejtori i Financave, Zijadin Maliqi, ka thënë se janë dy forma të përfitimit nga falja e borxheve. Forma e parë është pagesa e përnjëhershme dhe e dyta, është marrëveshja kontraktuale me Komunën, ku personat fizikë mund të bëjnë pagesën deri në 18 këste, ndërsa personat juridikë deri në 12 këste. Në rast se pala nënshkruan marrëveshje, por nuk i përmbahet, atëherë gjendja kthehet në fillim. Borxhi i përgjithshëm është 8 milionë e 470 mijë euro. Sipas ligjit, falen 5 milionë e 570 mijë euro, kurse mbeten për arkëtim 2 milionë e 900 mijë euro.



Ambasadorja Kiliç: Gjilani është shembull për Europën në multikulturalizëm e multietnicitet

25
NËNTOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri me bashkëpunëtorët, ka pritur sot në takim ambasadorën e Turqisë në Kosovë, Kivilcim Kiliç, të cilën e ka njoftuar për bashkëjetesën tradicionale të bashkëjetesës dhe bashkëpunimit të kulturave të përbashkëta dhe të nevojës që ta vazhdohet me këtë shembull të mirë të ruajtjes së këtyre vlerave për të ardhmen e Komunës së Gjilanit. “Është një nderë i veçantë që sot e takova ambasadorën, Kivilcim Kiliç. Prezenca turke në Gjilan është në tri nivele; diplomatik, ushtarak dhe niveli i tretë është ai i mbështetjes financiare që është agjenci shtetërore “Tika”. Pres restaurimin dhe renovimin e objekteve të trashëgimisë kulturore siç është xhamia “Atik”, e cila daton që nga viti 1605. “Tika” ka hyrë në programe bujqësore në bashkëfinancim me Komunën dhe në arsim në ndërtimin e çerdhës së fëmijëve në lagjen “Arbëria”. E falënderoj ambasadorën dhe shtetin turk për mbështetjen e vazh-

dueshme”, tha kryetari Haziri. Ndërkaq, ambasadorja e Turqisë në Republikën e Kosovës, Kivilcim Kiliç, pasi e ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen, ka thënë se ky i fundit është shembull për Europën që po e vazhdon traditën e multikulturalizmit dhe multietnicitetit. “Ndihejm krenare që gjendet sot në Komunën e Gjilanit. Kam vizituar shoqatën “Fidan” dhe “Gilan”. E falënderova kryetarin Haziri që po e vazhdon një traditë që është shembull jo vetëm për Ballkanin, por edhe për Europën, pra shembulli i multikulturalizmit dhe multietnicitetit. Këtë harmoni dhe bashkëjetesë e kemi parë edhe kur kemi vizituar shkollën dhe shoqatat tjera. Ne e shohim si pasuri të madhe mbrojtjen e kësaj kulture”, ka deklaruar para gazetarëve ambasadorja Kiliç. Ajo është shprehur se marrëdhëniet mes Turqisë dhe Kosovës në çdo aspekt janë special, duke konfirmuar se “do të vazhdojmë ta japim kontributin për Kosovën, sikur që kemi bërë deri më tash”.



Çështja e pazgjidhur e Kosovës Lindore rëndon mbi Gjilanin

26
NËNTOR

Në prag të festave të nëntorit, kryetarët e dy komunave me shumicë shqiptare në Kosovën Lindore, Nagip Arifi - kryetar i Bujanocit dhe Ragmi Mustafa - kryetar i Presheves së bashku edhe me Jonuz Musliun - kryetar i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginë, kanë qëndruar sot në mbrëmje në Gjilan për një takim pune, ku janë pritur nga kreu i Komunës, Lutfi Haziri. Takimi ishte ftuar nga Faton Bislimi, përfaqësues për Ballkan i Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane për të diskutuar vazhdimin e punës së përbashkët për të ngritur çështjen e Kosovës Lindore në nivel sa më të lartë në agjendën e politikës së jashtme amerikane. Në takim u diskutuan aktivitetet e fundit që janë bërë në Washington, DC për çështjen e Luginës si dhe hapat që do të merren më tutje. Kryetari Haziri tha me këtë rast se çështja e pazgjidhur shqiptare e Kosovës Lindore vazhdon të rëndojë Kosovën dhe veçanërisht Gjilanin ku jetojnë mijëra shqiptarë të Kosovës Lindore. Kryetari Haziri dhe kryetarët e Kosovës Lindore u da-

korduan që të vazhdojnë përpjekjet e përbashkëta për të sjellur paqe, barazi, dhe mundësi për prosperitet për shqiptarët në Luginë si masa imediate që do të lehtësojnë situatën atje. Poashtu, theks i posaqëm u vu edhe në çështjen e bllokimit të librave shqip në terminalin doganor Dheu i Bardhë, ku së fundi, nën organizimin e Këshillit Kombëtar Shqiptar janë mbajtur edhe protesta paqësore në Bujanoc. Në këtë takim kryetari i Gjilanit është nderuar me mirënjohje nga Jonuz Musliu - kryetar i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginë, për kontributin e tij të jashtëzakonshëm për zgjidhjen problemeve të shqiptarëve të Kosovës Lindore. Ndryshe, në shtator të këtij viti, kryetarët e Presheves dhe Bujanocit kishin qëndruar për vizitë zyrtare disa ditore në SHBA, ku kishin patur takime të ndryshme me zyrtarë të Departamentit të Shtetit si dhe Kongresit të SHBA-ve. Paraprakisht, në korrik 2015, në Washington, DC për çështjen e Kosovës Lindore kishte diskutuar edhe kryetari Haziri gjatë vizitës së tij atje.



Haziri: 28 Nëntori – ditë krenarie, dhembje dhe nderimi për ata që u sakrifikuan për liri

28
NËNTORI

Me rastin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit dhe shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, ka urren qytetarët. Në mesazhin e urimit thuhet: “Të dashur qytetarë të Gjilanit, më lejoni që në emrin tim personal dhe të të gjitha institucioneve të Komunës së Gjilanit, t’ju urren nga zemra Festat e Nëntorit, shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe Ditën e Flamurit”. Në këtë ditë të shënuar për kombin tonë, ne respektojmë e nderojmë dëshmorët tanë si Mulla Idriz Gjilanin, Idriz Seferin, Agim Ramadanin, Zenel Hajdinin, Abdullah

Preshevën, Musa Zajmin, e shumë dëshmorë e martirë të tjerë, të cilët sakrifikuan gjënë më të shtrenjtë për të mirën e përgjithshme. Në këtë ditë, po ashtu, kujtojmë me dhimbje 70- vjetorin e masakrës së madhe të Gjilanit dhe ekspeditës ndëshkuese për shkak të përpjekjeve të luftës për liri, ku u masakruan mbi 8000 qytetarë, ose gjysma e popullatës së atëhershme. Është dhimbje dhe përkulje e madhe për të gjithë këta dëshmorë, martirë dhe njerëz që vuajtën, por asnjëherë nuk u ndalën në përpjekjet e tyre për liri”, thuhet në mesazhin e urimit të kryetarit Haziri.



Përrurohet kompleksi i dëshmorëve në Gjilan

28
NËNTOR

Si asnjëherë më parë, në varrezat e dëshmorëve në Gjilan kanë marrë pjesë numër rekord i qytetarëve të Gjilanit, duke filluar nga kryetari Lutfi Haziri, partitë politike, deputetë, përfaqësues të institucioneve të sigurisë dhe familjet e dëshmorëve, në inaugurimin e projektit të kompleksit të dëshmorëve, i cili është realizuar nga buxheti i Komunës së Gjilanit. Kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, tha se ndjehet i nderuar që pikërisht në ditën e flamurit, më 28 nëntor, po inauguruhet faza e parafundit e këtij projekti të rëndësishëm. “Jemi të nderuar që përfundimisht një pjesë të punës sonë, një pjesë të amanetit tonë dhe një pjesë të kërkesës së qytetarëve ta realizojmë në ditën e shenjtë të flamurit, në ditën e madhe të lirisë së shqiptarëve, atëherë kur të gjithë ne iu bashkuam luftës së madhe për t’u çliruar dhe vazhduam të punojmë, edhe pse 103 vite pas saj, edhe më shumë duhet të bëjmë përpjekje që t’i realizojmë idealet, qëllimet mbi të gjitha amanetin

e dëshmorëve”, u shpreh Haziri. “Ne sot jemi shumë të vegjël para këtyre dëshmorëve. Ata rrugën e tyre e kanë zgjedhur në ditën e rënies për liri. Ne sot të gjallët, 15 vjet pasluftës në Gjilan duhet ta pranojmë që jemi vonuar shumë për t’i qetësuar të gjallët, familjarët e dëshmorëve, sepse qetësia e tyre ka ndodhur edhe në rënie. Të gjithë ne që i kemi njohur dhe kemi punuar e bashkëpunuar, jemi më të çliruar në këtë ditë, në mënyrë që vërtetë të vazhdojmë t’i realizojmë ato amanete dhe ato qëllime që dëshmorët i kanë lënë. Kodra e Dëshmorëve është emëruar me gjakun e dëshmorëve. Kodra e Dëshmorëve sot është kodra e heronjve, kodra e viktimave, kodra e burrave dhe grave të regjionit tonë, që në përpjekjet shekullore për liri kanë gjakuar”, ka thënë Haziri. Një fjalë rasti patën edhe Ahmet Isufi, ish-komandant i Zonës Operative të Karadakut dhe Ahmet Daku, kryetar i OVL të UÇK-së për Gjilan, të cilët realizimin e këtij projekti e vlerësuan lart.



Haziri: Hanife Malaj s'është vetëm nëna e Fitores, por është nënë dhe simbol i fitoreve të mëdha të shqiptarëve

27
Nëntor

Hanife Malajt, bashkëshortes së heroit kombëtar Rexhep Malaj, i është dorëzuar sot çmimi “Qytetar Nderi”. Vendimin për këtë çmim e ka marrë Kuvendi Komunal i Gjilanit, më datë 29.09.2015, me motivacionin “për avancimin e vlerave njerëzore, për humanizëm dhe sakrificë në ruajtjen dhe ndërtimin e familjes”. Çmim ia dorëzuan zonjës Malaj kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri dhe kryesuesja, Valentina Bunjaku Rexhepi. “Kjo grua, gjatë gjithë historisë, me dinjitet dhe fisnikëri të lartë, gjithmonë ka mbajtur lart flamurin e qëndresës dhe të familjes. Ajo, gjatë gjithë historisë, arriti të mbrojë popullin nga asimilimi, duke ruajtur njëkohësisht gjuhën, traditën, kulturën dhe familjen. Në rrethanat më të papërshtatshme historike, Hanifja u inkuadrua në rrjedhat që imponoi faktori kohë”, ka thënë me këtë rast kryesuesja Bunjaku-Rexhepi. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, tha se zonja Hanife nuk është vetëm nëna e Fitores, por është nënë dhe simbol i fitoreve të mëdha. “Jam i nderuar që Kuvendi i Komunës, me konsensus e ka miratuar ndarjen e një çmimi të vogël

për zonjën Hanife, që për ne është çmim shumë i madh, sepse po nderojmë një njeri të gjallë, një zonjë, një nënë dhe një grua që fuqishëm qëndroi, jo prapa bashkëshortit dhe udhëheqësit të çeliktë që e cilësonin shokët e tij, por qëndroi prapa heroit të shqiptarëve, Rexhep Malaj. Zonja Hanife i ka të gjitha atributet. Sot duhet t'ia japim edhe një atribut që Rexhep Malaj ia ka lënë. Ajo është nëna e Fitores, jo vetëm e kësaj që është pasardhëse e denjë, por është nëna e fitoreve të mëdha që pushka e Rexhep Malës, në vitet 80-ta ka bërë jehonë. Zonja Hanife është simboli i fitoreve të mëdha në Gjilan, në Kosovë dhe kudo ku janë shqiptarët”, ka thënë Haziri. Hanife Malaj e ka falënderuar Komunën e Gjilanit për këtë çmim, duke thënë se “ndihem shumë e nderuar, por nderi i takon të gjitha atyre nënave, motrave e vëllezërve që sakrifkuan me shekuj për lirinë e vendit tonë”. Mehmet Hajrizi, veprimtar i çështjes kombëtare dhe mik i familjes Malaj, tha se Hanifja meriton të nderohet për përkushtimin e saj jetësor, për veprimtarisë revolucionare të shoqit të saj, heroit Rexhep Malaj dhe ndaj familjes së saj.

Me titullin “Qytetar Nderi” nderohet edhe Rexhep Berisha



28

NËNTOR

Komuna e Gjilanit, në një seancë solemne të Kuvendit të Komunës, i ka ndarë titullin “Qytetar Nderi” Rexhep Berishës, babait të heroit Nuhi Berisha, duke e vlerësuar atë si një personalitet që i bënë nder jo vetëm familjes dhe Gjilanit, por gjithë Kosovës. Me këtë rast, kryesuesja e Kuvendit të Komunës, Valentina Bunjaku – Rexhepi, ka thënë se sot për Gjilanin, 28 Nëntori është ditë e veçantë, edhe për arsyen se Komuna ndan titullin “Qytetar Nderi” për babanë e heroit Nuhi Berisha. “Sot, në 103-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, në ditën e flamurit kombëtar, Komuna e Gjilanit ndan titullin “Qytetar Nderi” për Rexhep Berishën, i cili është simbol i qëndresës dhe krenarisë në rrugëtimin e gjatë patriotik e kombëtar. Këtë rrugëtim dhe sfidë në të njëjtën kohë, baca Rexhë, ka ditur ta kthej në frymëzim edhe për të tjerët, deri në fitore. Burrat si Rexhep Berisha i nevojiten përherë popullit, në mënyrë që të mos përulet asnjëherë para pushtuesve”, ka thënë ajo. Titulli “Qytetar Nderi”, Berishës i është dhënë me motivacionin për avancim të vlerave njerëzore, për humanizëm e sakrificë dhe si simbol i qëndresës kombëtare. Ndërsa kryetari, Lutfi Haziri, ka thënë se Kuvendi i Komunës ndan sot një çmim të vogël për bacën Rexhë, që është shtylla e familjes së tij shumë të madhe për Gjilanin, Kosovën dhe shqiptarët, në përgjithësi. “Mundi, sakrifica dhe përballja me ato dekada të vështira që kjo familje ka kaluar, janë sot krenari për të gjithë ne. Nuhi Berisha, në ditën e rënies, kishte zgjedhur rrugën e tij. Ai me vetëdije të

plotë dhe në veprim së bashku edhe me Rexhep Malën, dhanë jehonën e madhe, në vitet e ’80-ta, atë kohë kur shqiptarët ishin të shtypur dhe pa të drejta të plota”, tha ai. “Dje, në nderimin me këtë çmim të zonjës Hanife, theksuam se ajo kishte gjendjen e vështirë, sepse edhe te babai i saj, në familjen Limani, po edhe te burri, në familjen Mala, meshkujt pothuajse të gjithë ishin nëpër burgje, mirëpo atë e mbajti ideali dhe amaneti i madh që ajo të jetë sinonim yni sot. Ndërsa, Rexhep Berisha, ishte njeri që ka edukuar jo vetëm familjen e tij, por të gjithë neve përmes fjalëve e këshillave të mira, kudo që e kemi takuar. Ndjehe shumë i lumtur që arritëm që për së gjalli të ndajmë këtë titull për juve, sepse ky është titull në emër të të gjithë qytetarëve të Gjilanit. Nga sot ju jeni babai dhe gjyshi i gjithë familjeve dhe njerëzve të mirë shqiptarë të Gjilanit, sikur që zonja Hanife Mala, është nëna dhe motra jonë po ashtu”, ka thënë kryetari Haziri. Shukrie Gashi, bashkëveprimtare e Nuhi Berishës, ka thënë se çmimi nuk është një nder vetëm për familjet Malaj e Berisha, nuk është nder vetëm për ata, por është nder i madh fillimisht për Gjilanin dhe pastaj edhe për Kosovën. “Dy familjet Mala dhe Berisha ishin ato që i dhanë Kosovës bijtë, të cilët iniciuan themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe lirisë të cilën ne po e gëzojmë sot. Rexhep Malaj dhe Nuhi Berisha ishin bashkë përherë, deri në rënien e tyre heroike. Të tillë duhet të jemi edhe ne të gjallët, përherë bashkë në shërbim të vendit”, ka thënë ndër të tjera Gashi.



Në Gjilan defilohet me pajton dhe këngë për 28 Nëntorin

27
NËNTOR

Në Gjilan, festa e flamurit kombëtar, sivjet është kremtuar më ndryshe se zakonisht. Nëpër rrugët e qytetit kanë defiluar të rinj me veshje kombëtare, me pajton dhe këngë për 28 Nëntorin, që është një ngjarje e madhe historike për shqiptarët. Këtij vargu të ecjes nëpër qendrën e Gjilanit, iu bashkëngjiten edhe kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, drejtorë të drejtorive komunale, qytetarë të rastit. Fëmijët e Gjilanit, përmes koncertit “Dëbora”, kanë prezantuar këngë e valle në shënim të ditës së flamurit kombëtar. Me këtë rast të pranishmit, në Sallën e Teatrit të Qytetit i ka përshëndetur kryesuesja e Kuvendit të Komunës, Valentina Bunjaku – Rexhepi, e cila ka thënë se ky kjo ditë dhe këto gëzime do të ishin të pamundura pa sakrificën e madhe të shumë gjeneratave. “Historinë që ka përjetuar populli shqiptar, është ndër

më të dhimbshmet. Shqiptarët kanë dhënë shumë heronj, dëshmorë e martirë për lirinë që ne e gëzojmë sot”, ka thënë ajo. Ndryshe, aktivitetet në Gjilan kanë nisur me ndarjen e çmimit “Qytetar Nderi”, për Hanife Malaj dhe kanë vazhduar me koncertin e muzikës klasike, parakalimin nëpër qytet, për t’u mbyllur këtë ditë me koncertin e fëmijëve “Dëbora”. Ndërsa, gjatë ditës së nesërme, pikërisht me 28 Nëntor, do të përurohet projekti i Varrezave të Dëshmorëve, si dhe do të bëhet ndarja e çmimit “Qytetar Nderi”, për Rexhep Berishën, për të kulmuar me koncertin e madh festiv nga rok grupi “Jericho”. Pas dhënies së çmimit “Qytetar Nderi” për zonjën Hanife Malaj, nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, është mbajtur sot një akademi solemne për nder të festës të Ditës së Flamurit, përkatësisht koncert festiv.



30
NËNTOR

Kuvendi Komunal i Gjilanit, të enjten, në seancën e radhës për këtë vit, të drejtuar nga Valentina Bunjaku Rexhepi, kryesuese, pasi ka miratuar nismën e kryetarit të Komunës për ndarjen e 47 mijë eurove për Teatrin e Qytetit, ka diskutuar edhe për ndërtimet pa leje. Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri ka thënë se Teatrit të Qytetit do t'i ndahen 47 mijë euro, deri në fund të dhjetorit, si zgjidhje për këtë vit, deri në gjetjen e një zgjidhje tjetër, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës. Këto mjete vijnë nga vija buxhetore e Zyrës së kryetarit të Komunës dhe do t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet deri më 31 dhjetor 2015, përmes zbatimit të procedurave ligjore, ka thënë kryetari Haziri. Gjendja në Teatër, sikurse edhe çështja e ndërtimeve, u diskutuan në këtë seancë me kërkesën e opozitës, pika këto për të cilat ishin dakorduar në Komitetin për Politikë dhe Financa edhe partnerët e koalicionit qeverisës. Kuvendi Komunal ka diskutuar me tone mospajtuese rreth ndërtimeve në Gjilan, pas informatës që ka prezantuar drejtori i Urbanizimit, Valon Shefkui. Shefkui ka thënë se të hyrat e kësaj periudhe të vitit arrijnë mbi 660 mijë euro, gjë nuk kanë qenë asnjëherë më të mëdha, ndërkohë që duke folur për akuzat e opozitës, ka shtuar se për moral nuk mund të flasin ata që ka ndërtuar vetë pa leje. Riad Rashiti, në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së ka kërkuar formimin e një komisioni komunal, i cili do të kryesohet nga opozita (VV), për të bërë vlerësimin e gjendjes në sektorin e ndërtimeve dhe për t'i dhënë rekomandimet e veta. Nevzad Isufi (VV) tha se ndërtimet me leje nuk duhet të ndalohen, por kërkoi që të mos lejohet cenimi i planeve urbane. Pas një debati të gjerë ku morën pjesë edhe Bujar Nevzati (PDK), Avdyl Aliu, Isa Agushi (LDK), Sahit Abazi (PDK), Nevzad Rushiti (LDK), Rexhep Kadriu, nënkryetar i Komunës (AAK) dhe të tjerë, që në disa momente u përshkua edhe me akuza personale, kryesuesja e Kuvendit Komunal e qiti në votim propozimin e opozitës për formimin e komisionit, por ky propozim nuk mori përkrahje të mjaftueshme. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, ka thënë se kjo çështje zgjidhet në përputhje me ligjin dhe rregullore e jo me zhurmë e piskama. Ai ka thënë se në Gjilan nuk ka listë të ndërtuesve të rinj, që

Haziri: Çdo ndërtim i paligjshëm do të trajtohet me të njëjtin standard

kanë ardhur në kohën e kësaj qeverisje, por janë po ata që kanë qenë edhe më përpara. Por ai i ka siguruar këshilltarët komunalë se çdo ndërtim i paligjshëm do të trajtohet me të njëjtin standard, sikurse do të trajtohet edhe "Fidanishtja" si dhe rastet tjera që i përkasin periudhës së qeverisjes së kaluar dhe do të procedohen në prokurori. Në procedurën e rrënimave, do të trajtohen njësoj si një objekt njëkatësh, po ashtu edhe ai dhjetë katesh, ka thënë Haziri. Sa iu përket ndërtimeve në pronat private, Haziri ka thënë se ato nuk mund t'i ndalojë përderisa janë në përputhje me ligjin, por është shprehur i vendosur se nuk do të lejojë ndërtime afariste dhe banesore në pronën komunale, siç ka ndodhur në të kaluarën. Haziri i ka nxitur këshilltarët komunalë që ta denoncojnë në prokurori çdo rast që mendojnë se kanë fakte, duke përfshirë edhe atë, nëse, siç ka thënë ai, i kam legalizuar diku qoftë edhe një metër katror të ndërtuar në mënyrë të paligjshme. "Kompromis me ligjin nuk do të ketë", ka thënë ai. Kryetari Haziri tha se personalisht ka vizituar raste në terren, për të cilat është folur në qytet se po ndërtohen pa leje, por nuk kanë rezultuar ashtu. Edhe Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, kërkoi nga opozita që t'i paraqesin rastet nëse kanë fakte, duke i rikujtuar atyre se kështu mund të fitojnë edhe shpërblimin e Komunës prej 2 mijë euro, për lajmërim të korrupsionit dhe abuzimeve ligjore nga zyrtarët komunalë. Në një sqarim të shkurtër, Valon Shefkui, drejtor i Urbanizimit, ka thënë se të gjitha rastet që u përmenden nga opozita si ndërtime pa leje, në të vërtetë kanë leje. Përndryshe, Kuvendi Komunal ka miratuar edhe rregulloren për kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale, planin strategjik lokal për trajtimin dhe parandalimin e korrupsionit, planin lokal të veprimit për ri-integrim, vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit Komunal si dhe rekomandimin për riorganizimin e komiteteve. Në pikën nën të ndryshme, kryetari i Komunës, është përgjigjur në të gjitha pyetjet e këshilltarëve komunalë, kryesisht të opozitës, duke thënë se investimet e vitit 2016, në Gjilan, do të jenë për herë të parë më të mëdha se buxheti i Komunës, që është rreth 22 milionë euro.



Haziri emëron Faton Bislimin koordinator për politika rajonale

01

DHJETOR

Pas emërimit për koordinator të politikave dhe marrëdhënieve rajonale, kryetari Lutfi Haziri i ka dëshiruar mirëseardhje në këtë detyrë Faton Bislimit. Në këtë pozitë, Bislimi do të punojë ngusht me kryetarin Haziri dhe kabinetin e tij për të zhvilluar më tutje marrëdhëniet e Komunës së Gjilanit me donatorë e partnerë rajonalë e ndërkombëtarë, për të sjellë në Gjilan sa më shumë projekte zhvillimore e investive. Bislimi është arsimuar në shkollat më elitare në SHBA e Kanada, ku ka krijuar një përvojë të vlefshme në sferën e angazhimit akademik dhe ku ka krijuar lidhje e miqësi të veçanta në këto vende mike të Kosovës. “Ne kemi

një plan për zhvillim të mëtutjeshëm të kapaciteteve tona në Komunën e Gjilanit si dhe për atraktivitet të sa më shumë investimeve e projekteve ndërkombëtare këtu. Me bashkëpunëtorë si Fatoni, ne do ta bëjmë Gjilanin qendër të zhvillimit për të gjithë rajonin e trekëndësisht kufitar”, ka thënë Haziri. Kurse Bislimi mendon se shembullin e tij mund ta ndjekin edhe të tjerët. “Në një kohë kur nga vendi ynë ikin shumë qytetarë, kthimi im është sakrificë dhe besim në atdhe. Unë i jam shumë mirënjohës kryetarit Haziri për mundësinë e dhënë dhe i besoj vizionit që ai ka për të ardhmen”, ka deklaruar Bislimi.



Vizita e Hazirit në Kanada

19

DHJETOR

19 dhjetor 2015 / Kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i është bërë pritje e jashtëzakonshme në Kanada. Në Lethbridge, Haziri u mirëprit në një drekë pune nga Harold Pereverseff, president i “Lethbridge Twinning Society” (Shoqatës së Binjakëzimit të Lethbridge-it), ish-kryetari i Lethbridge-it, Robert Terleck, si dhe dy nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Shoqatës së Binjakëzimit, Kim Sievers, dhe Terri Demarchant. Gjatë këtij takimi, Haziri u njoftua me gjerësisht me rolin dhe funksionet e shoqatës si dhe interesimin e tyre për të zgjeruar bashkëpunimin edhe me qytete në Evropë, e veçanërisht me Gjilanin. Shoqata, përveç se ndihmon në procesin e binjakëzimit të qyteteve, ajo po ashtu organizon një sërë aktiviteteve kulturore e arsimore që ndërlidhin komunitetet e qyteteve të binjakëzuara. Kryetari Haziri shprehu gatishmërinë dhe interesimin e Komunës së Gjilanit për t’u bërë qyteti i parë në Europë me të cilin do të binjakëzohej Lethbridge, një qytet me popullsi të barabartë për nga numri me Gjilanin. Pasdite, Haziri u prit në një takim shumë miqësor edhe nga kryetari i Lethbridge-it, z. Chris Spearman, me të cilin u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit në mes dy komunave si dhe modalitetet e binjakëzimit potencial. Kryetari Spearman u shpreh shumë i interesuar për të gjetur të gjitha hapësirat e mundshme për bashkëpunim me Komunën e Gjilanit si dhe për të krijuar lidhje të fuqishme kulturore e arsimore, por edhe të biznesit në mes dy komuniteteve të këtyre komunave – Lethbridge dhe Gjilan. “Ne jemi të impresionuar me pritjen kaq miqësore që kemi hasur kudo në Alberta të Kanadasë. I jemi mirënjohës Shoqatës së Binjakëzimit të Lethbridge-it të ud-

hëhequr nga z. Pereverseff për gjithë përkrahjen e dhënë, si dhe kryetarit Spearman për gatishmërinë e shprehur që të shqyrtojmë modalitetet më praktike të mundshme për binjakëzim të dy komunave tona”, ka thënë Haziri. Në ditën e parë të vizitës së tij zyrtare në Kanada, kryetari Haziri, është pritur nga kryetari i Edmontonit në Alberta të Kanadasë, Don Iveson. Në takim me kreun e kryeqytetit të Provincës së Alberta-s, kryetari Haziri shoqërohej edhe nga Faton Bislami, koordinator për politika dhe bashkëpunim rajonal. Kryetari Iveson, duke i dëshiruar mirëseardhje kryetarit Haziri në Edmonton dhe Alberta, i shprehi gatishmërinë e tij dhe të qytetit të Edmontonit për të gjetur mënyra të bashkëpunimit konkret në të ardhmen e afërt. Ndërsa, kryetari Haziri e njoftoi nikoqirin me gjendjen në Komunën e Gjilanit si dhe sferat ku ka nevojë për marrje të eksperiencave kanadeze, nga të cilat mund të përfitoj Gjilani. Në këtë kontekst, theks i veçantë iu vu bashkëpunimit në fushën e arsimit, më konkretisht shkëmbimit të nxënësve, mundësisë për të realizuar një program trajnues profesional nga Edmontoni për stafin e Komunës së Gjilanit, si dhe organizimit të një vizite zyrtare të z. Iveson, së bashku me një grup afëristësh nga Edmontoni, në Gjilan, vitin që vjen. “Bashkëpunimi me qytete të një vendi mik siç është Kanadaja na jep mundësi për realizim të shumë projekteve zhvillimore për komunën tonë dhe ne jemi shumë mirënjohës për ngrohtësinë dhe vullnetin e shprehur nga homologu im këtu në Edmonton, që të punojmë së bashku në këtë drejtim”, ka thënë Haziri, duke shtuar se do të ishte nder i veçantë që në një të ardhme jo të largët, Gjilani të bëhej nikoqir i vizitës së parë të kryetarit Iveson në Ballkan.

Haziri merr garanci nga qeveria e Alberta-s për investime në agrikulturë

Gjatë ditë së dytë të vizitës zyrtare në Kanada, Haziri pati një takim me drejtorin për Europë në Ministrinë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Albertës, Phil Burke, si dhe një takim tjetër me zëvendës presidenten për Programe Ndërkombëtare të Universitetit të Albertës, Britta Baron. Në takimin me z. Burke, kryetari Haziri u njoftua me prioritetet e Qeverisë së Albertës në lidhje me zhvillimin ekonomik dhe shoqëror si dhe mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Gjilanit dhe departamenteve përkatëse që merren me zhvillim ndërkombëtar të Qeverisë së Alberta-s. Ndër temat kyçe të diskutuara me z. Burke ishte edhe çështja e zhvillimit të agrikulturës dhe përfitimeve që Komuna dhe rajoni i Gjilanit mund të kenë nga Departamenti i Agrikulturës së Albertës. Burke shprehu gatishmërinë e Ministrisë së tij dhe Qeverisë së Alberta-s për të bashkëpunuar me kryetarin Haziri që në një të ardhme të afërt të krijohen lidhje ekonomike dhe tregtare në mes të sektorëve përkatës të tregut në Alberta dhe atyre në Gjilan e Kosovë. Ai po ashtu shprehu gatishmërinë e Ministrisë për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Albertës që në bashkëpunim me kryetarin Haziri të punojnë në përgatitjen dhe realizimin e një vizite me mision ekonomik e tregtar në Komunën e Gjilanit. “Sfida e zhvillimit ekonomik kërkon përkushtim multidimensional. Neve na duhen partnerë nëpër botë, e sidomos nëpër vendet mike, siç është Kanadaja, për të realizuar projekte zhvillimore. Andaj, unë jam optimist që së bashku me miqtë tanë këtu, ne do të mund të bëjmë punë të hairit që na ndihmojnë në tejkalimin e kësaj sfide”, ka thënë Haziri. Ndërsa në takimin me zëvendës presidenten e Universitetit të Albertës, një prej universiteteve më të mira në botë dhe më të mëdhatë në Kanada, me rreth 38,000 studentë, është biseduar për mundësitë e bashkëpunimit në sferën akademike dhe universitare. Mirënjohje e veçantë u shpreh për Programin Ballkanik të Paqes, që realizohet në Gjilan, që nga viti 2012 dhe që njihet si shkollë verore akademike ndërkombëtarisht përmes Universitetit të Albertës. Udhëheqësi i këtij programi dhe njëherësh shoqëruesi i Kryetarit Haziri në këtë vizitë në Kanada, Faton Bislimi, paraqiti si kërkesë krijimin e mundësisë për realizimin e një programi veror këtu në Edmonton në kompleksin e Universitetit të Albertës për studentë të dalluar nga Gjilani. “Si qendër universitare, tanimë



Gjilani ka nevojë për ngritje të vazhdueshme të lidhjeve me institucione akademike ndërkombëtare. Shkëmbimet akademike janë shumë frytdhënëse. Ne tani kemi dhjetëra miq të Gjilanit nëpër botë përmes studentëve të huaj që ishin pjesë e Programit Ballkanik të Paqes këto vitet e fundit. Këto miqësi janë ura lidhëse në mes individëve, familjeve, shoqërive, por edhe kulturave e shteteve”, ka thënë kryetari Haziri. Nga ana e saj, znj. Baron siguroi kryetarin e Gjilanit se në bashkëpunim të ngushtë edhe me Bislimin, që ka kryer studimet e doktoratës në këtë universitet, do të gjejnë modalitetet e duhura të organizimit të shkëmbimit të studentëve gjilanas përmes një programi veror akademik që do të mbahet në Universitetin e Albertës. Gjatë qëndrimit në Lethbridge të Albertës, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri ka qenë edhe ligjërues nderi në tubimin e Shoqatës së Binjakëzimit të Lethbridge-it (Lethbridge Twinning Society). Gjatë fjalimi të tij, Haziri u fokusua në përvojën e Kosovës në tolerancën ndëretnike e ndërfetare. Ai potencoi se vetëm njerëzit e vullnetit të mirë, mund të bëjnë gjëra madhore. Në ditën e tretë të vizitës zyrtare në Alberta të Kanadasë, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka takuar kryetarin e Calgary, Naheed Nenshi, si dhe është pritur në një takim pune nga zëvendës presidentja e Agjencisë për Zhvillim Ekonomik të Calgary-it, Gillian McCormack dhe drejtoresha ekzekutive e Qendrës Globale të Biznesit, Bonnie Nunnari. Me kryetarin Nenshi u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit në mes dy qyteteve. Kryetari Haziri u sigurua nga kryetari Nenshi se ai dhe qeveria e tij janë të gatshme për të përkrahur ngritjen e kapaciteteve zhvillimore në Gjilan. Ndërsa, në takimin me znj. McCormack dhe znj. Nunnari u diskutuan përvojat e tyre në atraktivitetin e investimeve të huaja si dhe mënyrat e bashkëpunimit. “Ne jemi të gatshëm që të mësojmë nga praktikat më të mira e më të suksesshme ndërkombëtare të qasjes në zhvillim ekonomik lokal e rajonal dhe përvojat e marra nga autoritetet përkatëse në Calgary, janë të shkëlqyeshme”, ka thënë Haziri. Kreu i Gjilanit dhe përfaqësuesi i sektorit të zhvillimit ekonomik në Calgary, u pajtuan që Gjilani mund të kthehet në një qendër rajonale të zhvillimit ekonomik dhe për këtë do të përdoren edhe strategjitë e suksesshme të zbatuara në Calgary deri më tani.

Shpallet konkursi shpërblyes i “Flakës së Janarit 2016”

19
DHJETOR

Në Gjilan kanë filluar përgatitjet për manifestimin kulturor “Flaka e Janarit 2016”, që mbahet në nderim të heronjve, martirëve dhe dëshmorëve, të rënë në periudha të ndryshme historike, në rrugëtimin e gjatë për liri e mëvetësi kombëtare. Njësia për Kulturë, Rini e Sport ka shpallur konkursin shpërblyes tradicional në art letrar, pamor dhe dramatik, që përbëjnë shtyllat kryesore të këtij manifestimi unik, bashkë me artin muzikor dhe akademinë tematike të “Flakës...” Bashkim Nexhipi, udhëheqës i Task-Forcës për Kulturë, Rini dhe Sport, ka thënë se Komuna e Gjilanit e ka shpall konkursin tradicional letrar për tregim të shkurtër dhe poezi, me qëllim të nxitjes dhe avancimit të vlerave letrare në të gjitha trevat etnike dhe kudo tjetër ku jetojnë shqiptarët. Konkursi (anonim) do të jetë i hapur deri më 15 janar 2016. Punimet duhet të jenë të pa botuara. Ato dërgohen në tri kopje, të nënshkruar me shifër, në adresën: Komuna e Gjilanit, Njësia për Kulturë, Rini dhe Sport dhe në adresën elektronike: penafakes2016@gmail.com. Rezultatet e konkursit, si zakonisht do të shpallen në Orën e madhe letrare “Pena e Flakës”. Për tregim të shkurtër (deri në tri faqe), çmimi i parë ka

vlerën 250 euro, çmimi i dytë – 200, çmimi i tretë - 150 euro. Për poezi (deri në 50 vargje), çmimi i parë është 250 euro, çmimi i dytë - 200 dhe çmimi i tretë - 150 euro. Krijimet e shpërblyera dhe ato që sugjerohen nga juria profesionale, do të botohen në revistën letrare-kulturore AGMIA. Kurse për ekspozitën kolektive mbarëkombëtare, që do të hapet në Galerinë e Qytetit, mund të konkurrojnë të gjithë të interesuarit, me një vepër, përmasat e së cilës nuk duhet të jenë më të mëdha se 120 cm. Çmimi blerës për fondin e galerisë – është 500 euro. Tri çmimet tjera do të jenë në vlerë prej 150 euro. Punimet, jo më të vjetra se dy vite, teknikisht të përgatitura dhe të pa ekspozuara më parë, me tematikë të lirë, dorëzohen në Galerinë e Qytetit, gjatë orarit të punës, deri më 10 janar 2016. Të drejtë pjesëmarrje kanë të krijuesit e të gjitha zhanreve të artit pamor, nga të gjitha trojet etnike. Punimet e përzgjedhura do të botohen në katalog. Sa i përket artit dramatik “Talia e Flakës”, Nexhipi ka thënë se do të përzgjidhen pesë shfaqje teatrale, me përfaqësim nga trevat mbarëkombëtare. Risi e manifestimit “Flaka e Janarit 2016”, i 25-ti me radhë, do të jetë Festivali i filmit të shkurtër dhe i fotografisë.



Gjilani shpërndan mekanizëm bujqësor për 70 fermerë

22
DHJETOR

Komuna e Gjilanit, nëpërmjet Drejtorisë për Bujqësi, ka shpërndarë mekanizëm bujqësor për fermerë. Kryetari Lutfi Haziri, ka thënë se hero sot është ai që e punon tokën. “Ajo familje që e punon tokën, është familja më e pavarur që e ka sot Kosova”, ka thënë Haziri, ndërkohë që ka premtuar vazhdimin e mbështetjes për fermerët. Vitin e ardhshëm do të ketë rritje të buxhetit për bujqësi, në mënyrë që të forcohet sa më shumë familja gjilanasë. “Para më hallall se ato që jepen për bujqësi, nuk ka”, ka thënë ai. Një kulturë që do të fillojë të stimulohet në Gjilan, është ajo e duhanit, ku

ky regjion ka një traditë të gjatë, por që viteve të fundit është ndërprerë. “Vitin e ardhshëm po ashtu do ta rrisim edhe fondin për partnerët dhe fondin e brendshëm në mënyrë që t’ua ulim shpenzimet deri në zero dhe ju ato para t’i shpenzoni për të mira në familje”. Drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, ka thënë se nga ky projekt kanë përfituar 70 bujq, duke shtuar se Komuna ka aplikuar edhe për 70 të tjerë të “Tika” turke. Përndryshe, kësaj here janë shpërndarë 30 spërkatëse 440 litërshe, 10 rotofreza, 10 kositëse rotative, 10 grumbulluese të sanës dhe 10 pijatore me 24 disqe.



Bunjaku–Rexhepi: Raporti i KCIC-it është i mirë, por ka pasur vend edhe për pasqyrim pozitiv

23
DHJETOR

Në debatin e organizuar nga Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar, ku në panel të ftuar ishin kryesuesja e Kuvendit të Komunës, Valentina Bunjaku-Rexhepi dhe Riad Rashiti, nga opozita, të kryesuar nga Enver Kqiku, me një pjesëmarrje edhe të këshilltarëve komunalë që e përbëjnë komitetin për politikë dhe financa, drejtor të drejtorive komunale, shoqëria civile, mediat dhe studentë, është bërë prezantimi i raportit të monitorimit të Komunës së Gjilanit, respektivisht punës së Kuvendit të Komunës, KPF-së, por edhe ekzekutivit e me theks të veçantë përfshirja e publikut në vendimmarrje. Me këtë rast kryesuesja e Kuvendit, Bunjaku-Rexhepi, ka thënë se ky raport është një pasqyrë që edhe kuvendi, trupat e saj profesioniste, por edhe ekzekutivi me dikasteret e veta, ka vend për angazhim edhe më të madh në punën e përditshme, që bëhet që nga kërkesa e thjeshtë e një qytetari, e deri tek planifikimet vjetore apo edhe raportimet dhe takimet publike që organizohen. “Në Kuvendin e Komunës së Gjilanit ka standard të krijuar demokratik të organizimit të seancave, respektim të ligjit, duke u nisur nga ftesat e deri te aprovimi i akteve nënligjore nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokal. Në seancat e Kuvendit hapësira për të dhënë kontributin profesional e politik i jepet çdo këshilltari komunal. Po ashtu edhe informimi publik që do të mbahet një seancë e Kuvendit, bëhet në mediat lokale, ueb faqe dhe

njoftime të tjera të ndryshme, sikur që jemi të angazhuar maksimalisht të jemi transparent ndaj qytetarëve. Ajo që deri më tani është punuar në këtë drejtim ka qenë në funksion të zgjidhjes së problemeve të shumta që kanë qytetarët e Gjilanit”, ka thënë Bunjaku-Rexhepi. Ajo ka thënë se ky raport dhe raporte të tjera nga organizata të tjera, janë përherë kritikaa që pavarësisht pasqyrimit, pozitiv apo edhe rekomandimeve për përmirësim, janë shumë të vlefshme për institucionin, ngase ndikojnë në përmirësimin e planifikimit më të mirë në të ardhmen. “Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje, është shumë e rëndësishme në planifikimin e drejtë të prioriteteve për investime”, tha ajo. Kurse Riad Rashiti, këshilltar komunal (PDK), ka thënë se raporti si i tillë në vete përmban detaje konkrete për gjendjen ku janë institucionet komunale, trupat profesionale të Kuvendit, drejtoritë, zyrat e ndryshme, por edhe kabineti i kryetarit. Ai gjithashtu ka bërë kritika kryesisht në fushën e Kuvendit të Komunës, organizimit, materialeve, por edhe në fushën ekzekutive e me theks të veçantë në menaxhimin e parasë publike, sikur që nuk ka lënë pa përmendur edhe pjesëmarrjen e vogël të publikut në takime publike. Gjithashtu, kontributin e tyre e kanë dhënë edhe Avdyl Aliu (LDK), Nevzad Isufi (VV), pastaj Nevzad Rushiti, Bujar Nevzati, Fehmi Sylejmani, përfaqësuesja nga OSBE, studentë dhe zyrtarë të tjerë.



Haziri: S'ka ambasador dhe as ministër që s'ka ardhur në Gjilan

24
DHJETOR

Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, në një mbledhje të hapur dhe të drejtpërdrejtë në media, ka prezantuar punët që janë bërë gjatë vitit 2015 si dhe gjatë qeverisjes dyvjeçare. “Përkundër faktit se këto dy vite kanë qenë të rënda në kuptimin buxhetor, për shkak të problemeve të mëdha të trashëguara, megjithatë kemi arritur që të kryejmë punë të shumta në infrastrukturën publike dhe sektorët tjerë lokalë”, ka thënë Haziri. Ai me këtë rast ka falënderuar drejtorët për respektimin e dietës buxhetore, duke thënë se Gjilani është e vetmja Komunë në Republikën e Kosovës që ka vazhduar me këtë dinamikë. Haziri, po ashtu ka thënë se edhe në aspektin e sigurisë publike, Gjilani është shembull pozitiv, sepse për këto dy vjet, nuk ka pasur asnjë vdekje, si pasojë e akteve kriminale, apo të problemeve që lidhen me krim. Me punën dy vjeçare në të gjithë sektorët janë investuar miliona euro për t’ua bërë jetën më të mirë dhe më të lehtë qytetarëve të Gjilanit, duke qeverisur me duar të pastra e dyer të hapura për qytetarët, ka thënë kryetari Haziri. “Gjilani

është komunë me kalendar të programit të punës dhe aktiviteteve. Në kuadër të planit të punës kemi edhe dy aktivitete për këtë vit, është seanca e Kuvendit të Komunës që mbahet me datën 29 dhe debati me qytetarë që mbahet me datën 30 dhjetor. Nga java e ardhshme do të fillojmë caktimin e prioriteteve, sipas gjendjes në terren për t’u futur në programin e qeverisjes për vitin 2016 duke u përfshirë këtu të gjitha zyrat dhe drejtoritë”, ka thënë Haziri. Ai potencoi se në kuptimin buxhetor, Gjilani për herë të parë pas luftës është më i sigurt dhe pret që investimet në Gjilani të jenë më të mëdha se vet buxheti i Komunës në vitin e ardhshëm e që janë 22 milionë. “Mjetet e parapara për investime, do të ndahen sipas prioriteteve në shtyllën e arsimit, shëndetësisë, infrastrukturë urbane dhe rurale dhe prioritete të tjera në shërbim të qytetarëve”, ka thënë ai, duke potencuar se edhe një numër i madh i kërkesave të qytetarëve janë pjesë e punës për vitin e ardhshëm, ku përfshihen investime të rrugëve, ujësjellësit, kanalizimit, trotuareve dhe aspekte të tjera të arsyeshme për t’u trajtuar. “Falë angazhimeve tona të

përbashkëta, nuk ka asnjë ambasador apo ministër që nuk e ka vizituar Gjilanin, e që nuk i ka dhënë mbështetje të fuqishme në rrugën për ndryshim rrënjësor të kësaj Komune me ndikim dhe lidhje ndërshtetërore”, tha ai. Haziri, ka thënë se edhe në sektorin social do të vazhdojë me angazhime konkrete “deri sa të sjellim në pikën zero mungesën e kulmit mbi kokë për familjet gjilanasë”. Nga viti i ardhshëm do të nis edhe transporti humanitar për nxënësit që janë larg shkollave, për personat e moshuar apo personat e pambrojtur – pa familje. Në sektorin e investimeve, kryetari Haziri ka thënë se pos angazhimeve konkrete sipas planifikimit vjetor, do të nis puna në ndërtimin e tregut të gjelbër, do të punohet në gjetjen e një lokacioni të përshtatshëm për varrezat e qytetit, për trafikun urban, kinemanë e qytetit, teatrin dhe aspekte tjera jetike. Ndërsa, drejtori i Arsimit, Nazmi Musa, ka thënë se gjysmëvjetori i parë është përmbyllur me sukses dhe objektivat e drejtorisë për ngritje të cilësisë në arsim, po japin rezultate, sikur që edhe investimet kapitale janë në funksion të saj, kur merret parasysh që mbi 2.2 milionë euro janë investuar në infrastrukturën shkollore, kurse siç ka thënë ai gjatë vitit 2016, është planifikuar ndërtimi i çerdhes në lagjen “Dardania” që do të bëhet me USAID-in, pastaj çerdhja në shkollën “Abaz Ajeti”, tri salla sportive, ndërtimi i shkollës së Arteve, rregullimi i ngrohjes në sallën sportive të shkollës “Musa Zajmi” dhe në shkollën e fshatit Uglar. Në sektorin e drejtorinë e Shërbimeve Publike, drejtori Naser Korça, ka thënë se rezultatet në këtë fundvit në këtë fushë janë të mira, duke potencuar angazhimet konkrete në sa më shumë projekte që kanë të bëjnë me infrastrukturën publike. Ai po ashtu ka thënë se edhe projekti i mirëmbajtjes verore, rregullimit të trotuareve, të ujësjellësit, kanalizimit, ndriçimit publik dhe asfaltimeve të shumta anë e kënd Komunes janë pjesë e punës që gjatë tërë kohës është në funksion të përmirësimit të infrastrukturës publike. Ramiz Ramadani ka thënë se sektori i Bujqësisë karakterizohet me investime të shumta dhe aktivitete të pandërprera të cilat përkthehen përherë në zgjerim të veprimtarisë së fermerëve. Ai ka potencuar përfitimet e bujqve kryesisht në mbështetje të tyre nga subvencionet, grantet por edhe fushat ku janë mbështetur ata si në furnizim me atomizërë, farë misri, llaktofrizë, serra, dhe mekanizëm tjetër bujqësor, por edhe intervenim në hapjen e më shumë se 20 km rrugë të arave dhe shumë projekte të tjera që janë miliona euro të investuara. Edhe në sektorin e Kadastrës, drejtori Sadudin Berisha, ka thënë se punët kanë vazhduar me volum të shtuar të punëve duke potencuar që ka mbi 22 mijë lëndë që janë drejtuar këtij institucioni. Gjithashtu ai ka potencuar edhe incizimet e shumta të gjendjes që janë bërë në funksion të hapjes së rrugëve të reja, zgjerimit të tyre dhe punë të tjera që janë vendimtare

për zhvillim dhe ndërtimin e qytetit. Zijadin Maliqi, drejtor i Financave, ka thënë se në bazë të afateve ligjore janë respektuar të gjitha, duke nisur nga raportimi për vitin 2014, raportimet periodike, planifikimi i buxhetit për vitin e ardhshëm e deri tek angazhimi konkret i stafit të kësaj drejtorie në saktësimin e listave të faljes së borxheve ku janë amnistuar numër i madh i qytetarëve me rreth 7 milionë euro nga borxhi total që kishin ndaj Komunes. Në sektorin e sigurisë dhe emergjencave, Ensar Kadriu, ka thënë se shërbimi i zjarrfikjes dhe stafi tjetër, në çdo moment janë në funksion të krijimit të kushteve të sigurisë për qytetarë. Ai, gjithashtu ka informuar edhe për donacionet e pranuar në makineri të intervenimit për zjarrfikësit. Kurse, drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Nexhat Hajrullahu, ka thënë se shërbimet shëndetësore në nivelin primar, janë më të mirat deri më tani, duke marrë parasysh shërbimet, por edhe investimet që po bëhen në krijim të kushteve më të mira. Kurse në sektorin social, ai tha se deri më tani janë ndërtuar 24 shtëpi për familjet skamnore, por edhe përfitues të tjerë qoftë të meremetimit të shtëpive, apo edhe pagesat e qirave që numri arrin në 100 familje përfituese. Hajrullahu ka thënë se me sukses është kryer edhe projekti i dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit. Valon Shefkui, drejtor i Urbanizmit ka raportuar për punën që është duke u bërë në planifikim, hapje të rrugëve nëpër zonat e planifikuara siç është “Fidanishtja”, por sipas tij janë bërë të gjitha përgatitjet dhe së shpejti do të përfundohet edhe hapja e rrugëve në zonën “Monteith” dhe “Livadhet e Arapit”. Shefkui, po ashtu, ka bërë të ditur se edhe në sektorin e monitorimit të ndërtimeve është duke u bërë punë e madhe nga inspektorët e ndërtimit. Ndërkaq drejtori i Departamentit të Prokurimit, Salih Kqiku, ka thënë se të gjitha punët janë kryer sipas ligjit, duke zhvilluar procedurat e tenderimit sipas prioriteteve në rregullim të infrastrukturës publike, për çka, sipas tij, ky departament ka marrë edhe vlerësime pozitive nga OJQ të ndryshme. Kurse, Rexhep Kadriu, nënkryetar i Komunes së Gjilanit, ka thënë se kjo qeverisje dhe ky bord i drejtorëve kanë bërë punë të mëdha e të mira në shërbim të qytetarëve dhe jetës së tyre. Kadriu ka thënë se sot qytetarët e Gjilanit prekin projekte të ndryshme e të shumta në gjithë hapësirën e Komunes. “Falë angazhimeve dhe mbështetjes që kishim nga kryetari, asnjë investim nuk është kthyer prapa, por të gjitha janë këtu dhe të shfrytëzueshme përditë nga qytetarët gjilanas. Ndërtimet e shumta që po bëhen në Gjilan, kanë mundësuar që kësaj komune t’i kthejnë ndryshime të mëdha pozitive, por edhe të rrisin besimin e investorëve karshi institucioneve, po ashtu ne si Komunë kemi rritur edhe të hyrat nga kjo kategori, që përsëri u kthehen përmes investimeve publike”, tha Kadriu.



Lutfi Haziri: Nuk marrë pjesë në gara të pështymës!

29
DHJETOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në mbledhjen e sotme të Kuvendit Komunal të Gjilanit, të fundit për vitin 2015, ka vlerësuar se ky vit ka qenë i rëndësishëm, i suksesshëm, me plot sfida dhe është përcjellë me interesim nga qytetarët dhe nga këshilltarët komunal. Ai tha se ndihet krenar që Gjilani është shpallur Komuna me shpenzimet më të ulëta në Republikë. Ndërkaq, duke iu përgjigjur kritikave të opozitës, kreu i Gjilanit tha se “nuk merr pjesë në gara të pështymës”. “Temat që e kanë përcjellë Kuvendin nga janari, janë retorikë e njëjtë, insinuata, kualifikime që bazohen apo motivohen në prapavijë politike dhe jo në interes të qytetarëve. Unë i jap llogari qytetarëve, kurse raportin me Kuvend e kam të rregulluar me ligj. Jam krenar që unë jam zgjedhur me votë qytetare prej 60 për qind, ndërkaq nga dita e betimit i përfaqësoj qind për qind të qytetarëve. Për inate politike, disa vazhdojnë të njollosin, por unë ju kam treguar që në fillim se në lojën e pështymës nuk marrë pjesë. Nuk marrë pjesë në garat të tilla”, ka thënë Haziri. Në përgjigjen lidhur me informatat e fundit që “këshilltari komunal, Sergjan Mitroviç, është kryetar i Komunës paralele”, kreu i Gjilanit tha se nuk merret me fosile politike. “Unë jam i zgjedhur si kryetar me sistem të drejtpërdrejt dhe i jap llogari qytetarëve. Ndërsa raportin me Kuvendin e kam të rregulluar me ligj, sikurse që e kanë edhe këshilltarët dhe që duhet t’i përmbahen. Unë nuk merrem me fosile politike, me falanga e me ato pjesë të ndryshkura të Serbisë, pas

12 qershorit 1999 dhe këtë duhet ta vlerësojnë organet e shteti e jo kuvendet komunale”, tha Haziri. “Kolegu i juaj është zgjedhur nga lista e iniciativës qytetare, sipas ligjeve të Kosovës dhe i ka fituar votat. Ai sot është këtu duke përfaqësuar një pjesë të komunitetit pakicë, në një listë politike e cila është e ndarë nga lista serbe për Kosovën. Nëse i është bashkuar më vonë, është çështje e tij. Për mua është e papranueshme dhe e pa tolerueshme çdo lloj ndërhyrje e sistemit juridik të Serbisë brenda territorit të Kosovës dhe Komunës sonë. Do ta luftoj deri në fund që të paaftësohet dhe të paralizohet roli i tyre në jetën institucionale të Kosovës”, ka thënë Haziri. Ndërkohë, Haziri ka folur edhe për investimet e donatorëve. “Gjilani ka konkurruar që t’i marrë 12 milionë euro dhe jemi njëra nga dy komunat që jemi zgjedhur për të përfutur në trajtimin e ujërave të zeza, rregullimin e shtratit të lumit “Stanishorka”, pjesërisht të “Mirushës” dhe integrimin e sistemit të kanalizimeve në njëgjatësi prej 54 kilometrash”. Gjithashtu, kryetari Haziri ka informuar që nga marrëveshja e qeverisë me BERZH-in, Gjilani përfiton në masën prej 70 për qind të mjeteve. “Përderisa në Prishtinë thuhet që marrëveshja e BERZH-it, e nënshkruar dje nga qeveria, në masën 70 për qind është e destinuar për Gjilan, të zgjedhurit e Gjilanit e kundërshtojnë atë, në vend se të duartrokasin për marrjen e këtyre dy projekteve të mëdha, që janë dy korridore, Gjilan-Ferizaj dhe Gjilan-Prishtinë, të cilat në vitin e ardhshëm do të realizohen”, tha Haziri.



Kuvendi i Gjilanit e përjashton nga seanca këshilltarin Mitroviq, udhëheq strukturat paralele

29

DHJETOR

Gjilan, Kuvendi Komunal i Gjilanit, të mërkurën, në seancën e fundit për këtë vit, të cilën e ka drejtuar kryesuesja Valentina Bunjaku-Rexhepi, e ka përjashtuar nga mbledhja këshilltarin Srgjan Mitroviq, për shkak të emërimit të tij në krye të strukturave paralele të Serbisë dhe refuzimit që të deklarohet nëse i njeh institucionet dhe ligjet e Kosovës, sipas të cilave ai është zgjedhur anëtar i Kuvendit Komunal. Këtij vendimi i ka paraprirë një debat i gjerë i anëtarëve të Kuvendit, ku janë përfshirë Sahit Abazi (PDK), Selami Xhemajli (AAK), Nevzat Isufi (VV), Bujar Nevzati (PDK), Bajram Hasani (Nisma), Riad Rashiti (PDK), Fehmi Sylejmani (VV), Arben Mehmeti (LDK), Avdyli Aliu (LDK) dhe të tjerë, të cilët kanë thënë se Mitroviq nuk mund të jetë edhe në institucionet e Kosovës, edhe në strukturat paralele të Serbisë, të cilat e pengojnë integrimin e komunitetit serb dhe punojnë kundër interesave të Kosovës. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, duke u ndërlidhur me këtë rast, ka thënë se nuk merret me fosile politike. “Unë nuk merrem me fosile politike, me falanga e me ato pjesë të ndryshkura të Serbisë, që kanë ngelur në Kosovë pas 12 qershorit 1999. Këtë duhet ta vlerësojnë organet e shtetit dhe jo Kuvendet Komunale”, tha Haziri. Shumica e këshilltarëve komunalë e kanë kushtëzuar pjesëmarrjen në seancë nëse Mitroviq nuk sqarohet rreth këtij rasti, apo nuk largohet nga seanca. Pas dy pauzave, kryesuesja e Kuvendit Komunal, Valentina Bunjaku-Rexhepi, e cila i ka dhënë mbështetje kësaj kërkesë të këshilltarëve komunalë, sipas rregullores e ka nxjerrë në votim rastin e Srgjan Mitrovit dhe Kuvendi, me 29 vota për, ka vendosur përjashtimin e tij nga seanca. Valentina Bunjaku-Rexhepi ka thënë se do t’i drejtohen me shkrim MAPL-së, për të marrë përgjigje ligjore në lidhje me këtë rast, ku një anëtar i zgjedhur i Kuvendit Komunal, në të njëjtën kohë bëhet pjesë e strukturave paralele, madje kryetar i të ashtuquajturës Komunë e Gjilanit. Përndryshe, Kuvendi ka votuar për ndryshimin e pjesshëm të projektit të lumit Mirusha, pasi është njoftuar për dinamikën e deritashme të punimeve, ku ka ngecje që prej fillimit, shkak i shpronësimeve, terrenit të papërshtatshëm dhe mungesës së mjeteve. Rexhep Kadriu, nënkryetar i Komunës, ka thënë se kjo qeverisje është e interesuar që projektin e lumit Mirusha, të filluar në vitin 2009, ta përfundojë sa më

shpejt. Kadriu ka thënë se është kërkesë e qytetarëve, por edhe nevojë e gjendjes në terren, që projekti të ndryshohet pjesërisht dhe pjesa e lumit prej qendrës e deri te lagja Balec, të mbulohet. Me mbulimin e kësaj pjese krijohet një shëtitore për qytetarë dhe krijohen mundësi për hapjen e bizneseve të vogla në këtë zonë, gjë që do të ndihmojë zhvillimin ekonomik dhe punësimin, ka thënë Kadriu. Avdyli Aliu (LDK) ka thënë se e përkrahin ndryshimin, duke shtuar se edhe atëherë ka qenë kërkesë e qytetarëve që kjo pjesë të mbulohet, por në njëfarë mënyre është injoruar nga projektuesi. Në favor të revidimit të projektit janë deklaruar edhe Selami Xhemajli (AAK) e Ismet Hajdini (AKR). Meqë është interes i qytetarëve, atëherë duhet të përkrahet mbulimi i këtij segmenti, kanë thënë ata. Në favor të këtij ndryshimi janë deklaruar edhe Nevzat Rushiti e Arben Maliqi (LDK) e Bajram Hasani (Nisma). Opozita (PDK) ishte kundër ndryshimit të projektit. Ndryshimi është jologjor dhe po bëhet për interesa të ngushta, ka thënë Riad Rashiti (PDK), duke shtuar se ata do ta kundërshtojnë në procedura ligjore revidimin e projektit. Arsytet për këtë ndryshim të projektit, nuk ishin të mjaftueshme as për VV-në. Megjithatë Nevzat Isufi (VV), ka thënë se ne jemi për çfarëdo zgjidhje që merr parasysh interesat e përgjithshme. Kurse Fehmi Sylejmani (VV) ka kërkuar që të eliminohen dilemat e ngritura, para se të vendoset për ndryshimin e projektit. Përndryshe, Kuvendi Komunal e ka miratuar edhe rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale si dhe kërkesën për financimin e manifestimit “Flaka e Janarit 2016”. Shpresa Kurteshi, kryesuese e Komitetit për Kulturë, ka thënë se risi e “Flakës...2016” do të jetë festivali i filmit dhe i fotografisë. Bujar Nevzati (PDK) tha se projekti është i vonuar dhe i mangët dhe nuk u pajtua as me përbërjen e Këshillit organizativ. Leonora Bunjaku pati vërejtje të përfaqësimit gjinor në Këshillin organizativ. Fehmi Sylejmani (VV) tha se projekti duhet të rishikohet dhe ridizajnohet. Arben Maliqi (LDK) ka kërkuar që manifestimit t’i shtohet edhe pjesa sportive, kurse Sejduallah Kadriu kërkoi që “Flaka...” të shtrihet edhe në Kosovën Lindore, të paktën me ndonjë shfaqje apo pjesë muzikore. Kuvendarët e kanë miratuar edhe planin e punës së Kuvendit si dhe orarin e seancave të Kuvendit dhe të Komiteteve për vitin 2016, me disa vërejtje.

Gjilani mban takimin e dhjetë publik me qytetarë

30
DHJETOR

Gjilan, Nën organizimin e kryetarit të Komunës së Gjilanit, është mbajtur sot takimi publik me qytetarët, i dhjeti për dy vite të qeverisjes, në të cilin ka marrë pjesë edhe kryesuesja Valentina Bunjaku Rexhepi, nënkryetari Rexhep Kadriu dhe drejtorët komunalë. Në këtë takim ka marrë pjesë një numër rekord i qytetarëve, të cilët kanë shprehur interesimet e tyre në lidhje me infrastrukturën, arsimin, bujqësinë, shëndetësinë etj, ku kanë marrë përgjigje nga ana e kryetarit dhe bashkëpunëtorëve. Gjatë këtij viti, kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, tha se ka vazhduar të qeveris me duar të pastra, dyer të hapura për qytetarët dhe me një dietë të ashpër në shpenzime. “Nga kursimet në dreka e darka, subvencionet i kemi orientuar në kulturë, rini e sport dhe u kemi dalë në ndihmë këtyre tre sektorëve të rëndësishme”, ka thënë Haziri. Ai tha se Gjilani vazhdon të jetë në nivelin më të lartë të pagesës së tatimit në pronë, ku vetëm sivjet janë arkëtuar 600 mijë euro, ndërkaj janë falur mbi 5 milionë euro borxhe nga vitet e kaluara. Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri pohoi se edhe për këtë vit kanë arritur ta ulin vlerën e tatimit në pronë, duke thënë se “nuk duhet të ketë Komunë të pasur me qytetarë të varfër”. Haziri theksoi se Komuna e Gjilanit ka lidhur partneritete të rëndësishme me donatorë, të cilët kanë ndikuar dhe do të ndikojnë në përmirësimin e jetesës së qytetarëve. “Deri tash, Komuna ka qenë punëdhënësi më i madh, ndërkaj prej vitit të ardhshëm do të jetë qeveria e Austrisë. Nga nënshkrimi i marrëveshjeve me qeverinë e Kosovës, Gjilani përfiton 12 milionë euro, të cilat do të investohen në rregullimin e 54 kilometrave të rrjetit të kanalizimit, rregullimin e lumit Stanishorka si dhe përfundimin e projektit të lumit Mirusha. Nga donacionet e qeverisë së Zvicrës, Gjilani ka përfituar rreth 3 milionë euro në këtë vit, sikurse edhe nga partneriteti me Komisionin Europian, për ndërtimin e parkut në lagjen “Dardania”. Me USAID-in, për vitin e ardhshëm, është nënshkruar marrëveshja për ndërtimin e çerdhes në Dardani, kurse me



qeverinë turke do të ndërtohet çerdhja në lagjen Arbëria. Sa i përket shëndetësisë, Haziri potencoi se kanë arritur ta rehabilitojnë infrastrukturën në qendrat e mjekësisë familjare, duke paralajmëruar ndërtimin e objektit të ri të QKMF-së, në vitin 2016. Në bujqësi, Komuna, në bashkëpunim me donatorët, ka subvencionuar bujqit në shumën afro 2.5 milionë euro. “Synimi yni është që të arrijmë ta subvencionojmë edhe kulturën e duhanit dhe po punojmë që me ligj të trajtohet bima e duhanit sikur ajo e rrushit”, tha Haziri. Ndërkohë, kryetari Haziri konfirmoi se për vitin 2016 janë rritur investimet publike. Në bashkëfinancim me qeverinë e Kosovës dhe BERZH-in, do të ndërtohen hyrje-daljet e qytetit Gjilan-Prishtinë dhe Gjilan-Ferizaj. Haziri është shprehur se Komuna nuk ka krijuar asnjë borxh për dy vjet, por i ka shlyer borxhet e trashëguara. Për vitin 2016, Haziri tha se do të ndërtohet rruga Malishevë-Uglar-Pogragjë, sikur që pritet të hapet vendkalimi kufitar në Stançiq, për ta lidhur Gjilanin me Kumanovën. Po ashtu, vitin e ardhshëm pritet të nis ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza. Haziri ka falënderuar qytetarët dhe bashkatdhetarët për solidaritet në fondin për banim social, ku nga 11 shtëpi sa ishin premtuar në mbrëmjen humanitare, janë ndërtuar 24 shtëpi. “Sot do të nis ndërtimi i shtëpisë së 25-të, ndërsa 200 mijë euro i kemi rezervuar për rinovim të shtëpive dhe pagesën e qirave, sipas kërkesave të qytetarëve”, tha Haziri. Sa i përket kompleksit të shkollave të mesme, Haziri tha se do të ndërtohet në vitin e ardhshëm, ndërkaj në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit pritet të nis edhe kompleksi universitar në vendin ku tani është FSK-ja. Në fund, kryetari Haziri ka falënderuar qytetarët për pyetjet, kërkesat, rekomandimet dhe vërejtjet e tyre. “Rekomandimet dhe kërkesat tuaja për mua janë obligative dhe do të mundohem t’i realizojë që në fillim të vitit të ardhshëm”, ka thënë kryetari Lutfi Haziri, në takimin publik me qytetarë, që është i dhjeti për dy vite të qeverisjes së tij.

Orari i seancave të Kuvendit dhe Komiteteve për vitin 2016

Kuvendi Komunal në Gjilan

Orari i Seancave të Kuvendit Komunal në Gjilan dhe mbledhjet e komiteteve të KK-së për vitin 2016													
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Kuvendi Komunal Gjilan	28	25	31	28	26	30	28	25	29	27	24	29	
Komitetet e Kuvendit të Komunës-Gjilan													
1	Komiteti për Politikë dhe Financa	19	16	22	19	17	21	19	16	20	18	15	20
2	Komiteti për Komunitete	6	3	2	6	4	1	6	3	7	6	2	7
3	Komiteti për Shëndetësi dhe MS	5	2	1	5	3	7	5	2	6	4	1	6
4	Komiteti për Arsimit	11	8	7	11	11	13	11	8	12	10	7	14
5	Komiteti për Planifikim Urban dhe MM	12	9	8	12	10	6	12	9	13	11	8	13
6	Komiteti për Zh. Ekonomik dhe Agrokulturë	4	1	9	4	11	8	4	1	5	5	3	5
7	Komiteti për Shërbime publike,	7	5	4	8	6	3	1	5	2	7	4	2
8	Komiteti për Kulturë, Rini e Sport	8	10	10	7	12	9	8	10	9	3	12	9
9	Komiteti për Pronë, Kadastër dhe Banim	14	11	11	13	5	10	7	11	8	12	11	12
10	Komiteti për Bashkp. Ndërkufitar	13	12	14	14	13	14	13	12	14	13	10	8
11	Komiteti për Barazi Gjinore	15	4	4	1	2	2	14	4	2	14	9	13
12	Kom. Konsul. i Ekspertëve të Pla.Hapsinor	18				16				15			15



Kuvendi Komunal i Gjilanit me sallë të re të modelit evropian

30
TETOR

Në ditën e festës së falënderimeve “Darka e Lamës”, është përruruar salla e re e Kuvendit Komunal, ku është mbajtur edhe seanca e radhës. Në këtë hapësirë i ka mbajtur mbledhjet e veta Kuvendi Komunal, edhe para luftës. Tani ajo është rregulluar me mjete të Komunës, sipas modelit evropian dhe ofron kushte ideale për punë. Pas hapjes solemne,

kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku-Rexhepi, është shprehur se tashmë kjo sallë është e modelit evropian dhe i plotëson të gjitha kushtet për mbarëvajtjen e mbledhjeve të Kuvendit. Salla e re e Kuvendit Komunal të Gjilanit, e cila është ndërtuar me buxhet të Komunës, gjendet në rrugën “Bulevardi i Pavarësisë” (objekti i ish-gjykatës).